



Titulli original: *Bir Nasihat, Binbir Ibrat*

Përktheu: Albert Halili
Redaktor: Zija Vukaj
Kryeredaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama

 **PROGRESI** sh.p.k _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 67 60 78484
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Një Këshillë

1001 Mësime

Osman Nuri TOPBASH

PARATHËNIE

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahu të Madhëruar, i Cili na krijoi nga asgjëja, si krijesën më fisnike, atë “njerëzore”; na nderoi me mirësinë e Islamit dhe besimit dhe na bëri prej dëshmuesve të ekzistencës dhe njëshmërisë së Tij!

Selamet dhe salavatet qofshin mbi Muhamed Mustafanë ﷺ, i cili me personalitetin e tij shembullor e të pashoq, është udhëzuesi ynë i lumturisë në këtë botë dhe ndërmjetësuesi tek Allahu në botën tjetër!

Nëse shohim nga horizonti i besimit, vihet re shumë qartë se e gjithë kjo botë, nga fillimi në fund, është një shkollë besimi; të gjitha ndodhitë janë shfaqje të sprovave hyjnore; ndërsa jeta, është një udhëtim drejt vendit të përjetësisë. Detyra jonë më e rëndësishme në këtë karvan të pafundësisë, është të mos kaplohem nga plogështia e egos, të mos kapemi të papërgatitur nga sprovat hyjnore dhe të mos bëhemi udhëtarë të trashë, të tromaksur dhe të hutuar të kësaj jete të përkohshme. Përkundrazi, të jemi vigjilentë përballë shfaqjeve të mistershme dhe plot urtësi të madhëstisë hyjnore.

Padyshim se për një jetë të tillë kërkohet pjekuri shpirtërore; kërkohet qëndrueshmëri e fortë, e cila nuk do të



mashtrohet nga iluzionet kalimtare të kësaj jete të shkurtër; kërkohet urtësi e madhe, që të shohësh se sa gabim i rëndë është të grindesh, të thyesh zemra dhe të shkelësh të drejtat e të tjerëve për interesa të kësaj bote, të cilave pas njëfarë kohe do t'u vijë fundi; kërkohet mençuri, e cila brenda vetëdijes së përkohshmërisë do të kuptojë urtësinë e dërgimit në këtë botë. Dhe padyshim se burimi i të gjitha këtyre virtyteve është Islami.

Mirëpo, është një fakt shumë i qartë se pa u përkushtuar ndaj diçkaje, është e pamundur ta zotërosh atë. Prandaj, për ta kuptuar sa më mirë mirësinë e Islamit, kërkohet që ta përvetësosh atë me zemër aq sa e përvetëson edhe me mendje dhe ta bësh atë mbizotërues në çdo periudhë të jetës. Për të arritur këtë, njeriu duhet të marrë një edukim të lartë shpirtëror.

Ata që do të na e japin këtë edukim, janë Pejgamberi ynë ﷺ, i cili ka thënë: *“Mua më ka edukuar Zoti im me një edukim të lartë.”* (Sujuti, *Xhamiu's-Sagir*, I, 12.) dhe dijetarët që i ndjekin me kujdes të veçantë gjurmët e tij dhe që në të njëjtën kohë janë edhe trashëgimtarët e pejgamberëve. Pa u vënë veshin thirrjeve të tyre udhëzuese, mendjet e kufizuara dhe zemrat e papjekura nuk mund ta dëgjojnë të vërtetën, të gjejnë rrugën e drejtë, të shohin urtësitë e kësaj bote dhe të zgjidhin enigmat e jetës dhe gjithësisë.

Të dashur lexues!

Në këtë libër janë përmbledhur një pjesë e kritereve të rëndësishme Islame, që janë të domosdoshme për një jetë të lumtur. Pothuajse të gjitha temat trajtohen përreth një tregimi apo historie të jetës së pejgamberëve, të sahabëve



fisnikë, njerëzve të ditur e miqve të Allahut. Në këtë mënyrë, synohet që me ndihmën e shembujve konkretë të vërtetat të bëhen më të kuptueshme.

Nëse do të shpreheshim shkurtimisht në lidhje me përmbajtjen e librit, mund të themi se:

Besimtari me shpirt të ndjeshëm, gjithmonë përpiket të përmirësojë sjelljet dhe gjendjen e vet, duke marrë mësim prej çdo gjëje. “**Një këshillë**” që do të dëgjonte, do t’i mjaftonte për të marrë “**Njëmijë mësim**”.

Ndërsa një zemër e papjekur, që përpëlitet në pavetëdije dhe ngurtësi, nuk merr mësim edhe prej këshillave më ndikuese. Njerëz të tillë nuk ndreqen me këshilla, por vetëm me fatkeqësi. Prandaj, mënyra më e mençur për të mos pësuar fatkeqësi, është të marrim mësim prej këshillave. Kjo, sepse dëmet e shumë prej fatkeqësive që e sjellin në vete njeriun, është e pamundur të korrigjohen përsëri. Për këtë arsye, çdo tablo mësimdhënëse që shohim dhe çdo këshillë që dëgjojmë, duhet ta konsiderojmë sikur është apostafat për ne, duke korrigjuar veten dhe duke bërë një vetëllogari të ndërgjegjes sonë.

Ideali dhe pretendimi ynë më i madh si besimtarë në këtë botë, është “besimi”. Mirëpo, ashtu si çdo pretendim që ka nevojë për argument, është kusht që edhe ky ideal të argumentohet me prova dhe dëshmitarë. Pra, “**Besimi kërkon prova**”. Dhe kjo varet nga përgjigjet që bëhen në përputhje me besimin, si durimi, pranimi, mbështetja në Allahun, dorëzimi, falënderimi dhe mirënjohja, që u japim të gjitha shfaqjeve të sprovave hyjnore me të cilat përballemi.

Vetëm kështu mund të arrihet sinqeriteti në besim, syni-



mi i kënaqësisë së Allahut në çdo çështje dhe të realizohen shfaqjet e mirësive të veçanta hyjnore të lidhjes me dashuri ndaj Allahut; pra arritja e **“Begatisë së sinqeritetit dhe devotshmërisë”**. Allahu i Madhëruar, për robërit e Tij që jetojnë me devotshmëri, bëhet syri me të cilin shohin dhe veshi me të cilin dëgjojnë. (shih. Buhari, Rikak, 38) Mjafton që zemrat të pastrohen nga idhujt e dëshirave dhe epsheve dhe të bëhen vende të shfaqjeve hyjnore. Një rob i cili mund ta ruajë veten e tij nga idhujtaria e egos së vet, mund të kapërcejë çdo vështirësi dhe mund të hapë çdo kyç që duket i pahapshëm. Ndërsa, për të shtënë në dorë çelësin e derës që hapet në atmosferën e lumturisë së përjetshme, duhet jetuar në përputhje me përmbajtjen e **“kelime-i teuhidit”**. Ashtu siç kërkohen vepra të mira për të provuar besimin, ashtu duhet që edhe **“Dhëmbëve të çelësit të kelime-i teuhidit”** t’u jepet formë në bazë të kriterëve të Kuranit dhe Sunetit, në mënyrë që të hapë derën e xhenetit.

Kur arrihet një pjekuri e tillë shpirtërore, fillojnë dhe zgjidhen enigmat dhe të panjohurat e jetës dhe ngjarjeve. Mirësia e fshehur brenda shkatërrimit, mëshira e fshehur brenda vështirësive dhe mirësitë hyjnore të fshehura brenda vuajtjeve e hidhërimeve fillojnë e bëhen të qarta për robin. Një zemër e tillë e kupton se **“E vërteta qartësohet me të kundërtën e saj”**. Arritja e së vërtetës dhe mirësisë, bëhet e mundur me anë të ruajtjes nga të këqijat dhe të kotat.

Udhëzuesi ynë më i saktë në lidhje me këtë çështje, është **“Libri i gjithësisë: Kurani Fisnik”**, çdo shkronjë e të cilit përmban shumë mistere dhe urtësi. Ai është një oqean i pafund shpirtëror brenda të cilit ndodhen të përmbledhura të



gjitha të vërtetat e universit. Detyra jonë si besimtarë, është të hyjmë në horizontin e meditimt, që është edhe thesari i frymëzimit shpirtëror të Kuranit; të arrijmë pjekurinë shpirtërore, në sajë të së cilës do të mund të përdorim armën e “durimit” në momentet kur na lënë forcat nën presionin e situatave të ndryshme të jetës, duke i shikuar nga ky horizont të gjitha ngjitjet dhe zbritjet e saj, të cilat janë edhe shfaqje të sprovave hyjnore; t’i përballojmë me pjekuri surprizat e hidhura të jetës dhe ndodhive duke ndjerë vullnetin hyjnor në çdo gjë.

Edukimi që synon një pjekuri e tillë shpirtërore, pra **“tasavufi, është arti i të qenit i kënaqur me vullnetin hyjnor”**. Të dish se gjithçka, e mira dhe e keqja vjen prej Allahut, e ruan zemrën prej lodhjes me shqetësime dhe hidhërime të panevojshme. Një besimtar që kërkon të arrijë kënaqësinë e Allahut, e di shumë mirë se më parë duhet të jetë i kënaqur vetë prej Allahut dhe se në çdo rast duhet ta falënderojë Atë. Ai i kupton **“urtësitë dhe mrekullitë që gjenden tek vuajtjet”**. Ai e ndjen urtësinë e faktit se vuajtjet më të mëdha i kalojnë robërit më të dashur të Allahut. Pra, e kupton në mënyrë të qartë se edukimi me vuajtje, është një metodë e lartë e përsosjes shpirtërore.

Ja pra, detyra jonë më e rëndësishme si besimtarë, është fitimi i kësaj pjekurie shpirtërore, duke arritur meritën e përfaqësimit të bukurive hyjnore në çdo vend dhe kohë, pra **“të shfaqim një personalitet islam”** në kuptimin e plotë të fjalës.

Thirrja më e bukur ndaj atyre që janë larg udhëzimit dhe nuk i njohin bukuritë e Islamit, është shfaqja e Islamit



në jetën tonë të përditshme në mënyrë të gjallë. Dhe për këtë, më parë duhet ta ringjallim veten me përsosmërinë e sjelljeve islame dhe më pas, me anë të fjalës, gjendjes dhe sjelljes sonë duhet të shfaqim bukurinë e fytyrës së Islamit, botëkuptimin e tij ndaj së vërtetës dhe drejtësisë, butësinë, mëshirën; me një fjalë, të gjitha ndjesitë e tij shpirtërore.

Historia, është dëshmitare se jeta me moral islam i ka kthyer shumë gjemba në kopshte trëndafilash dhe shumë armiqësi në miqësi. Nisur nga kjo, treguesi ynë në përfaqësimin e moralit islam si besimtarë, duhet të jetë botëkuptimi: **“Kush vjen për të të vrarë, të ngjallet tek ti!”**. Kjo, sepse besimtar i vërtetë, është njeriu altruist, i cili është i vetëdijshëm se shpëtimi i tij varet nga shërbimi në shpëtimin e të tjerëve. **“Fruti i parë i besimit, është mëshira”**. Butësia dhe mëshira ndaj krijesave për hir të krijuesit, është domosdoshmëri e besimit. Zemra e një besimtari që e përjeton besimin me dashuri, bëhet një vendprirje ambulante që i përqafton me mëshirë të gjitha krijesat.

Hapja e këtyre vendprirjeve, pikësëpari, është **“Përgjegjësi e prijësve”** që udhëzojnë shoqëritë. Kjo, sepse çdo gjendje e prijësve, qoftë pozitive apo negative, përhapet shpejt përreth tyre si shembulli i valëve që formon një pikë që bie mbi ujin e qetë. Për këtë arsye, në mënyrë të veçantë ata janë të detyruar të tregojnë më tepër kujdes ndaj sjelljeve dhe prirjeve që kanë në zemra e tyre.

Mirëpo edhe individët që formojnë shoqërinë, duhet të bëjnë kujdes ndaj sjelljeve të tyre, duke pasur gjithmonë parasysh hadithin fisnik: **“Siç jeni, ashtu do të qeveriseni!”**. (Sujuti, *Xhamiu’s-Sagir*, II, 82) Ata duhet të posedojnë një horizont



shpirtëror të gjerë, në sajë të të cilit do ta konsiderojnë veten përgjegjës ndaj mbarëvajtjes së gjithë shoqërisë.

Nga ana tjetër, të kaplohesh nga gëzimi i tepërt përballë lumturive kalimtare të kësaj bote të përkohshme dhe të harrosh se lumturia e vërtetë është në botën tjetër, nuk u shkon aspak besimtarëve të mirë. Kjo vlen edhe për kaplimin nga hidhërimi i tepërt përballë surprizave të hidhura të jetës. Në këtë aspekt, duke e kuptuar mirë se sa të parëndësishme janë shqetësimet kalimtare të kësaj bote që e lodhin shpirtin e njeriut, në krahasim me jetën e përjetshme, duhet të synojmë arritjen e **“misterit të rinisë”**, që shkon drejt pafundësisë.

Padyshim se arritja e këtij misteri është e mundur vetëm për robërit fatlumë që vdesin para se t’u vijë vdekja, pra ata që e kthejnë vdekjen një festë, duke i eliminuar dëshirat e egos. Mesazhi më i madh që i lënë njerëzimit këta robër të tillë, që jetojnë në zemrat e njerëzve edhe pas jetës së tyre të përkohshme, është: **“Bëj një jetë të tillë, që të vdesësh i përgëzuar!..”**

Shpirtrat e përsosur jetojnë me dashurinë dhe entuziazmin për të lënë një thirrje të këndshme në kupën qiellore, duke kapërcyer ekzistencën e tyre të përkohshme e relative. Në të njëjtën kohë, duke u nisur nga fakti se në derën e varrit do t’i braktisin të gjitha gradat dhe pasuritë e kësaj bote e do të varrosen vetëm me punët e tyre, ata kanë vepruar me urtësinë e dërgimit të të mirave në botën tjetër në sajë të mirësive dhe bamirësive që kanë bërë që në këtë botë. Ruajtja e zemrës së tyre përballë mirësive të kësaj bote, shpreh faktin se nuk mund të arrihet tek Allahu



pa u zhveshur nga rroba e ekzistencës dhe unit dhe pa e pastruar nga zemra çdo gjë që të bën të harrosh Zotin. Pra, ata sikur na thonë: **“Lëshoje barrën dhe kalo!”**.

Gjithashtu, nëse foleja familjare, e cila është shkak për vazhdimësinë e ekzistencës njerëzore, ndërtohet nga bashkëshortë me personalitet të pjekur, të cilët i kanë përvetësuar këto parime të larta, e bën të mundur paqen e xhenetit që në këtë botë. Edhe pse përputhja shpirtërore e bashkëshortëve zë një vend shumë të rëndësishëm në këtë paqe dhe lumturi, siç thotë edhe shprehja “folenë e bën zogu femër”, rëndësi të veçantë ka edhe edukimi i mirë i femrës.

Njerëzit e urtë thonë:

“Nëse edukoni një mashkull, keni edukuar një njeri. Por, nëse edukoni një femër, keni edukuar një familje, madje një pjesë të madhe të shoqërisë.”

Nisur nga kjo, mund të themi se “gruaja e mirë është stolia më e bukur e racës njerëzore”. Gruaja e mirë është simboli i vlerave më të rëndësishme që e mbajnë në këmbë njerëzimin, si edukata, turpi, ndershmëria, namusi, mirësjellja, delikatesa, butësia, fisnikëria dhe pastërtia shpirtërore.

Në ditët tona, nën emrin “barazi gjinore”, po bëhet një propagandë e madhe, që i ka vënë gratë në garë me burrat në çdo fushë të jetës. Për fat të keq, kjo është një nga gabimet më të mëdha të botës moderne, sepse struktura trupore dhe shpirtërore e grave nuk është e njëjtë me atë të burrave. Për këtë arsye, paqja në familje dhe shoqëri mund të arrihet vetëm nëse cilësitë dhe aftësitë e femrave dhe meshkujve mbrohen dhe përdoren në vendin e duhur.



Përndryshe, njerëzimi do të shkatërrohet dhe shoqëria do të shndërrohet në një gjermadhë njerëzore.

Nga kjo pikëpamje, duhet që vajzat e reja të marrin shembull prej **“modelit të gruas së mirë në Epokën e Lumturisë”**, pa u infektuar ende nga sëmundjet e botës moderne, në mënyrë që të shfaqin një personalitet islam të pastër e të paprishur, duke u bërë shembull në rrethin ku jetojnë. Lidhur me këtë çështje, **“Këshillat e një nëne të mirë për vajzën e saj”**, në prag të martesës, përbëjnë kapitalin themelor për ndërtimin e një foleje të qetë familjare.

Këto këshilla kanë zënë një vend të rëndësishëm në traditën shumëshekullore islame. Dhe thelbi i këtyre këshillave është që më parë të mendosh shokun e jetës, jo veten; pra të tregohesh altruist e jo egoist. Përveç kësaj edhe nxitja në devotshmëri, edhe ndihma për arritjen e lumturisë në botën tjetër, që tregojnë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit, është një prej shkaqeve themelore të paqes familjare. Kjo varet nga gjendja e besimit dhe niveli i pjekurisë morale të bashkëshortëve.

Nga ana tjetër, rëndësi të madhe ka edhe “mehri”, të cilin Islami e ka përcaktuar si një nga të drejtat më të rëndësishme të gruas. Në dukje, mehri është një garanci materiale për këtë botë. Mirëpo, qëllimi i vërtetë i dhënies së kësaj mundësie materiale, është ruajtja e jetës shpirtërore të gruas, pra mbrojtja e virtytit të nderit dhe ndjeshmërisë femërore.

Nisur nga kjo, në ditët tona, kur materializmi është kthyer në një sëmundje ngjitëse, ku vlerat shpirtërore janë përmbysur dhe në shoqëri kanë zënë rrënjë botëkuptime të



devijuara, virtyti që shfaqti në lidhje me mehrin një prej grave sahabe, e cila ishte në majën më të lartë të dorëzimit ndaj Allahut dhe bindjes ndaj Pejgamberit ﷺ, është një shembull i mahnitshëm devotshmërie, aq sa të bën të thuash: **“Një mehër i tillë!”**. Padyshim se, zemrat që e njohin Allahun dhe përpiqen që çdo mundësi ta kthejnë në një fitim për botën tjetër, mund të marrin mësimë të shumta nga këta shembuj.

Allahu i Madhëruar i bëftë ndjenjat dhe mendimet tona në përputhje me kënaqësinë e Tij dhe sinqeritetin e devotshmërinë boshtin e veprave tona. Gjithashtu, i mbushtë zemrat tona me qetësinë e besimit dhe na bëftë të gjithëve prej robërve fatlumë, të cilët i përfaqësojnë bukuritë e Islamit duke i jetuar ato personalisht! Amin!..

Osman Nuri Topbash

Nëntor 2009

Yskydar





Një kësbillë, një mijë e një mësime...



Muhamedi ﷺ në një thënie të Tij e përshkruan në këtë mënyrë besimtarin:

“Ai është si bleta, e cila ushqehet me ushqim të pastër, prodhon ushqim të pastër e të shëndetshëm dhe kur qëndron mbi lule nuk e dëmton apo e prish atë.” (Ahmed ibn Hanbel, II, 199)

Ashtu si bleta që shëtit mbi një mijë lule për të mbledhur nektarin, për të prodhuar më pas mjaltin edhe ne si besimtarë duhet të marrim mësime nga jeta e Pejgamberit ﷺ dhe miqve të dashur të Allahut, për t'i pasqyruar në çdo moment të jetës sonë. Në këtë mënyrë i ofrojmë gjithë njerëzimit mirësjelljen dhe ëmbëlsinë e Islamit.



NJË KËSHILLË, NJË MIJË E NJË MËSIMI...

Çdo individ ndjen nevojën për këshilla gjatë jetës së tij, pavarësisht nivelit intelektual, social apo profesional në të cilin ndodhet.

Pejgamberi ﷺ, duke e shprehur këtë realitet në hadithin: *“Feja është këshillë.”* (Muslim, Iman, 95), pothuajse e deklaroi këshillën si mjetin e vetëm të shpjegimit të fesë. Për më tepër, përsëritja tri herë e kësaj porosie nga Pejgamberi ﷺ, tregon rëndësinë dhe nevojën e përsëritjes së këshillës.

Nëse një besimtar në kohën dhe vendin ku jeton nuk gjen dot njerëz të urtë e të mençur, me këshillat e të cilëve mund të orientohet dhe ndriçojë rrugën drejt së vërtetës, duhet medoemos që mësimet prej të cilave mund të përfitojë, t'i nxjerrë nga ngjarjet dhe ndodhitë historike. Ky është edhe qëllimi kryesor i përpilimit të librave me tregime mistike. Këto vepra janë shkruar për të përfituar prej njerëzve të urtë, të cilët kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme.

Sundimi i katër halifëve të drejtë me gjithë gjashtë muajt e sundimit të Hasanit ؑ, pati një jetëgjatësi totale prej tridhjetë vjetësh. Kjo periudhë e kalifatit, ngaqë u mbriut me begatinë shpirtërore të Pejgamberit ﷺ, u përmbush në



mënyrë të përsosur. Kurse në periudhën mbas kalifëve të drejtë, ashtu siç kishte paralajmëruar Pejgamberi ﷺ, do të sundonte despotizmi dhe, për këtë arsye, periudha mbas kalifëve të drejtë është quajtur “kalifat formal”. Të parët e kalifatit formal janë kalifët e dinastisë umejade.

Megjithëse dinastia Umejade u kontestua në mënyrë masive nga myslimanët për shkak të qëndrimit të pahijshëm që mbajti ndaj Ehli Bejtit, në të pati edhe personalitete të shquara si Omer ibn Abdulazizi, i cili brenda një kohe mjaft të shkurtër në të cilën qëndroi në pushtet fitoi admirimin e të gjithë myslimanëve përmes përmbushjes me përpikëri të detyrave dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Përveç Omer ibn Adulazizit, kalifët e dinastisë umejade ngaqë islamizimin e popullsisë e perceptuan edhe si arabizim të saj, u përballën me reagime dhe antipati të thellë nga ana e popujve të sapokonvertuar në Islam. Kjo bëri që jetëgjatësia e dinastisë umejade të mos i kalonte 92 vjetët.

Paraardhësi i Omer ibn Abdulazizit ishte kalifi Sulejman ibn Abdulmelik. Dialogu i këtij të fundit, realizuar me një nga personalitetet e shquara të brezit të tabiinëve, siç ishte Ebu Hazimi, ka zënë një vend të veçantë në literaturën islame të urtësisë për shkak të këshillave të vyera që përmban.

Sulejman ibn Abdulmelik niset nga Meka për në Medine, për të qëndruar disa ditë në qytetin e Pejgamberit ﷺ. Kur arriti në Medine pyeti të pranishmit nëse jetonte ndonjë që kishte marrë mësim dhe ishte edukuar nën kujdesin e sahabëve të Pejgamberit ﷺ. Të pranishmit e informuan për dijetarin e famshëm Ebu Hazim. Kalifi menjëherë dërgoi



një person për ta sjellë pranë tij. Kur mbërriti, midis tij dhe Kalifit u zhvillua ky dialog:

Kalifi:

- Unë erdha në Medine si kalif, përse kjo mungesë respekti dhe mosinteresimi nga ana juaj? Përse mbani distancë nga unë?

Ebu Hazim:

- O Prijësi i besimtarëve, çfarë marrëdhënieje mund të kem unë me ju?

Kalifi:

- Ndërsa paria e Medinës erdhi të më takojë, ti përse nuk erdhe?

Ebu Hazim:

- O Prijësi i besimtarëve! Deri më sot as ti nuk më njihje mua dhe as unë ty. Në këtë mënyrë, si mund të presësh një interesim të veçantë nga ana ime?

Kalifi u kthye nga Muhamed ibn Shihab ez-Zuhri, duke i thënë: “Ky njeri ka të drejtë, unë bëra gabim.” Dhe duke ndjerë nevojën për këshillat e këtij njeriu të urtë, e pyeti:

- Ebu Hazim! Si ka mundësi që ne e urrejmë vdekjen?

Ebu Hazimi:

- Sepse ju keni rënë pre e dëshirave epshore dhe pasioneve, keni ndërtuar dynjanë duke rrënuar ahiretin. Për këtë arsye, urreni të shkoni nga një vend i mirëndërtuar në një vend të rrënuar.



Kalifi:

- Të vërtetën the, o Ebu Hazim! Si do të dalin para Allahut njerëzit në Ditën e Gjykimit?

Ebu Hazim:

- Vepërmirët do të dalin të lumtur e të qetë si personat që kthehen në familjen e tyre pas një kurbeti të gjatë. Kurse ata që kanë qenë robër të epsheve të tyre do të dalin para Allahut si skllavi që kapet duke u arratisur dhe sillet para pronarit. Kalifi përballë kësaj përgjigjeje nuk mundi të duronte dhe filloi të qante me dënësë. Dhe duke shprehur keqardhjen, tha:

- Ah, sikur ta dija si do ta takoj Allahun!

Ebu Hazimi:

- Atëherë rregulloji veprat sipas Librit të Allahut dhe Sunetit të Pejgamberit ﷺ.

Kalifi:

- Më trego çfarë duhet të bëj për të rregulluar pozitën time para Allahut.

Ebu Hazimi lexoi ajetin: **“Pa dyshim, të mirët janë në xhenet, kurse mëkatarët me siguri në xhehenem.”**

(Infitar, 13-14)

Kalifi:

- Po mëshira e Allahut, ku është?

Këtë herë Ebu Hazimi lexoi ajetin: **“Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve.”** (Araf, 56)



Më pas dialogu vazhdoi kështu:

Kalifi:

- Cilët janë robërit më të mirë të Allahut?

Ebu Hazimi:

- Robërit më të mirë tek Allahu janë mëshiruesit, bujarët, modestët, të mençurit që nxjerrin mësimë dhe njerëzit që janë në shërbim të njerëzimit.

- Cila është vepra më e vyer?

- Qëndrimi larg haramëve dhe kryerja e detyrimeve me kënaqësi, nderim dhe përvulje.

- Cila është lutja më e pranueshme?

- Lutja që bën për personin që ju ka bërë një të mirë.

- Cila sadaka është më e çmuar?

- Lëmosha e personit që është nevojtar dhe që nuk shoqërohet me përmendje.

- Cila është fjala më e drejtë?

- Thënia e së vërtetës personit që ke frikë ose personit prej të cilit shpreson të përfitosh diçka.

- Cili është besimtari më i mençur?

- Besimtari i përkushtuar në bindjen ndaj Allahut dhe që është shembull për njerëzit në këtë çështje.

- Cili është personi më mendjelehtë?

- Personi që anon nga dynjaja, duke harruar ahiretin. Ai i cili, duke ndjekur dëshirat e shokut të vet rrënoi ahiretin



për dynjanë e tjetërkujt.

- Të gjitha çfarë the janë më se të sakta, po për gjendjen tonë çfarë mendon?

- O prijësi i besimtarëve, më lejoni të mos i përgjigjem kësaj pyetjeje.

- Jo! Konsideroje si këshillë për mua këtë përgjigje.

Ebu Hazimi:

- O sundues i besimtarëve! Baballarët e tu i kanë shtypur njerëzit me shpatë dhe këtë mbretëri e morën me forcë pa u këshilluar me myslimanët dhe pa dëshirën e tyre, duke vrarë shumë prej tyre; tani ata janë larguar nga kjo botë, ah sikur t'i dëgjoje se ç'thanë e ç'iu tha atyre (para Zotit).

Një i pranishëm, në formë qortimi i tha:

- Këtu gabove, o Ebu Hazim!

Ebu Hazimi:

- Jo, këtu po gabon ti, sepse Allahu i ka urdhëruar dijetarët të thonë të vërtetën pa pasur frikë nga askush dhe të mos e fshehin atë.

Sulejmani:

- Si mund të përmirësohemi?

Ebu Hazimi:

- Braktisni padrejtësitë dhe dhunën, silluni mirë me njerëzit dhe gjykoni me drejtësi midis tyre, atëherë mund të përmirësoheni.

- Si mund ta realizojmë këtë gjë?



- Fitojeni pasurinë në mënyrë të drejtë, shpenzoheni pasurinë për ata që kanë nevojë.

Sulejmani:

- A do të na shoqërosh o Ebu Hazim, që të marrësh nga ne e të marrim nga ti?

Ebu Hazimi:

- Allahu më ruajtë prej kësaj.

Pse pyeti kalifi?

- Kam frikë se do të anoj pak nga ju, sepse ju jeni nën sundimin e dëshirave, nëse anoj nga ju, Allahu do të më bëjë të shijoj dobësinë e jetës dhe të vdekjes.

Sulejmani:

- Më thuaj, për çfarë ke nevojë?

Ebu Hazimi:

- Më shpëto nga zjarri dhe më bëj të mundur të hyj në xhenet.

Sulejmani:

- Nuk kam mundësi për një gjë të tillë.

Ebu Hazimi:

- Edhe unë nuk kam nevojë për gjë tjetër.

Sulejmani:

- Lutu për mua atëherë.

- O Zot! Nëse Sulejmani është miku Yt, jepi atij mirësi dhe begati në këtë botë dhe botën tjetër. Nëse është



mëkatar, ndihmoje të kthehet në rrugën prej së cilës Ti je i kënaqur.

- Kaq?

- Nëse e meriton këtë lutje, unë me të vërtetë kam bërë një lutje shumë të vlefshme, nëse nuk e meriton apo nuk ke dëshirë të ecësh në rrugën e drejtë, atëherë kjo lutje i ngjan hedhjes së shigjetës me një hark që nuk ka fill, pra nuk shërben për asgjë.

- Çfarë më këshillon tjetër?

- Do të të jap një këshillë të urtë: Adhuroje Allahun me respekt dhe kujdes, tregohu i kujdesshëm në urdhëresat dhe ndalesat e Tij, në mënyrë që Allahu të të gjejë gjithmonë aty ku të ka urdhëruar e jo ku të ka ndaluar.

Sapo Ebu Hazimi doli, Kalifi i dërgoi njëqind dinarë dhe një letër ku i shkruante që t'i shpenzonte, sepse do t'i jepte edhe më shumë.

Por Ebu Hazimi nuk i pranoi dhe së bashku me dinarët i dërgoi edhe një letër, ku i shkruante:

- O prijësi i besimtarëve! Më vjen shumë keq që nuk paske përfituar asnjë dobi nga këshillat dhe përgjigjet. Si mund t'ia lejoj vetes ato që t'i ndalova ty? Unë nuk të këshillova kundrejt shpërblimit, në lidhje me këtë dua të tregoj historinë e Musait عليه السلام, me dy vajzat e Shuajbit عليه السلام.

Kur Musai عليه السلام, arriti te burimi i Medjenit, gjeti aty shumë njerëz duke u dhënë ujë bagëtive. Përveç tyre, ai vuri re edhe dy vajza që po mbanin kafshët e veta. Ai u tha: “Si e keni hallin ju?” Ato thanë: “Ne nuk mund t’u japim ujë



bagëtime tona pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë i moshuar”. Musai عليه السلام, pasi i ndihmoi t’u jepnin ujë bagëtime, u ul nën një hije aty pranë dhe iu lut Zotit: **“Zoti im, unë jam nevojtar për çdo mirësi Tënden.”** (Kassas, 23-26)

Musai عليه السلام, po lutej ndërsa ishte i lodhur dhe i uritur nga udhëtimi i gjatë, në të njëjtën kohë ishte i frikësuar nga rreziku që mund t’i vinte prej armiqve. Por Ai me gjithë atë gjendje të rënduar, strehimin dhe qetësinë e gjeti vetëm tek Allahu, duke injoruar çdo lloj ndihme tjetër.

Vajzat e kuptuan menjëherë gjendjen e Musait عليه السلام dhe sapo arritën në shtëpi, i treguan babait për të panjohurin që i ndihmoi.

Shuajbi عليه السلام, i tha njëres prej vajzave: “Shko thirrre të na nderojë në shtëpi, sepse duhet të jetë i uritur.”

Vajza shkoi në vendin ku ishte Musai عليه السلام dhe gjithë respekt dhe nderim i tha:

Babai ju fton në shtëpi, që t’ju shpërblejë për ndihmën që na bëtë.

Musait عليه السلام, i erdhi rëndë përmendja e shpërblimit, por nuk gjeti zgjidhje tjetër përveçse të ndiqte vajzën për në shtëpinë e Shuajbit عليه السلام.

Ndërsa vajza ecte para Musait عليه السلام, era që frynte i ngjiste rrobat pas trupit, duke i shfaqur linjat. Musai عليه السلام, përpiquej të mbante larg shikimin, duke kthyer kokën herë djathtas herë majtas. Më në fund, i tha:

- Ecni ju mbas meje dhe më oriento me fjalë cilën rrugë duhet të ndjek.



Kur Musai عليه السلام, mbërriti te shtëpia e Shuajbit, e gjeti darkën të shtruar. Shuajbi عليه السلام, e ftoi të ulej për të ngrënë, por Musai عليه السلام, refuzoi të ulej.

Shuajbi عليه السلام:

- Përse nuk uleni apo nuk jeni i uritur?

I uritur jam, por kam frikë se kjo bukë është si shpërblim i ndihmës që u bëra vajzave. Ne rrjedhim nga një familje, e cila çdo bamirësi e bën vetëm për hir të Allahut.

Shuajbi u drejtua nga ai dhe i tha: “Jo, nuk është ashtu siç mendon ti, por mikpritja dhe përcjellja bujare e mysafirëve është traditë në familjen tonë.”

Pas këtyre fjalëve të sinqerta dhe të përzemërta të Shuajbit, Musai عليه السلام, u ul për të ngrënë.

Ebu Hazimi, pasi i tregoi historinë e Musait عليه السلام, e vazhdoi kështu letrën drejtuar Kalifit:

“Nëse këto njëqind dinarë janë si shpërblim i këshillave të mia për ty, atëherë mishi i ngordhur, mishi i derrit dhe gjaku, të cilat janë të lejuara në raste të veçanta, janë më të mirë se këto njëqind dinarë. Nëse mendon se këto janë e drejta ime nga thesari i shtetit, atëherë ka shumë të tjerë para meje që kanë të drejtë të përfitojnë nga thesari i shtetit. Vetëm nëse ke bërë një ndarje të drejtë, atëherë nuk ka problem, përndryshe unë nuk kam nevojë për dinarë. (Darimi, Mukaddime, 56/653; Ebu nuajm, Hilje, III, 234-236)



shëm. Por siç e theksoi edhe Ebu Hazimi, në një masë të vogël sundohej nga dëshirat dhe kënaqësitë e çastit. Por sa vetë në botë kanë arritur të shpëtojnë në mënyrë absolute nga kthetrat e nefsit?!

Edhe ne ashtu si Kalifi Sulejman, dikush më pak dikush më shumë, jemi nën sundimin e nefsit. Këto këshilla të Ebu Hazimit drejtuar Kalifes duhet t'i vlerësojmë si këshilla drejtuar edhe ndaj nesh, në mënyrë që ta kemi më të lehtë për të mposhtur egon dhe rregulluar veprat sipas Kuranit dhe Traditës Profetike.

Një mik i Zotit thotë: “Një bletë, për të mbushur një hoje me mjaltë mbledh nektar prej një mijë lulesh.”

Ashtu si bleta që shëtit mbi një mijë lule për të mbledhur nektarin që të prodhojë më pas mjaltin edhe ne si besimtarë duhet të marrim mësimë nga jeta e Pejgamberit ﷺ dhe miqve të dashur të Allahut, për t'i pasqyruar në çdo moment të jetës sonë, në mënyrë që t'i ofrojmë gjithë njerëzimit mirë-sjelljen dhe ëmbëlsinë e Islamit.

O Zot, na mundëso të përfitojmë në jetën tonë copëza nga morali dhe personaliteti shembullor i Muhamedit ﷺ!.. Na ndihmo të përfitojmë nga mënyra e edukimit, mësimdhënies dhe të gjitha virtytet e larta të Tij!.. Na zbukuro me moralin e Tij të rrallë dhe na mundëso që përmes pasqyrimit të moralit të Tij të bëhemi shkak për udhëzimin e shumë njerëzve të tjerë!

Amin...!



Besimi kërkon dëshmi



Ashtu si pastërtia e arit përftohet përmes nxehtësisë së tij në temperatura tepër të larta edhe besnikëria në besim provohet përmes durimit, pranimit, tevekkulit dhe ruajtjes së qetësisë dhe ekuilibrit përballë fatkeqësive dhe vështirësive të ndryshme në jetë.

Nga kjo pikëpamje, besimtari i ngjason pozitës së floririt midis metaleve të tjera. Nëse bie në baltë, nuk humbet asgjë nga vlera e tij.

BESIMI KËRKON DËSHMI

Siç rrëfëhet, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka pyetur një ditë Harithin رضي الله عنه:

- Si u gdhive sot, o Harith?

Harithi:

- Si një besimtar i vërtetë, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi ﷺ:

- Çdo gjendje dhe e vërtetë ka dëshminë e vet. Cila është dëshmia e vërtetësisë së besimit tënd?

Harithi:

- O i Dërguari i Allahut. Hoqa dorë nga bota dhe kënaqësitë materiale të saj, në atë mënyrë që ditët i kaloj në agjërim, kurse netët në namaz. Derisa arrita një gjendje të tillë, që arshin e Zotit tim ta shoh qartë.

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Tamam, o Harith! Ruaje zemrën kështu siç e ke! Ti e ke ndriçuar zemrën me dritën e Allahut. (Hejthemi, Mexhmauz-Zevaid, I, 57)

Në një version tjetër, Pejgamberi ﷺ, gjendjen dhe sin-



qeritetin e Harithit e konfirmon kështu:

“Kush dëshiron të shikojë një zemër të ndriçuar me dritën e Allahut, le të shikojë Harithin.” (Ibn Haxher, el- Isabe, I, 289)

Ky rrëfim tregon se çdo pohim kërkon vërtetim dhe çdo vërtetim kërkon argument dhe dëshmitar. Pohimi më i madh i njeriut para Allahut është deklarimi se e beson Atë. Argumentet që shërbejnë për vërtetimin e këtij pohimi janë veprat dhe jeta sipas programit hyjnor.

Imani është përkufizuar si shqiptim me fjalë dhe miratim me zemër. Miratimin e saj, zemra e konfirmon, e shpreh përmes veprave të mira.

Imani është dashuri dhe treguesi i dashurisë është sakrifica. Sinqeriteti në besim është në raport të drejtë me sakrificën në rrugën e Allahut. Pra, veprat e mira janë pasqyrë që tregon nivelin e besimit.

Përsosja e imanit është e lidhur ngushtë me devocionin e thellë të jetës shpirtërore. Kurse devocioni është arti i krijimit të miqësisë së ngushtë midis njeriut dhe Krijuesit, përmes mbrojtjes së zemrës nga ndalesat e Allahut, disiplinimit të dëshirave dhe zhvillimit të dhuntive shpirtërore. Devotshmërinë mund ta përkufizojmë edhe si përpjekje për të shpëtuar nga zemërimi dhe dënimi i Allahut, duke u strehuar në hijen e mëshirës së Tij.

Allahu në Kuran i porosit besimtarët:

“...Bëhuni të devotshëm, që Allahu t’ju japë dituri...” (Bekare, 282) Pra Allahu i dhuron dituri dhe urtësi njeriut



sipas nivelit të marrëdhënies që ka me devocionin.

Besnikëria e njeriut në besim vihet në provë përmes vështirësive të ndryshme gjatë jetës së tij. **“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu të dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë.”** (Ankebut, 2-3)

Ashtu si pastërtia e arit përftohet përmes nxehtësisë së tij në temperatura tepër të larta edhe besnikëria në besim provohet përmes durimit, pranimit, tevekkulit dhe ruajtjes së qetësisë dhe ekuilibrit përballë fatkeqësive dhe vështirësive të ndryshme në jetë.

Nga kjo pikëpamje, besimtari i ngjason pozitës së floririt midis metaleve të tjera. Nëse bie në baltë, nuk humbet asgjë nga vlera e tij. Por si Asija, e cila, megjithëse ishte bashkëshortja e Faronit arriti përmes devotshmërisë, sinqeritetit dhe besnikërisë së saj të ruajë imanin. Ajo sakrifikoi veten për besimin.

Besimtarët e vërtetë e ruajnë qëndrueshmërinë shpirtërore dhe vetëdijen e adhurimit përballë çdo lloj forme të shfaqjes së sprovës, si në formën e shfaqjes në begati, si në fatkeqësi.

Pejgamberi ﷺ, gjendjen e besimtarit e ka shprehur përmes këtij krahasimi të bukur: *“Ai është si bleta, e cila ushqehet me ushqim të pastër, prodhon ushqim të pastër e të shëndetshëm dhe kur qëndron mbi lule, nuk e dëmton apo e prish atë.”* (Ahmed ibn Hanbel, II, 199.)



Besnikëria e besimit vihet në provë, herë përmes fatkeqësive, herë përmes mirëqenies. Reagimi i besimtarit përballë fatkeqësive dhe vështirësive është durimi dhe mbështetja e plotë tek Allahu, e shoqëruar kjo me përpjekje të një-pasnjëshme për të kapërcyer vështirësitë. Kjo lloj sjelljeje e çon njeriun drejt fitores së dashurisë së Allahut, e kundërta e kësaj, pra reagimi përmes revoltës dhe zemërimit e çon njeriun në shkatërrim dhe rrënim të plotë shpirtëror.

E njëjta gjë ndodh edhe me shfaqjen e sprovës në formën e mirëqenies dhe begatisë. Falënderimi ndaj Allahut për begatitë e dhëna dhe modestia përballë njerëzve çon në fitimin e dashurisë së Allahut, në rast të kundërt, kur njeriu ia atribuon vetes të gjitha meritat e begative të zotëruara dhe pushtohet nga mendjemadhësia si Karuni, ai në fakt është në një shkatërrim dhe humbje të vërtetë shpirtërore. Të dyja këto lloj sprovash janë për të testuar dhe provuar sinqeritetin e besimtarit.

Reagimi i Pejgamberit ﷺ, përballë sprovave të tilla përbën shembullin më të përkryer dhe ideal për gjithë besimtarët. Mbas goditjes së fuqishme që i dhanë myslimanët idhujtarisë në luftën e Bedrit, Allahu zbriti një ajet, i cili pengonte përfshirjen e myslimanëve nga ndjenjat egoiste. **“Sigurisht, nuk ishit ju që i vratë ata, por i vrau Allahu! Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante, me qëllim që t’u bënte besimtarëve një dhuratë të bukur. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë.”** (Enfal, 17)

Në vazhden e frymës së ajetit dhe modestisë, i Dërguari i



Allahut ﷺ, megjithëse triumfator, hyri në Mekë gjithë modeshti dhe thjeshtësi dhe nga goja e Tij e bekuar rridhnin vetëm fjalët: “*Jeta e vërtetë është jeta e përtejme*”. Me këtë qëndrim, Ai ia kushtonte të gjithë suksesin e arritur Allahut, duke refuzuar në mënyrë kategorike çdo prirje egoiste që mund t’i hapte rrugë mburrjes dhe lavdisë personale.



Sprovat, siç nxjerrin në pah besimin e vërtetë, nxjerrin në pah edhe virtytet dhe aftësitë e vërteta të njeriut.

Një ditë, kur Pejgamberi ﷺ, po merrte abdest, sahabët u afruan dhe filluan të fërkonin dhe lagnin sytë me ujin e abdesit të Tij ﷺ. Kur Pejgamberi i pyeti për shkakun e këtij veprimi, të gjithë njëzëri iu përgjigjën: “Për shkak të dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.”

Kundrejt mendimit të sahabëve, Muhamedi ﷺ, e shprehu kështu provën e dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij:

“Kush pretendon se do Allahun dhe Pejgamberin e Tij ose dëshiron të fitojë dashurinë e Allahut dhe Pejgamberit të Tij, atëherë, kur të flasë të thotë të vërtetën, të çojë në vend amanetin e dhënë dhe të sillet mirë me fqinjët.”
(Bejhaki, Shuab, II, 201; Tebrizi, Mishkat, III, 81.)

Pejgamberi ﷺ, në hadithin e mësipërm deklaroi qartë se dashuria nuk mund dhe nuk duhet të konsistojë vetëm në fjalë të thata. Dashuria shfaqet në ndjekjen e të dashuruarit. Është krejtësisht absurde të pretendosh se admiron dikë dhe nga ana tjetër të sillesh në kundërshtim me atë që të kërkon



ai. Një person i tillë, ose nuk është i sinqertë në dashuri, ose në veprimet që bën.

Një tjetër argument i besimit është edhe mëshira dhe virtyti i faljes. Këtu nuk bëhet fjalë për mëshirën që pak a shumë e ka çdo njeri, por për mëshirën që ka përkufizuar Pejgamberi ﷺ, në porosinë Profetike.

“Betohem tek Allahu në duart e të cilit është shpirti im, se nuk do të hyni në xhenet deri sa të mëshironi njëri-tjetrin.”

Sahabët e nderuar i thanë:

“Ne të gjithë jemi të mëshirshëm, o i Dërguari i Allahut.”

“Pejgamberi ﷺ, i sqaroi duke thënë: *“Mëshira që kam për qëllim nuk është vetëm mëshira midis jush, por mëshira në përgjithësi.”*

Pra, zemra duhet shndërruar në një burim mëshire dhe dhembshurie, ku mund të shuajë etjen qetësisht çdo krijesë. Kjo mëshirë nënkupton mëshirën dhe dashurinë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Kur njerëzit duhen midis njëri-tjetrit për hir të Krijuesit, atëherë zemrat e tyre bëhen të ndjeshme dhe delikate, në këtë mënyrë shtohet edhe më shumë dashuria dhe mëshira për njëri-tjetrin. Ata e dinë mirë se fitimi i mëshirës së atyre që janë në qiell është i lidhur ngushtë me mëshirën që tregohet ndaj atyre që janë mbi tokë.

Kur njeriu arrin këtë gjendje shpirtërore fillon të tolerojë gabimet që bëjnë të tjerët ndaj tij. Ai për hir të Allahut mëshiron dhe fal gabimet që bëhen kundrejt tij, duke mos i shndërruar ato në shkak për urrejtje dhe armiqësi.



Nga shembujt më unikë të kësaj gjendjeje është Ebu Bekri رضي الله عنه. Ebu Bekri ndihmonte një sërë njerëzish të varfër. Midis tyre ishte edhe një person me emrin Mistah, të cilit Ebu Bekri رضي الله عنه, ia preu ndihmën, për shkak se ishte njëri nga ata që kishin trilluar shpifje për Aishen رضي الله عنها, bashkëshorten e nderuar të Pejgamberit صلى الله عليه وسلم dhe njëkohësisht vajzën e Ebu Bekrit رضي الله عنه. Për më tepër, u betua që nuk do ta ndihmonte më kurrë atë njeri. Si mundet një njeri të trillojë gjithfarë shpifjesh për vajzën e një personi, i cili i është gjendur pranë për çdo problem? Si mundet një njeri të shpifë kaq rëndë për bashkëshorten e nderuar të Pejgamberit صلى الله عليه وسلم?

Por Allahu nuk e miratoi këtë vendim të Ebu Bekrit dhe urdhëroi që ndihma ndaj personit që shpifi ndaj Aishes رضي الله عنها, vajzës së tij të mos ndërpritej.

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur midis jush të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është falës e mëshirëplotë.” (Nur, 22)

Pas zbritjes së ajetit, Ebu Bekri tha: “Natyrisht që unë dëshiroj faljen e Allahut.” Pas shlyerjes së betimit, Ebu Bekri e vazhdoi ndihmën për Mistahun. (Buhari, Megazi, 34; Muslim, Tevbe, 56)

Çfarë besimi, çfarë dashurie dhe çfarë nënshtrimi është ky që bën të mundur të falësh një njeri, i cili ka trilluar shpifje për familjen tënde?

Vajza ndaj së cilës është trilluar është nëna e besimta-



rëve, bashkëshortja e Pejgamberit ﷺ, vajza e shokut më të ngushtë të Pejgamberit ﷺ dhe e familjes më të ndershme të ymetit.

Megjithë ato arsye të forta për t'ia ndërprerë ndihmën, sahabiu i nderuar e besnik Ebu Bekri ؓ, dëshmoi besnikërinë dhe sinqeritetin në besimin e tij duke iu nënshtruar plotësisht vullnetit të Allahut.

Prandaj, në momentin që deklarojmë: **“Amentu billahi / besoj Allahun”**, duhet të veprojmë dhe jetojmë sipas saj. Sprovave të ndryshme hyjnore, me të cilat mund të përballlemi në jetë duhet t'u përgjigjemi sipas kritereve të imanit. Duhet të strehohemi gjithmonë tek mëshira, dhembshuria dhe ndihma e Allahut.

O Zot, mos na sprovo përtej fuqisë në këto ditë ku mbajtja e besimit në zemër është më e vështirë se mbajtja e thëngjillit. O Zot, na fal dhe na përfshij në mëshirën Tënde të pakufishme. Ti je shpëtimtari ynë. Sa mik dhe ndihmës i mirë je!

Amin...!





Begatia e devocionit dhe sinqeritetit



Devotshmëria është mësuesi më i mirë dhe udhërrëfyesi më i sigurt. Devotshmëria duket qartë në të drejtë dhe në shtrembër, në të mirë dhe në të keqe. Me devotshmërinë merret rruga e miqësisë për tek Allahu. Si pasojë e kësaj devotshmërie dhe miqësie, Allahu i bëhet robit të Tij, syri me të cilin shikon, veshi me të cilin dëgjon dhe zemra me të cilën kupton.



BEGATIA E DEVOCIONIT DHE SINQERITETIT

Vetitë më të rëndësishme që i japin kuptim dhe vlerë jetës së besimtarit janë sinqeriteti dhe devotshmëria. Sepse përmes devotshmërisë dhe sinqeritetit arrihet kulmi i adhurimit dhe robërimit ndaj Allahut, i cili është shkaku dhe qëllimi i ekzistencës së njeriut.

Devotshmëria është frenimi i epsheve dhe zhvillimi i aftësive shpirtërore. Pra, dëshira e vetme e besimtarit është fitimi i dashurisë dhe miqësisë me Allahun e Lartësuar.


Udhërrëfyesi më i rëndësishëm i besimtarit është devotshmëria. Në lidhje me këtë Allahu urdhëron në Kuran:

“...Bëhuni të devotshëm me Allahun, në mënyrë që t’ju mësojë.” (Bekare, 282)

Devotshmëria është mësuesi më i mirë dhe udhërrëfyesi më i sigurt. Devotshmëria duket qartë në të drejtë dhe në të shtrembër, në të mirë dhe në të keqe. Me devotshmërinë merret rruga e miqësisë për tek Allahu. Si pasojë e kësaj devotshmërie dhe miqësie, Allahu bëhet syri i robit me të cilin shikon, veshi i tij me të cilin dëgjon dhe zemra e tij me të cilën kupton.



Ata që arrijnë këtë gjendje, gjatë gjithë jetës janë të vetëdijshëm për natyrën provokuese të jetës tokësore. Ata e konsiderojnë jetën e kësaj bote si shkollë sprovash. Zemrat e tyre janë të mbushura me dashurinë ndaj Allahut. Pasuria dhe jeta e tyre është thjesht një mjet për të arritur dashurinë e Allahut. Këta shijojnë kënaqësinë e vërtetë të besimit. Shërbimi ndaj Allahut dhe robërve të Tij shndërrohet në stil jetese dhe bëhet qëllimi dhe kënaqësia më e madhe e jetës së tyre.

Një nga personalitetet e historisë sonë, që e ka përjetuar këtë gjendje është edhe Javuz Sulltan Selimi. Sulltani i gjashtë i dinastisë osmane, Sulltan Selimi në një periudhë gjashtëvjeçare, në të cilën qëndroi në pushtet, la gjurmë të paharrueshme, jo vetëm në historinë 620 vjeçare të historisë osmane, por edhe në 1400 vjet të historisë islame në përgjithësi. Sulltan Selimi me zgjuarsinë dhe herë-herë me rreptësinë dhe ashpërsinë e tij, sikur na kujton Omer ibn Hatabin .

Ky muxhahid i madh, për të siguruar unitetin e botës islame organizoi disa ekspedita të suksesshme ushtarake, duke përfshirë brenda kufijve të perandorisë Sirinë, Jordaninë, Palestinën, Egjiptin dhe Arabinë Saudite. Në këtë mënyrë, ai fitoi titullin Kalifi i parë i historisë Osmane.

Kur imami në hutbe iu referua si sunduesi i dy vendeve të shenjta, e kundërshtoi menjëherë duke thënë:

“Jo, jo!.. Përkundrazi, unë jam shërbyesi i dy vendeve të shenjta.” Kështu e shprehu Sulltani nderimin e vet kundrejt vendeve të shenjta.



“... Kush është i devotshëm ndaj Allahut, Allahu i jep rrugëzgjdhje për çdo gjë.” (Talak, 2)

Siç kuptohet lehtësisht nga ajeti, në themel të fitoreve dhe sukseseve të Sulltan Selimit qëndron devotshmëria. Si pasojë e begatisë së sinqeritetit dhe devotshmërisë ndaj Allahut, Sulltan Selimit në shumë çështje të rëndësishme dhe jetike i është gjendur pranë ndihma dhe frymëzimi hyjnor. Ndodhia historike që do të tregojmë më poshtë është shembulli më i mirë i kësaj gjendjeje shpirtërore sublime të Sulltan Selimit.



Pas fitores që korri kundër memlukëve në betejën Merxhidabëk më 1516, Sulltan Selimi vendosi të hynte në Egjipt për të fshirë përfundimisht nga historia shtetin memluk, i cili ishte bërë qendra e intrigave në botën islame. Por, para se të nisej për në Egjipt, qëndroi 3 muaj në Zonën e Shamit. Gjatë kësaj periudhe u angazhua me riorganizimin e sistemit administrativ të zonës, me pritjen e delegacioneve nga vendet fqinje të Shamit dhe në vizitat e vendeve historike të Shamit.

Por shkak u kryesor i qëndrimit në Sham ishte krejt tjetër. Sipas një transmetimi, Ai e kishte vënë gjithë potencialin e tij në përmbushjen e një profecie të dëgjuar në Stamboll. Thelbi i kësaj profecie ishte zbulimi i varrit të Muhjiddin Arabiut, i cili rezultonte i zhdukur prej kohësh. Dijetarët në Stamboll, shprehjen në veprat e Ibn Arabiut: “Kur Sin-i të hyjë në Shin do të gjendet varri im”, (kur shkronja “S” të hyjë në shkronjën “Sh” do të gjendet varri im), shkronjën “S” e



kishin interpretuar si simbol të emrit Selim, kurse shkronjën “Sh” si simbol të Shamit. Duke u bazuar te ky interpretim, e kishin informuar Sulltan Selimin se pikërisht ai do të ishte personi që do të gjente varrin e Ibn Arabiut.

Sulltan Selimi këtë e kishte mbajtur të fshehur edhe prej njerëzve më të afërt të tij. Gjatë kohës që ishte në Sham, herë pas here, duke u maskuar me rroba të vjetra hynte midis popullit për të mbledhur informacion mbi vendndodhjen e varrit. Por, megjithëse kaluan tre muaj Sulltani nuk arriti të siguronte një informacion të saktë për vendndodhjen e varrit. Kjo krijoi një gjendje të mërzitshme tek Sulltan Selimi, sepse ai dëshironte të nisej sa më parë për në Egjipt për t’i dhënë fund përfundimisht dinastisë memluke. Prandaj vendosi të dilte për herë të fundit në qytet me shpresën për të gjetur ndonjë informacion për vendndodhjen e varrit.

Ndërsa shëtiste midis njerëzve pa rënë në sy, dalloj një hamam dhe u nis drejt tij për t’u freskuar.

Kur hyri në hamam nuk gjeti askënd përveç një plaku që lahej në një qoshe të hamamit. Edhe Sulltan Selimi filloi të lahej në një cep tjetër të hamamit. Në ato momente plaku filloi të godiste tasin e hamamit në havuzin e mermerit. Ky veprim ishte një sinjal për të thirrur shërbyesit. Megjithëse plaku vazhdoi për një kohë të godiste tasin për të sinjalizuar shërbyesit, askush nuk po vinte. Sulltan Selimi mendoi t’i shkonte në ndihmë të moshuarit.

- Xhaxha! Me sa kuptoj po jep sinjal për të thirrur shërbyesit apo jo?

- Po, biri im, ata po thërras.



- Nëse më lejon, të shërbej unë.

- Shumë faleminderit.

Sulltan Selimi u ngrit dhe filloi t'i shërbente të mos-huarit të panjohur.

- Xhaxha! Megjithëse për minuta të tërë u përpoqe të thërrasësh dikë për të të shërbyer, askush nuk t'u përgjigj, kjo tregon se në rini nuk ke ndihmuar dhe nuk i je gjendur askujt pranë

- Shiko! Në trupin tënd gjenden shtatë nishane. Dëshiron t'i tregoj?

Sulltan Selimi mbeti i shtangur dhe i mahnitur nga kjo. Por plaku vazhdoi më tej:

- Megjithë atë personel dhe me gjithë ato thirrje që bëra unë nuk u përgjigj askush, por vjen dhe përgjigjet gjithë ai Sulltan. A do të mund të ndodhte një gjë e tillë, po të mos i kisha shërbyer kujt në rini?

Sulltani i kërkoi ndjesë menjëherë, sepse e kuptoi gradën e lartë shpirtërore të njeriut në fjalë. Pastaj e pyeti:

-Mirë që e kuptove se unë jam Sulltan, por si e gjete që kam shtatë nishane në trup?

- Nëna juaj ishte një grua e bekuar, e cila tani po pushon përjetësisht pranë xhamisë së Trabzonit. Iu bëftë vendi xhennet. A nuk ke dëgjuar prej saj se ditën që ke lindur ka ardhur një njeri i urtë që i ka dhënë lajmin e mirë të lindjes së një djali, i cili do të ketë shtatë nishane, do të bëhet sulltan dhe do të fshijë shtatë shtete? Ndërsa njeriu i urtë jepte këtë



sihariq, ti ishe duke lindur. A nuk e ke dëgjuar prej nënës këtë ngjarje?

-Po, kam dëgjuar për këtë në fëmijëri, por kisha harruar. Nëna më thoshte shpesh mëso, puno shumë, sepse ti do të marrësh përgjegjësitë e ymetit mbi vete.

Sulltan Selimi ishte i merakosur për sa i përket kalimit të shkretëtirës së Sinasë. Duke qenë se kishte pranë një njeri i cili ishte në gjendje të shikonte nga syri i zemrës, mendoi ta pyeste.

-Zotëri! Është e qartë që ju jeni njeri zemre apo ndoshta edhe vetë Hidri عليه السلام. Unë dëshiroj këshillën tënde në lidhje me iniciativën time për të kaluar ushtrinë mospërmes shkretëtirës së Sinasë, a do të ketë sukses?

- Do të jap dy lajme të mira në lidhje me këtë çështje. Dhe vazhdoi:

-Vazhdoni rrugën pa asnjë lloj ndrojtjeje, sepse pa hyrë në shkretëtirë do të bjerë një shi, i cili do t'ju lehtësojë udhëtimin. Ushtarët dhe topat do të kalojnë pa asnjë lloj vështirësie nëpër shkretëtirë. Sepse Pejgamberi ﷺ, së bashku me katër kalifët do të ecin para teje.

-A do të mund t'i shikoj unë Ata?

-Ti do t'i shikosh kështu siç më shikon mua tani, zbrit nga kali dhe në shenjë respekti ndiqi në këmbë. Ky ishte lajmi i parë. Ndërsa i dyti, kur të marrësh Kajron, do të të dorëzohen amanetet e shenjta të historisë islame. Dy nga këto amanete mbajnë sihariqe për ty. Njëra është një stemë e vjetër egjiptiane, mbi të cilën shkruhet se ti do të



marrësh përgjegjësinë e kalifatit. Prandaj, në Kajro do të hysh si fitimtar!.. Merre stemën dhe dërgoje në Stamboll së bashku me amanetet e tjera. Një amanet tjetër që do të të dorëzohet ty është edhe shpata e Davutit سيف داود. Kjo shpatë është një metër e gjatë dhe në njërën anë të dorezës është vizatuar një shpatë, kurse në anën tjetër një njeri që mban në dorë një kokë të prerë. Ajo figurë të simbolizon ty. Ngjitur me dorezën është një pllakëz mbi të cilën është shkruar një shprehje në gjuhën arabe, e cila profetizon qartë triumfin tënd mbi Egjiptin dhe marrjen e titullit shërbyesi i dy vend-eve të shenjta, Mekës dhe Medinës.

Sulltan Selimi, i habitur nga fjalët e plakut harroi shkakun e vërtetë për të cilin doli. Por plakun nuk vonoi dhe e pyeti:

-Ti kërkon edhe diçka tjetër, por më duket se harrove. Sapo Sulltan Selimi po bëhej gati për ta pyetur për varrin, plakun i tha:

-Nuk është e nevojshme biri im, tani do të të jap përgjigje për atë që të mundon. Kthehu në rezidencë dhe jep urdhër që të priset ky hamam, sepse pikërisht këtu nën hamam gjendet varri i Ibn Arabiut.

Sulltan Selimi e kapi për dore plakun dhe filloi t'i puthte dorën, kur papritur vuri re se plakun ishte zhdukur. Sulltan Selimi nuk po e kuptonte, ishte në ëndërr apo zgjuar. Menjëherë u kthye në rezidencë dhe dha urdhër për prishjen e hamamit. Dhe pikërisht nën hamam u shfaq varri i Ibn Arabiut. Sulltan Selimi urdhëroi që në vend të hamamit të ndërtohej tyrbja e Ibn Arabiut.



Pas kësaj, Sulltan Selimi dha urdhër për t'u nisur për në Egjipt. Shkuarja në Egjipt ishte një domosdoshmëri strategjike, por për të kaluar në Egjipt më parë duhej kaluar shkretëtira e egër dhe e rrezikshme e Sinasë. Por Sulltan Selimi arriti ta kalojë shkretëtirën për dhjetë ditë pa asnjë humbje jete, kurse Napoleon Bonaparti, i cili konsiderohet si një nga strategët më të mëdhenj të kohës, plot tre shekuj mbas Sulltan Selimit, nuk arriti ta kalonte këtë shkretëtirë.

Por vezirët dhe ushtarët kishin dyshime për kalimin me sukses të kësaj shkretëtire të rrezikshme. Ditën temperaturat arrinin plus 40 gradë, kurse natën midis minus 20 dhe 50 gradë.

Sulltan Selimi, i vendosur në vendimin e tij, hyri në shkretëtirë dhe pas një kohe zbriti nga kali dhe filloi të ecte në këmbë. Ushtarët u habitën dhe pyesnin njëri-tjetrin përse ecte në këmbë Sulltani.

Përballë kësaj gjendjeje edhe ushtarët vendosën të ecnin në këmbë si komandanti i tyre. Vezirët i kërkuan Hasan Xhanit, shokut të ngushtë të Sulltanit, të pyeste Sulltan Selimin për shkakun e ecjes në këmbë në këto kushte. Kur Hasan Xhani e pyeti Sulltanin për shkakun, përgjigjja ishte:

“Hasan! A nuk e shikon se përpara nesh po ecën i Dërguari i Allahut? Ndërsa Ai ecën në këmbë, si mund të ecim ne hipur në kalë ?..”

Shkretëtira u kalua me sukses dhe Egjipti u çlirua përfundimisht prej dinastisë memluke. Por Sulltan Selimin e lëndoi shumë rënia dëshmor e Sinan Pashës, i cili dha një




kontribut të madh në çlirimin e Egjiptit. Humbja e Sinan Pashës e detyroi Sulltan Selimin të thoshte:

“Morëm Egjiptin, por humbëm Sinanin...”

Hyrjen e Sulltan Selimit në Egjipt historianët e përkruajnë kështu:

“Populli kishte dalë në rrugë për të parë madhështinë e Sulltanit. Ata imagjinonin një sulltan krejt ndryshe. Mendonin se Sulltani do të hynte në qytet gjithë madhështi, por ai përkundrazi, qëndronte midis njerëzve duke ecur gjithë modesti.”

Kjo është një nga tablotë e shumta të atyre që kanë arritur pjekurinë shpirtërore përmes devotshmërisë që kanë treguar ndaj Allahut. Sulltan Selimi mbërriti në lagjen periferike të Stambollit në mesditë, së bashku me 80 mijë ushtarë. Kur i erdhi lajmi se populli ishte përgatitur për ta pritur në mënyrë madhështore urdhëroi ushtrinë të priste në hyrje të qytetit, deri sa të errësohej dhe njerëzit të shkonin nëpër shtëpi, sepse ai frikësohej se duartrokitjet e njerëzve mund t'i errësonin zemrën dhe ngjallnin egon. Një nga shembujt e fundit të gjendjes shpirtërore të këtij Sulltani është në shtratin e vdekjes, megjithëse dëshira e tij ishte të binte dëshmor në fushën e betejës. Allahu e kishte caktuar të ndahej nga kjo jetë në shtratin e vdekjes porsì Halid ibn Velidi . Kur shoku i ngushtë Hasan Xhani i tha se tani kishte ardhur koha për t'u takuar me Allahun, Sulltan Selimi iu përgjigj:

“Miku im i dashur! Me kë pandeh se isha deri tani?” Në këtë mënyrë shprehu besimin, sinqeritetin dhe devotshmërinë ndaj Allahut në çastet e fundit të jetës.



O Zot! Na mundëso të jetojmë një jetë të singertë dhe të devotshme. Na bëj të mundur të adhurojmë deri në fund të jetës. Na bëj të mundur të dalim para Teje si myslimanë dhe na e lehtëso rrugën drejt Teje!

Amin...!





Elementët e çelësit të Tevbidit



Kalifi i famshëm për asketizmin, Omer ibn Abdulazizi, e shpreh thjeshtësinë dhe modestinë e tij në një nga këshillat tij: “Bëjeni përgatitjen për Ditën e Kiametit sipas vendit që dëshironi të shkoni.”

Harrimi i vdekjes është harrim i vetvetes, është rrënim i së ardhmes. Por të mos harrojmë që zemra është si kuti postare, që pret lajmin e vdekjes nga posta hyjnore.



ELEMENTËT E ÇELËSIT TË TEVHIDIT

Bejazit Bistami i nxiste nxënësit për vepra të mira dhe i këshillonte të qëndronin larg veprave të këqija. U kërkonte të mos ndaheshin nga veprat e mira, si rruga më e mirë për të shfrytëzuar jetën në këtë botë.

Një ditë, njëri nga nxënësit i tha:

- Mësues i dashur! Pejgamberi ﷺ, ka thënë që fjala “*La ilahe il-lallah*” është çelësi i xhenetit. Atëherë përse na mundon, na vështirëson rrugën për në xhenet?

Bejazit Bistami:

- A ke parë ti ndonjëherë çelës pa dhëmbë?

Nxënësi:

- Jo nuk kam parë! Normalisht që çdo çelës i ka dhëmbët sipas kyçit të cilin hap ose mbyll.

Bejazit Bistami:

-Në të njëjtën mënyrë edhe Tevhidi ka dhëmbët e vet, pa të cilët dera e xhenetit nuk hapet. Katër janë dhëmbët më të rëndësishëm të Tevhidit.



ELEMENTI I PARË I TEVHIDIT ËSHTË:

Pastrimi nga çdo lloj gënjeshtre, përgojimi dhe thashethemi, duke e mbajtur gjuhën të njomë me leximin e Kuranit, përmendjen e Allahut dhe bekimet mbi Pejgamberin ﷺ.

“Ata të cilët shmangen nga fjalët e kota.” (Muminun, 3)

“(Kështu janë) edhe ata që nuk dëshmojnë në mënyrë të gënjeshtërt e, kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet.” (Furkan, 72)

Besimtari duhet të përpiqet të mos lëndojë zemrat e të tjerëve. Besimtari duhet të qëndrojë sa më larg të jetë e mundur nga përgojimi, sepse përgojimi është kancer i zemrës.

Kurani e ka konsideruar përgojimin si ngrënien e mishit të vëllait: “Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?!” (Huxhurat, 12) në një ajet tjetër: “Mjerë për çdo përqeshës – shpifës.” (Humeze, 72)

Kur Ferezdakut, poetit më të madh të epokës Umejadi i vdiq bashkëshortja, në ceremoninë e varrimit mori pjesë edhe dijetari i famshëm asket Hasan Basriu. Ai, duke e ditur që poeti kishte përqeshur njerëzit me poezitë e tij, i tha duke i bërë me shenjë nga varri:

-Çfarë ke përgatitur për ahiretin?

Poeti:

-Kam përgatitur shehadetin.

Hasan Basriu, pasi i tha sa mirë për ty në formë qor-



timi, e këshilloi me këto fjalë:

- Shehadeti ka kushte. Prandaj mos lëndo njeri dhe qëndro larg fjalëve shpotitëse, mos i nënvlerëso krijesat e Allahut dhe qëndro larg përgojimit!

Shkurtimisht, besimtari duhet të flasë fjalë të dobishme ose më mirë të heshtë.

ELEMENTI I DYTË I ÇELËSIT TË TEVHIDIT

Pastrimi nga zilia, lakmia, ambicia, dhënia mbas kësaj bote dhe çdo lloj ndjenje armiqësie e hakmarrjeje, duke e zbukuruar zemrën me ndjenja të bukura si: mëshira, dhembshuria dhe dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Nuk duhet të harrojmë që zilia, mburrja, mendjemadhësia, lakmia dhe ndjenja të tjera negative si këto, janë pengesë për hyrjen në xhenet. Sepse njerëzit, të ndotur me këto lloj cilësish negative, janë larg mëshirës së Allahut. Dhe për pasojë edhe larg xhenetit.

Kujt i është dhënë ndonjë e mirë në këtë botë të përkohshme, duhet ta dijë se ajo është borxh. Prandaj nuk duhet të mashtrohemi nga mirësitë e kësaj bote, por duhet të përpiqemi që zemra të jetë gjithmonë me Allahun. Dhënie pas kësaj bote, një i urtë e përshkruan kështu: *“Jeta e atyre që jetojnë nën sundimin e dëshirave i ngjason pirjes së ujit të detit, prej të cilit, sa më shumë të pihet, aq më shumë shtohet etja. Zemra që zhytet pas kënaqësive të kësaj bote, nuk bën gjë tjetër veçse largohet nga Krijuesi i saj.”*



Lakmia dhe etja e pushuar për të fituar pasuri e çon njeriun drejt fitimit të pasurisë në mënyrë të padrejtë. Kurse ziliqari mbetet i privuar nga çdo lloj e mire.


Siç thotë edhe Imam Shafiu: “Njeriu më fatkeq është ai që mban në zemrën e vet urrejtje dhe zili.”

Kurse Rumi e shpreh kështu gjendjen e lakmitarit: “Sa peshq të sigurt në ujë, kanë rënë në grep për shkak të lakmisë.”

Në të vërtetë, peshku gënjehet nga karremi në majë të grepit, kurse grepin vdekjeprurës për të nën karrem nuk e shikon. Kështu është edhe gjendja e atyre që mashtrohen pas mirësive të kësaj bote, duke harruar botën e amëshuar.

Pra lakmia, zilia, urrejtja, babëzia, pangopësia janë sëmundje shpirtërore të cilat dëmtojnë thelbin e Tevhidit.

Prandaj Allahu në Kuran thotë: “**Kushdo që pastron shpirtin do të shpëtojë.**” (Shems, 9)

Osmani , thotë: “Pasioni për të fituar nga pasuritë e kësaj bote e shndërron zemrën në burg.”

ELEMENTI I TRETË I ÇELËSIT TË TEVHIDIT

Një stomak i ushqyer me ushqim hallall dhe i mbrojtur nga ushqimi haram dhe i dyshimtë.

Një nga faktorët që ndikon negativisht në zemër është ushqimi i fituar në mënyrë të ndaluar ose të dyshimtë. Ushqimi haram dëmton rëndë gjendjen shpirtërore të njeriut, duke



nxitur plotësimin e kënaqësive të shfrenuara. **“Hani nga ushqimet e mira e të pastra që ju kemi dhënë.”** (Araf, 160)

Ndikimin e ushqimit hallall dhe të pastër në gjendjen shpirtërore dhe fizike të njeriut, Rumi u shpreh kështu: “Ushqimi i fituar në mënyrë hallall shton dritën dhe ruhanijetin e personit.”

Ushqimi hallall mbron zemrën nga vrazhdësia dhe brutaliteti, prandaj besimtari nuk duhet ta ndotë në asnjë mënyrë zemrën me ushqim haram apo të dyshimtë.

Domosdoshmërinë e largimit nga ushqimi haram, Abdullah ibn Umeri e shpreh kështu:

“Nëse nuk largoheni nga ushqimi haram, Allahu nuk jua pranon ibadetin, edhe sikur të bëheni hark nga falja e namazit dhe tel i hollë nga mbajtja e agjërimit.”

Këtë thënie nuk duhet ta nxjerrim nga mendja për asnjë çast, largimi nga ushqimi hallall për një kohë qoftë edhe të shkurtër gjatë muajit të ramazanit, shërben për të treguar se sa të kujdesshëm duhet të jemi ndaj ushqimit haram. Pra, njeriut i kërkohet të bëjë kujdes në ushqimin hallall. Në lidhje me kujdesin e ushqimit hallall, Rumi thotë:

“Mos e ushqe shumë trupin me ushqime yndyrore dhe mjaltë. Sepse ai që ushqen tepër trupin bëhet pre e pasioneve dhe dëshirave epshore, duke humbur në këtë mënyrë dinjitetin dhe nderin. Shpirtit jepi ushqim shpirtëror. Ushqeje shpirtin me mendime të pjekura, me intuitë të hollë dhe ushqime shpirtërore.”



ELEMENTI I KATËRT I ÇELËSIT TË TEVHIDIT

Puno vetëm për hir të Allahut, duke u pastruar dhe qëndruar larg çdo lloj hipokrizie dhe servilizmi.

Allahu në vlerësimin e veprave tona shikon nivelin e sinqeritetit. I Dërguari i Allahut ﷺ, e shpreh kështu këtë të vërtetë: “*Veprat vlerësohen sipas qëllimeve.*” (Buhari, Iman, 41)

Qëllimet duhet të jenë për hir të Allahut, në mënyrë që të kenë vlerë tek Allahu, përndryshe të gjitha janë të refuzuara. Në një hadith Kudsî Allahu thotë: “*Refuzoj personin dh punën në të cilën më shoqërohet shok.*” (Muslim, Zuhd, 46.)

Omeri رضي الله عنه, thotë: “**Njeriu më injorant është ai që shet ahiretin për botën e tjetërkujt. Pra, që në vend të kënaqësisë së Allahut, vendos kënaqësinë e njerëzve.**”

Kurse Jahja ibn Muadh رضي الله عنه, jep këtë këshillë: “Kujdes nga dëmtuesit e imanit. Mos lejoni që syfaqësia dhe veset e këqija të shkatërrojnë besimin tuaj.”

Sepse syfaqësia, përgojimi, nënçmimi dhe vese të tjera të këqija shkatërrojnë veprat e mira.

Sadi Shirazi tregon një ngjarje personale të ndodhur në fëmijëri:

“Në fëmijëri isha shumë i dhënë pas jetës askete dhe namazit të natës. Një natë, kur po qëndroja me babain duke lexuar Kuran, përreth kishte njerëz që po flinin. I thashë babait:

- Baba! Të gjithë po flenë, askush nuk ngrihet për të



falur namaz nate, por flenë si të vdekur.

Babai u vërejt dhe tha:

- Biri im! Do ishte më mirë të flije edhe ti si ata, sesa t'i përgojoje. Ata mund jenë të privuar nga merhameti hyjnor në këto momente, por në të njëjtën kohë në librin e tyre nuk shkruhen mëkate kurse, në librin tënd tashmë u shkrua një mëkat.

Prandaj, për t'i ngritur veprat tona në Arshin e madhë-rishëm, duhet të qëndrojmë sa më larg nga mburrja dhe syfaqësia. Siç thotë Haxhi Bajram Veliu:

“Mburrja është si një gur i rëndë, i lidhur për beli, me të cilin as nuk mund të notosh dhe as nuk mund të fluturosh.”

Rumiu e përkufizon kështu gjendjen e pastrimit nga këto vese:

“Duhet ta djegësh egoizmin, nëse dëshiron të shndrisësh dhe ndriçosh.”



Pejgamberi ﷺ, në një hadith tregon:

“*Kush thotë La ilahe illallah hyn në xhenet.*” (Ebu Davut, Xhenaiz, 20)

Por ka shpjeguar edhe rrugën për të dhënë shpirtin me fjalën e Tevhidit në gojë, duke thënë:

“*Si të jetoni, ashtu do të vdisni dhe si të vdisni, ashtu do të ringjalleni.*” (Fejdul Kadir, V, 663)



Që Tevhidi të luajë rolin e çelësit të Xhenetit, duhet të jetohet një jetë në përputhje me atë që kërkohet prej tij. Prandaj fillimisht duhet të pastrojmë zemrën nga të gjitha ndjenjat negative dhe idhujt që janë në brendësinë tonë. Kuptimi i fjalës “La ilahe” në fillim të Tevhidit, është pikërisht ky, pastrimi i zemrës nga çdo lloj idhulli apo zoti tjetër, duke vendosur në të vetëm Allahun.

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?” (Furkan, 43)

Rumi në lidhje me këtë, thotë: “Çdo gjë përveç Allahut është e përkohshme. Nëse dëshironi të jeni të përjetshëm, mbështetuni tek Ai që është i përjetshëm.”

Ajeti kuranor na jep një mesazh shumë domethënës: **“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al ‘Imran, 102)

O Zot! Na bëj të mundur një jetë sipas modelit të Tevhidit dhe që fjala e fundit në çastin e vdekjes të jetë shehadeti...

Amin...





Realiteti njihet përmes të kundërtave



Muhamedi ﷺ, sikur të mos zotëronte asnjë mrekulli tjetër për të vërtetuar profetësinë, do t'i mjaftonte si mrekulli dhe vërtetim i profetësisë ndërtimi i personaliteteve shembullore të cilët do të nxirrnin nga një shoqëri injorante dhe primitive qytetërimin e virtyteve dhe shoqërinë më ideale që kishte parë ndonjëherë historia e njerëzimit. Pejgamberët nuk lënë pas trashëgimi materiale, trashëgimia e tyre është personaliteti dhe karakteri shembullor për brezat e ardhshëm.



REALITETI NJIHET PËRMES TË KUNDËRTAVE

Një ditë Symbyl Efendiu, i cili ishte një nga evlijatë e njohur të Stambollit, u bën këtë pyetje nxënësve të tij:

- Nëse të jepet mundësia për të ndryshuar botën çfarë do të kishe bërë?

Çdo nxënës kishte dhënë nga një përgjigje sipas horizontit dhe diapazonit të tij shpirtëror. Dikush kishte thënë:

-Do të zhdukja të gjitha të këqijat e kësaj bote.

Dikush tjetër:

- Do ta shndërroja botën në parajsë.

Dikush tjetër:

- Do të doja një botë, ku çdo problem të gjente zgjidhje dhe ku çdo sëmundje të gjente shërim, pra një botë pa probleme dhe sëmundje.

Pasi i dëgjoi të gjithë, Symbyl Efendiu vuri re se njëri nga nxënësit nuk dha asnjë përgjigje dhe e pyeti për shkakun:

- Biri im, po ti si mendon? Si do kishe dëshirë ta ndryshoje botën?

Nxënësi me emër Muslihiddin u përgjigj:



- Zotëri, unë nuk jam më i ditur dhe i urtë se Krijuesi i botës, unë thjesht jam një krijesë e dobët e Tij. Njeriu, nëse njuh vetveten, njuh më mirë Krijuesin. Nuk ka dyshim se në çdo gjë që Ai ka krijuar ka një urtësi. Unë për vete e kisha lënë çdo gjë ashtu siç është, duke u kënaqur me caktimin e Allahut.

Në një skenë teatri ku luhet vetëm një skenar, është më se normale, por nëse në një skenë teatri luhet tre skenarë, atëherë rolet ngatërrohen me njëri-tjetrin. Kurse në botën përreth, ku ekziston një numër i pafund krijesash, të cilat të gjithë luajnë rolin e vet duke i përngjasuar një teatri, nuk ndodh asnjë lloj kaosi, përkundrazi, çdo gjë luan rolin e vet në një harmoni të plotë. Çdo gjë në këtë botë është rregulluar në atë mënyrë nga Allahu i gjithëdijshëm, që të jetë shkak dhe mjet për falënderim, lëvdim, dhikër dhe bindje. Në krijimin e Tij nuk ekziston asgjë që të jetë krijuar pa qëllim dhe pa urtësi. Prandaj, ngjarjet të cilave nuk u jep dot një shpjegim racional, njeriu duhet t'i pranojë me bindje.

Njeriu është krijuar në atë mënyrë që çdo gjë e kupton përmes të kundërtave. Ngjyrat dallohen më lehtë nga njëra-tjetra, kur kontrasti midis tyre rritet. Ky realitet është i vlefshëm edhe për çështje materialo-shpirtërore.

Njeriu nuk mund të perceptojë të ftohtin pa ekzistuar i nxehti apo pa ushqimet e kripura nuk mund të kuptohen ushqimet e ëmbla. Mosvlerësimi siç duhet i shëndetit para sëmundjes, i rinisë para pleqërisë, kohës së lirë para kohës së zënë me punë vjen pikërisht nga ky fakt.

Si të gjitha këto edhe vlera e së mirës dhe së drejtës dallohet më lehtë përballë së keqes dhe padrejtësisë.



Prandaj Kurani jep shembuj të këqinj, si Faraoni dhe Nemruti, për të kuptuar më mirë dhe lehtë shembujt e mirë, siç janë profetët dhe veçanërisht Pejgamberi ﷺ.

Pra, çdo gjë në këtë botë fiton kuptim përmes të kundërtave. Është e pamundur të perceptohet diçka që nuk ka të kundërtën. Dhe një nga shkaqet e mosperceptimit të qenies së Allahut është mosekzistenca e të ngjashmit dhe të kundërtës së Tij.

Kur njeriu i qaset gjithësisë përmes urtësisë së besimit, çdo gjë në gjithësi fiton kuptim dhe vlerë, madje kupton që edhe e keqja nuk është pa vend dhe urtësi. Kur njeriu u qaset gjërave vetëm nga një këndvështrim, shumë gjëra duken të pakuptimta, por realiteti është krejt ndryshe, siç e tregon edhe Kurani në ajetin e mëposhtëm: **“Mund të urreni diçka, ndërkohë që ajo është e mirë për ju dhe mund të doni diçka, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** (Bekare, 216)

Prandaj, njeriu që kërkon të njohë të vërtetën nuk duhet t’u qaset gjërave vetëm sipas kriterëve të veta, por edhe sipas kriterëve hyjnore, sepse ka shumë gjëra të cilat kur maten me kriteret e kësaj bote duken si të pavlefshme, por në realitet janë shumë të çmuara.

Vejsel Karani e shpreh kështu ndërlidhjen dhe gërshehtimin e të kundërtave në fitimin e dashurisë së Allahut:

1- KËRKOVA RESPEKT, E GJETA NË MODESTI

Ajeti kuranor shprehet kështu: **“Robërit e të**



Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...”

(Furkan, 63)

Kurse një këshillë e vendosur në gojën e Idrizit عليه السلام, thotë: “Kur njeriut të mençur i rritet prestigji, i rritet edhe modestia.”

Kurse poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoj, e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Fara që nuk bie në tokë, nuk nxjerr filiz për t’u rritur, edhe mëshira e Allahut lartëson modestët, jo mendjemëdhenjtë.”

Mendjemadhësia, mburrja, vetëpëlqimi dhe kryelartësia shfaqen më shumë tek personat e pasur dhe me pozitë. Në fakt, të gjitha të mirat që i janë dhuruar njeriut janë si një thikë me dy presa, të cilat mund të përdoren si për mirë, ashtu edhe për keq. Në të vërtetë, madhështia e pasurisë dhe pozitës qëndron në kalimin e jetës larg koprracisë, shpenzimeve të kota dhe mendjemadhësisë, duke u mbështetur tek modestia dhe bujaria.

2- KËRKOVA POZITË E GJETA NË BAMIRËSI

“Zotëria i popullit është ai që i shërben atij.”

Rruga për t’u bërë i pari i një populli është shërbimi dhe bamirësia ndaj tij. Bamirësia zbut zemrat e vrazhda. Njeriu është i prirur t’i bindet plotësisht mirëbërësit. Sa e bukur është kjo shprehje e Osmanit عليه السلام: “Madhështia e pasurisë është falënderimi, kurse falënderimi është të bësh sa më shumë bamirësi.”



Kurse ajeti kuranor, masën e shpenzimit për bamirësi e shpreh kështu: **“Të pyesin ty çfarë duhet të të japin për bamirësi. Thuaju: ‘Tepricën’...”** (Bekare, 219)

3- KËRKOVA FISNIKËRI E GJETA NË DREJTËSI

“Qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je urdhëruar.” (Hud, 112)

“Kjo është dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre.” (Maide, 119)

Fisnikëria dhe trimëria e vërtetë qëndron në të qenët i drejtë. E drejta dhe e vërteta në disa raste kanë çmim shumë të shtrenjtë, por ata që besojnë në botën tjetër janë të gatshëm të paguajnë çfarëdo lloj çmimi për të mos devijuar nga e drejta dhe e vërteta. Njeriu mendon se mund të përfitojë shumë gjëra përmes gënjeshtërisë në këtë botë të përkohshme. Por nuk duhet harruar se këto në botën tjetër janë si fushë e minuar për personin.

Jeta e ndershme arrihet duke qëndruar afër të vërtetës dhe të drejtës.

4- KËRKOVA LAVDI E GJETA NË MOSQENIE

Pejgamberi ﷺ, e shprehte dobësinë dhe pafuqinë e vet duke u strehuar dhe kërkuar falje nga Allahu. **“O Zot! Nuk të njoha Ty siç duhet, nuk munda të të adhuroj siç duhet.”**



Edhe ne si pasues të Muhamedit ﷺ, nuk duhet ta shikojmë mjaftueshëm adhurimin dhe falënderimin tonë ndaj Allahut për mirësitë dhe begatitë e dhuruara.

Prandaj duhet të kalojmë një jetë në lutje të vazhdueshme ndaj Allahut.

5- KËRKOVA FAMË E GJETA NË DEVOTSHMËRI

“...bëhuni të devotshëm, Allahu ju mëson ju...”

(Bekare, 282)

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (Huxhurat, 13)

Nuk ka asnjë dyshim se fisi më i nderuar në botë është fisi që rrjedh nga familja e Pejgamberit ﷺ, por devotshmëria është një veti që e bën njeriun pjesëtar të familjes më të fisme në botë, e bën atë pjesë të Ehli Bejtit.

Selman Farisiu ekspozoi një gjendje morali aq të vyer, sa që ensarët dhe muhaxhirët nuk dëshironin ta ndanin midis tyre. Secili grup e pretendonte si të vetin Selman Farisiun. Përballë kësaj situatë, Pejgamberi ﷺ, në shenjë vlerësimi dhe komplimenti tha: *“Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit.”*

Përveç atyre që janë trashëgimtarë biologjikë të drejtpërdrejtë të Pejgamberit ﷺ, nderin për të qenë pjesëtarë të Ehli Bejtit e kanë edhe ata që ndjekin rrugën e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe kapen fort pas devotshmërisë. Kushti i vetëm për të fituar këtë privilegj është “devocioni”. Vlera e vërtetë e njeriut matet nga devotshmëria që ekspozon para



Allahut, jo nga pasuria, pozita dhe fama në këtë botë.

Devotshmëria është arti i adhurimit ndaj Allahut dhe zbukurimit me moralin e Pejgamberit ﷺ.

6- KËRKOVA RESPEKT, NDERIM, KRENARI DHE E GJETA NË MJAFTUESHMËRI.

Në hadithe thuhet:

“Të qenët i kënaqur me atë që ke, është thesar i pashtershëm.” (Dejlemi, III, 236/4699)

“Nëse dëshiron dashurinë e Allahut, mos e lidh zemrën me këtë botë dhe, nëse dëshiron të jesh i dashur midis njerëze, mos kërko gjë prej tyre.” (Ibn Maxhe, Zuhd, 1)

“...Nderi i besimtarit është në qëndrimin natën në namaz, kurse krenaria në të mospasurit nevojë për njerëzit.” (Hakim, IV, 360-361/7921)

Shumë njerëz, megjithë pasurinë e madhe që kanë, përsëri janë të babëzitur. Sikur t’u jepet e gjithë bota, do t’i hedhin sytë nga hëna, duke thënë: “Sikur të kisha edhe një pjesë nga hëna.” Pejgamberi ﷺ, njerëzit e pangopur i përshkruan kështu: *“Në qoftë se i biri i Ademit do të kishte një luginë me flori, do të dëshironte të kishte dy lugina. Mirëpo, gojën e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut. Allahu ia pranon pendesën atij njeriu që pendohet”* (Buhari, Rikak, 10)

Pra njeriun e lartëson ndjenja e mjaftueshmërisë me atë që ka, sepse, edhe sikur t’i jepet e gjithë pasuria e kësaj bote, në Ditën e Gjykimit ajo nuk mund t’i bëjë asnjë lloj dobie atij.



7- KËRKOVA QETËSI DHE E GJETA NË THJESHTËSI

Ajeti kuranor e formulon kështu sekretin e qetësisë së njeriut: **“Vërtet zemrat gjejnë qetësi vetëm përmes përmendjes së Allahut.”** (Rad, 28)

Jeta askete konsiston në shfrytëzimin e mirësive të kësaj bote pa e lidhur zemrën me to. Nëse do shpreheshim ndryshe, asketizmi shpreh lirinë duke mos u bërë rob i pasurisë së kësaj bote. Rumi, i cili e ka krahasuar njeriun me një anije që lundron në detin e pasurisë, shprehet kështu:

“Nëse deti është nën anije, bëhet mbështetës dhe bën të mundur lundrimin e anijes pa u mbytur, por nëse dallgët hyjnë në anije, atëherë e fundosin atë.”

“Lakmia pas kësaj bote është të jesh i shkujdesur ndaj Krijuesit dhe jo të heqësh dorë nga pasuria, nga familja dhe begatitë e tjera të kësaj bote.”

Zemrat e besimtarëve nuk gjejnë kënaqësi më të madhe sesa ndjenja e pranisë së Allahut në zemrat e tyre. Zemrat e atyre që jetojnë të shkujdesur ndaj Allahut janë gjithmonë të trishtuara dhe të brengosura. Pasuria dhe kënaqësitë e kësaj bote, me të cilat përpiqen të ngushëllojnë veten, nuk u siguron atyre asnjë lloj qetësie shpirtërore dhe psikologjike. Terapia e zemrës së vrazhdë është konsiderimi i pasurive dhe begatitë të kësaj bote si mjet për të fituar dashurinë e Allahut dhe jo si qëllim në vetvete. Kjo bën të mundur pastrimin e zemrës nga dashuria për këtë botë duke e përgatitur vetëm për dashurinë e Allahut.



Lumturia është e fshehur në refuzimin e kënaqësive epshore. Abdurrahman ibn Auf e shpreh kështu këtë realitet: “Islami ka obliguar disa urdhëresa të vështira, që nuk i pëlqejnë njeriut. Ne, më të mirën e të mirave e gjetëm pikërisht në këto urdhëresa të vështira. Ne emigruam me Pejgamberin ﷺ. Largimi nga vendlindja ishte shumë i vështirë për ne, por Allahu na dhuroi fitore dhe privilegje me këtë veprim. Kurani tregon:

“Zoti yt të nxori nga shtëpia për të vërtetën, edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve. Ata polemizojnë me ty për të vërtetën, e cila u ishte bërë e qartë, sikur të ishin duke u çuar drejt vdekjes së sigurt.” (Enfal, 5-6) *Siç e tregoi edhe Kurani, kishim dalë me të Dërguarin e Allahut në luftën e Bedrit. Kjo ishte e vështirë për ne, por Allahu na dhuroi fitore. Mirësitë më të mëdha i kemi arritur përmes urdhëresave që njeriut i vijnë të vështira.”* (Hejthemi, VII, 26-27)

Allahu na bëftë prej njerëzve që kërkojnë vetëm dashurinë e Allahut në këtë botë. I lutemi Allahut të na ruajë nga zhytja në plotësimin e dëshirave të nefsit, duke injoruar botën e amëshuar. O Zot, na i mbush zemrat me iman dhe dhikrullah!

Amin!..







Kurani

libri i gjithësisë



Kurani është gjithësia e shprehur në fjalë, kurse gjithësia është shpjegim i Kuranit. Prandaj, ata që e kanë zemrën të lëmuar me Kuran, gjithmonë janë në gjendje reflektimi rreth gjithësisë. Kurani është begati për shpirtrat dhe furnizues i pashtershëm për ta. Kurani është një mrekulli e qartë dedikuar njeriut. Është dhuratë e Allahut për robërit e Tij.



KURANI, LIBRI I GJITHËSISË

Kurani është shprehje e mëshirës së madhe të Allahut për njerëzimin. Ai është një begati që nuk mund t'i përkufizohet vlera që ka për njerëzimin. Ky libër është udhërrëfyes për në xhenet, pishtar në errësirë, çelës për lumturinë dhe argument për çdo aspekt të jetës.

Kurani shpreh vullnetin hyjnor. Prandaj, çdo shkronjë e tij përmban njëmijë mrekulli dhe urtësi të fshehura. Tefsirët që shpjegojnë atë, në krahasim me përmbajtjen e vërtetë të Kuranit, janë si një pikë ujë në oqean. Nga kjo pikëpamje, njohuritë njerëzore nuk do të arrijnë kurrë të shprehin realisht përmbajtjen e Kuranit.

Allahu në Kuran urdhëron: **“Jini të devotshëm, që Allahu t’ju mësojë atë që nuk dini.”** (Bekare, 282) Allahu i mëson të devotshmit atë që nuk duket në rreshtat e Kuranit.

Lidhur me këtë veçori të Kuranit të Shenjtë, dëshirojmë të përmendim një ngjarje historike.

Një diplomat anglez, në një takim me Said Halim Pashën, kryeministrin e atëhershëm, ndër të tjera i bën një pyetje të tillë:



“Shkëlqesia juaj! Myslimanët pretendojnë vazhdimisht se të gjitha të vërtetat dhe, në këtë mes, të vërtetat e shkencave të natyrës, ndodhen në Kuran, mirëpo nuk nxjerrin nga Kurani e të na e tregojnë ndonjë të vërtetë para se ta zbulojmë ne, perëndimorët. Dhe mua më rri vazhdimisht mendja në këtë! Ç’thoni ju vallë, për këtë? A është kështu apo jo?”

I rritur në Egjipt, njohës i mirë i arabishtes, njohës i mirë edhe i Islamit ashtu siç e kërkonte koha, Said Halim Pasha i bëri një shpjegim diplomatit, por shpjegimi i tij nuk e kënaqi diplomatin anglez. I mërzitur nga kjo situatë, kryeministri Halim Pasha telefoni në parlament dhe kërkoi t’i dërgonin urgjentisht në kryeministri ndonjërin prej dijetarëve të shumë fetarë që ndodheshin atje. Dhe pasi edhe përgjigjet dhe shpjegimi i dijetarit nuk e kënaqën diplomatin anglez, Said Halim Pasha iu lut diplomatit të priste deri të nesërmen për përgjigjen, kurse dijetarit që erdhi nga parlamenti i tha:

“Ti je dijetar fetar! Edhe dijetarët e tjerë i njeh më mirë se unë! Kërko mes tyre atë i cili është më i aftë të bëjë një shpjegim, në mënyrë që të mbesë i kënaqur miku anglez.”

Hoxha u ngrit e shkoi për këtë punë në fshatin Reshadije të qytetit Jalova, ku banonte Hirësia Sheh Sherafeddini nga shehlerët Nakshi. Sheh Sherafeddini, së bashku me Sheh Shamilin i përkisnin grupit që kishin ardhur dhe ishin vendosur në Turqi. Meqë sulltan Reshadi ua pati dhënë atyre truallin-pronë shtetërore në fshatin ku qenë vendosur, fshati u mbiquajt Reshadije (sot Fshati i Jugut). Sheh Sherafeddin



Efendiu u burgos për një farë kohe pas ngjarjes “Menem” të vitit 1930 dhe mori pafajësinë. Pasi e mësoi nga hoxha, situatën dijetari fetar që i shkoi për vizitë, e mbajti mikun atë natë në shtëpi dhe të nesërmen në mëngjes, menjëherë pas namazit të agimit, hipën të dy në një pajton dhe në mesditë, arritën në kryeministri. Diplomati anglez u thirr sërish në kryeministri, iu kërkua ta përsëriste pyetjen dhe Sheh Sherafeddin Efendiu, pasi i dëgjoi ato që ishin thënë, siç i përshkruam më lart, i tha kështu diplomatit anglez:

“Po, në Kuranin e Shenjtë janë të pranishme të gjitha zbulimet e shkencave të natyrës që do të ndodhin gjer në Kiamet.

Sepse ai është “Libri i Universit”! Edhe ajo që thoni ju përëndimorët se asnjë mysliman nuk i nxjerr nga Kurani për t’i treguar këto zbulime para se t’i bëni ju, është e vërtetë. Mirëpo kjo ka tri shkaqe, dy nga të cilat mund t’jua them, kurse të tretën, jo, sepse i kalon kufijtë e etikës së bisedës diplomatike meqë është kundër jush!”

Por pasi diplomati anglez nguli këmbë që t’i dëgjonte të tri shkaqet, Hirësia Sheh Sherafeddini tha:

“Prekja dhe trajtimi i të vërtetave të shkencave të natyrës në Kuran bëhet në aspektin argumentues dhe jo shtjellues, pra, ato preken thjesht si argumente, jo si shtjellime. Shkaku i parë i kësaj është se, po qe se këto të vërteta do të merreshin dhe shtjelloheshin, vëllimi i Kuranit do të zgjerohej aq shumë, saqë mësimi i tij përmendsh do të bëhej i pamundur. Mirëpo është pikërisht mësimi përmendsh që e ka ruajtur Kuranin praktikisht nga ndryshimi që kanë pësuar të gjithë



librat e tjerë qiellorë. Në një kohë kur shkrimi nuk ishte i përhapur, vetëm në këtë mënyrë mund të parandalohesh ndërhyrja në të.”

“Eh, ...” - tha diplomati anglez, duke u treguar se s’kishte mbetur fort i kënaqur. Sheh Sherafeddini vazhdoi:

“Por nuk është ky shkak u esencjal. Po qe se Kurani, vlefshmëria e të cilit gjer në Kiamet është domosdoshmëri hyjnore, do t’i kishte prekur dhe trajtuar të vërtetat e shkencave të natyrës me rrugën e shtjellimit, për shekuj me radhë, për shkak të nivelit të përparimit shkencor dhe teknologjik të kohës së tyre, shumica e myslimanëve nuk do t’i kishin pranuar ato dhe do të kishin dalë nga besimi. Kurse besimtarëve që i kuptojnë ajetet që argumentojnë të vërtetat e kohës së vet pasi të jenë provuar, përkundrazi, u forcohet besimi!”

Pastaj, sado që Sheh Sherafeddin Efendiu i kërkoi diplomatit ta shihte të justifikuar që nuk do t’ia parashtronte shkakun e tretë, sepse e konsideronte në kundërshtim me etikën, pas këmbënguljeve të diplomatit anglez, i tha kështu:

“Meqë Kurani i Shenjtë, për këto dy shkaqe që përmenda, i ka prekur të vërtetat e shkencave të natyrës jo me rrugën e shtjellimit, por të argumentit, jo çdokush mundet t’i kuptojë dhe t’i konceptojë ato. Por ka nga ata që i dinë dhe i njohin të vërtetat edhe pa i eksperimentuar ju, perëndimorët! Këta janë persona “të thelluar në dituri” dhe që i zotërojnë dituritë hyjnore po aq sa ato formale. Mirëpo, ata nuk e kanë të lejuar t’i thonë ato që dinë. Dhe kjo, jo vetëm për ta mbrojtur rregullin bazë të mbështetur në pari-



min sipas të cilit kjo botë është botë përpjekjeje, por, në të njëjtën kohë, edhe për të mos ju dhënë mundësi juve, perëndimorëve, ta përdorni çdo zbulim shkencor në mënyrë egoiste për qëllimet tuaja dhe në dëm të popujve të tjerë. Ne, pra, na është ndaluar të flasim, sepse atëherë ju nuk do të pengoheshit dot nga askush që ta njihnit çdo zbulim shkencor që do të nxirrej nga Kurani!”

Diplomati anglez e kundërshtoi këtë shpjegim duke e konsideruar thjesht si pretekst dhe, atëherë, kur Hirësia Sheh Sherafeddini e pa se do të ishte e pamundur të bindej ai, u detyrua të thoshte këto fjalë:

“Shih, ekselencë! Edhe unë jam nga ata që e njoh si një dhuratë hyjnore kafazin e të vërtetave të shkencave të natyrës, të cilat Kur’ani i prek vetëm si argumente. Po të dua, mund t’jua numëroj të gjitha zbulimet shkencore që kanë për t’u bërë gjer në Kiamet! Mirëpo kjo do të ishte vetëvrasje shpirtërore për mua! Por mund t’ju ofroj informacione të tjera mrekullore, me qëllim që ta pranoni këtë të vërtetë ashtu siç jua thashë!”

“Çfarë për shembull?”- pyeti diplomati anglez.

“Për shembull, mund t’jua përmend të parët tuaj gjer te Adami!”- tha Sheh Sherafeddini. Dhe, meqë diplomati e kundërshtoi një mundësi të tillë, Sheh Sherafeddini nisi t’ia përmendë diplomatit emrat e të parëve të vet një pas një drejt së shkuarës. Atëherë, diplomati e ndërpreu:

“Prit, një minutë! Ku i di ti këto? As unë s’e di se ç’kemi përtej shtatë brezave!”



Si përgjigje për këtë pyetje që kishte kuptimin e një pranimit të diplomatit për thëniet e tij, Sheh Sherafeddini vazhdoi:

“Unë mund t’jua përmend jo vetëm këta, por edhe të gjithë të parët tuaj si dhe të gjithë pasardhësit tuaj gjer në Kiamet!”

Dhe ia përmendi drejtpërdrejt diplomatit anglez një e nga një emrat e bijve dhe nipërve të gjallë si dhe të atyre që s’kishin lindur ende! Atëherë, diplomati, duke iu drejtuar kryeministrit, i tha:

“Shkëlqesia juaj! Unë ju kërkova një dijetar fetar, kurse ju më nxorët para një magjistar!”

Duke u shprehur kështu, diplomati iu shmang detyrimit për të besuar që, tashmë, ishte bërë diçka e logjikshme për të, dhe rasti i tij u bë edhe një shembull tjetër ilustrues i faktit se besimi varet nga vendimi hyjnor.

Kjo ngjarje historike është një shembull interesant që tregon se në ç’thellësira mund të hyjnë dija dhe vullneti njerëzor kur ndihmohen nga favori dhe bujaria hyjnore!

Siç e shprehu edhe ndodhia historike, Kurani është gjithësia e shprehur në fjalë, kurse gjithësia është shpjegim i Kuranit. Prandaj ata që e kanë zemrën të lëmuar me Kuran gjithmonë janë në gjendje reflektimi rreth gjithësisë. Kurani është begati për shpirtat dhe furnizues i pashtershëm për ta. Kurani është një mrekulli e qartë dedikuar njeriut. Është mrekulli dhuruar njerëzve.

Ashtu si fara ka nevojë për tokën për t’u bërë pemë



edhe njeriu për t'u bërë i arrirë ka nevojë për Kuranin. Pejgamberi ﷺ e ka përshkruar zemrën që është larg Kuranit, kështu:

“Personi që nuk ka në zemrën e tij sado pak Kuran është si një shtëpi e rrënuar.” (Tirmidhi, Fedailul- Kuran.)

Për të arritur kuptimet e larta të Kuranit dhe për t'i pasqyruar në vepra më pas, është e domosdoshme që zemra të mbushet me dashuri dhe ruhanijet.

Historia është dëshmitare se individët, familjet apo popujt kanë qenë të lumtur në raport me ndjekjen e mësimëve të Kuranit.

Për të mos i shndërruar zemrat në një shkretëtirë të thatë duhet ta lexojmë, kuptojmë dhe jetojmë Kuranin.

Sa mirë për besimtarët të cilët ushqejnë zemrat me Kuran, edukohen me porositë e tij dhe jetojnë sipas porositë të tij.

O Zot! Na bëj prej tyre që përfitojnë nga mirësitë e Kuranit dhe prej të dashurve Tuaj.

Amin!..





Mistika

*arti i të qenit i kënaqur
me caqtimin byjnor*



Rumi në një këshillë të tij thotë: “Nëse dëshiron parajsën në këtë botë, bëhu mik me të gjithë, mos mbaj mëri për askënd, sepse miqësia mbush zemrat me gëzim. Ai moment gëzimi është vetë parajsa. Nëse ke urrejtje për një person, ajo urrejtje të ndjek nga pas dhe gjithmonë do të jesh i trishtuar. Ky trishtim është vetë xhehenemi.”



MISTIKA ËSHTË ARTI I TË QENIT I KËNAQUR ME CAKTIMIN HYJNOR

Rumi e këshillonte kështu të birin:

“Bahaeddin! Nëse dëshiron parajsën në këtë botë, bëhu mik me të gjithë, mos mbaj mëri për askënd, sepse miqësia mbush zemrat me gëzim. Ai moment gëzimi është vetë parajsa. Nëse ke urrejtje për një person, ajo urrejtje të ndjek nga pas dhe gjithmonë do të jesh i trishtuar. Ky trishtim është vetë xhehenemi.

Kur kujton miqtë, zemra shndërrohet në një kopsht të mbushur me lule dhe trëndafila. Kurse kur kujton armiqtë, në shpirtin tënd lulëzojnë ferrat dhe gjarpërinjtë. Të gjithë pejgamberët dhe njerëzit e dashur të Allahut i kanë përfshirë besimtarët në zemrat e tyre. Kjo veti e tyre i bëri për vete njerëzit dhe në këtë mënyrë u bënë ndjekësit e tyre.” (Ahmed Eflaki, Menakibul Arifin, II, 210.)

Besimtari i qaset vëllait besimtar gjithmonë me mëshirë, dhembshuri, mirëkuptim dhe tolerancë. Besimtari nuk ushqen urrejtje, mëri, zemërim dhe inat ndaj vëllait mysliman. Prandaj ajetin: **“O Zoti ynë, na fal ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në**



**zemrat tona të ketë ndonjë të keqe ndaj besimtarëve!
O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”** (Hashr,
10) duhet ta përsërisim vazhdimisht në lutje.

Tema e parë e tasavufit është moslëndimi i njerëzve, kurse mësimi i fundit është pritja me durim, madje me kënaqësi e lëndimeve dhe mundimeve që mund të vijnë prej të tjerëve. Mundimet që mund të vijnë prej të tjerëve nuk nënkupton vetëm mundimet që mund të vijnë prej njerëzve, por edhe vështirësitë, problemet dhe sprovat e ndryshme që mund të ofrojë jeta. Sepse është Allahu Ai që e ka caktuar botën si vend sprove me të mirat dhe të këqijat për njerëzit. Besimtari i përsosur është ai që e pret me kënaqësi çdo gjë që i vjen nga Allahu. Në thelbin e lumturisë së kësaj bote dhe botës tjetër qëndron kënaqja me caktimin hyjnor.

Ata që duan të arrijnë dashurinë e Allahut, duhet së pari të jenë të kënaqur prej Tij. Besimtari është në gjendje falënderimi në çdo situatë. Besimtari nuk bie në kurthin e dëshirave të ulëta dhe mondane. Besimtari shikon anën e mirë të çdo gjëje, qoftë edhe fatkeqësi.

I urti Llukman e shpreh kështu çelësin e lumturisë:

“Dy gjëra mos i harro: Mos harro Zotin dhe vdekjen, dhe harro dy gjëra: Të këqijat që të bëjnë dhe të mirat që bën.”

Besimtari i vërtetë e gjen lumturinë edhe me një copë bukë thatë dhe di të ruajë qetësinë përballë uljeve dhe zbritjeve që i servir jeta.

Filibeli Hilmi Efendiu në veprën e tij “Ahmak-i Hayal”,



në mënyrë figurative tregon si t'i shndërrojmë momentet e trishtueshme në momente gëzimi.

Heroi i tregimit, Raxhiu, gjatë kërkimit të lumturisë takon një njeri të urtë duke i rënë nejit dhe recituar poezi melodike. Raxhiu, i ndikuar nga gjendja, u zhyt thellë në botën e imagjinatave, ku e gjeti veten në një mexhlis, në të cilin merrnin pjesë Pejgamberë, filozofë, intelektualë dhe njerëz të thjeshtë. Një person në emër të gjithë njerëzimit ishte vënë në kërkim të lumturisë së vërtetë dhe iu drejtua me zë të lartë të gjithë të pranishmëve duke u thënë:

- Më tregoni ju lutem; më është mërziur jeta, por edhe pa të nuk bëj dot. Ju lutem më përkufizoni lumturinë e vërtetë.

Nga të pranishmit u ngritën disa nga më ekselentët, ku secili bëri përkufizimin e vet.

Platoni: “Lumturia është të mendosh gjithmonë gjëra të mëdha.”

Aristoteli: “Logjika është lumturia e vërtetë.”

Zerdushti: “Lumturia është të dalësh nga errësira.”

Brahama: “Lumturia është e kundërta e saj që mendoni.”

Buda: “Lumturia është nirvana, tretja në botën transhendentale.”

Përballë këtyre fjalëve, personit që përfaqësonte njerëzimin iu turbullua mendja.

- Ju nuk jeni të dobishëm për veten tuaj, jetën tuaj e kaluat të gjithën të privuar nga lumturia. Edhe ato që thatë



nuk kanë lidhje fare me lumturinë. As vetë nuk ishit të lumtur dhe as ndjekësit tuaj nuk i bëtë të lumtur. Mendimet tuaja kanë ngelur në librat e pluhurosur nëpër rafte librash.

Pastaj çohen pejgamberët dhe shpjegojnë çfarë është lumturia. Më në fund çohet Pejgamberi i fundit ﷺ dhe u drejtohet njerëzve:

- O njerëz! Lumturia është të pranosh jetën siç është, të tregohesh i qetë përballë vështirësive dhe të përpiqesh ta përmirësosh jetën në tokë.

Njerëzimi, i kënaqur nga përgjigjja, ngrihet në këmbë dhe i thotë Pejgamberit ﷺ:

- O Krenaria e gjithë njerëzimit! Vetëm Ti i kupton shqetësimet e njerëzimit dhe vetëm Ti mund të gjesh ilaçin për shërimin e tyre.

Prandaj është marrëzi që një njeri që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit të mbytet në kënaqësitë e kësaj bote të përkohshme. Rruga e shpëtimit nga kjo marrëzi është ta konsiderosh botën si mjet për të fituar lumturinë në jetën e amëshuar. Kjo e bën njeriun të reflektojë mbi jetën në këtë botë. Njeriu që reflekton mbi jetën dhe ngjarjet në këtë botë nga këndvështrimi i besimit, nuk bëhet skllav i dëshirave dhe kënaqësive të kësaj bote.

Njerëzit e dashur të Allahut e shikojnë shfaqjen e mrekullisë hyjnore në bimët dhe pemët të cilat ushqehen nga e njëjta tokë, por që japin lule dhe fruta të ndryshme. Ata gjejnë qetësi shpirtërore në shikimin e një luleje dhe dëgjimin e një bilbili. Besimtarët e arrirë falënderojnë Allahun për të



gjitha mirësitë e krijuara në këtë botë dhe botën tjetër. Ata e ruajnë lumturinë në këtë botë, duke qëndruar larg lakmisë ndaj të mirave të përkohshme. Ata u përgjigjen me “Selam” sjelljeve negative të injorantëve.

Sadi Shirazi bën një krahasim të tillë për të ilustruar zemrën e zgjuar nga zemra e fjetur:

“Për njerëzit vigjilentë çdo gjethe në pemë është një libër në vete, në rrugën për të njohur Krijuesin, kurse për njerëzit e shkujdesur të gjitha pemët nuk janë asnjë gjethe.”

Rumi e shpreh kështu gjendjen e të shkujdesurit:

Një ditë, një person iu bë shok rruge Isait عليه السلام. Duke shkuar së bashku, personi pa në një skaj të rrugës ca eshtra dhe iu lut Isait عليه السلام:

“Ma mëso emrin e madh të Allahut me të cilin t’i lutem për të ringjallur këto eshtra e t’i ngre në këmbë!”

Isai iu përgjigj:

“Kjo punë nuk është për ty! Për ta kënduar “Emrin e madh” dhe për ta ringjallur të vdekurin, duhet të kesh një frymë më të pastër se shiu, të jesh më i kuptueshëm në adhurim se engjëjt! Emri i madh kërkon një gjuhë të kulluar dhe një zemër të pastër. Pra, një njeri që të mos e ketë nefs-in të ngjyer me haram dhe, si engjëjt, të mos dijë ç’është kundërshtimi. Sepse njeriut që e ka nefs-in të pastër, i pranohet lutja. Zoti i Lartë e bën atë njeri ruajtës të thesareve. Për shembull, ta zëmë se ti more në dorë shkopin e Musait. Mirë, po a ke fuqi ti ta bësh atë gjarpër dhe ta urdhërosh? Vetë Musai qe frikësuar kur i qe bërë shkopi gjarpër dhe Zoti




i pat thënë: **“Mos u frikëso, o Musa!”** (Neml, 10)

Ja, kështu edhe ti, ç’dobi do të kesh po ta këndosh dhe ta mësosh përmendsh “Emrin e madh”, në qoftë se nuk ke frymën e Musait?”

Por ai njeriu indiferent e i paditur prapë nuk heshti, por i tha:

“O Isa! Po s’e pata unë këtë fuqi, të paktën ringjalli ti ato eshtra!”

Isait , i erdhi shumë turp nga fjalët e atij kokëtrashi dhe tha:

“O Zot! Ç’është urtësia e kësaj këmbënguljeje? Cili është shkaku i kundërshtimit në këtë gradë të këtij kokëtrashi? Vetë e ka zemrën të vdekur, përpiqet ta ringjallë kufomën e tjetrit! Kurse atij që është vetë i vdekur, i takon ta ringjallë veten! Në vend që të lutet për ta ringjallur veten, përpiqet t’i ringjallë të tjerët! Ç’padituri e ç’indiferentizëm!”



Ja pra, një besimtar i arrirë nuk i cenon kufijtë dhe caktimin e Allahut e percepton si gjënë më të mirë për të. Në vend që të shkatërroje veten për gjërat që nuk ka përfituar në jetë, falënderon Allahun për gjërat që zotëron. Ai strehohet tek Allahu për t’u mbrojtur nga ata që e pandehin mjerimin lumturi. Ai, në çdo vështirësi dhe pengesë shikon një mirësi të fshehur.

Allahu në Kuran thotë:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur



me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27-30)

Allahu na mundësoftë të jemi prej atyre fatlumëve të cilët përfshihen në këtë ajet kuranor.

Amin!..





Urtësia e Vuajtjeve



Personi i pavuajtur dhe i paregjur bëhet arrogant. Një person i tillë mund të arrijë deri aty sa t'i atribuojë vetes cilësi hyjnore. Faraoni dhe Nemrudi janë dy shembujt më të spikatur të këtij fenomeni. Për këtë arsye, njerëzit e dashur të Allahut i kanë konsideruar vuajtjet dhe vështirësitë gjithmonë si një mirësi, e cila i ndihmon për të kuptuar dobësinë dhe për të gjetur rrugën drejt parajsës.



URTËSIA E VUAJTJEVE

Allahu në një ajet shprehet kështu:

Ajeti: **“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...”** (Bekare, 286), shpreh qartë që nuk e ngarkon njeriun me diçka që është jashtë mundësive të tij. Prandaj edhe masa e adhurimit ndaj Allahut është në raport me mundësinë për ta kryer adhurimin.

Një person që mund të ngrëjë 25 kg, nëse ngre 24 kg, atëherë në Ditën e Gjykimit do të gjykohet për 1 kg të lënë pa ngritur.

Obligimi i zekatit është i lidhur ngushtë me masën e duhur të pasurisë, e cila quhet nisab. Vetëm pasi të arrihet nisabi, personit i bëhet obligim dhënia e zeqatit. Përcaktimi i nisabit është shumë i thjeshtë, mirëpo ka shumë të mira të tjera materiale apo shpirtërore, të cilat janë shumë të vështira për t'u përcaktuar nisabin.

Prandaj për të dalë faqebardhë para Allahut në Ditën e Kiametit, duhet të shfrytëzojmë maksimumin e fuqive tona për hir të Allahut.

Ky tregim i Ibn Arabiut e ilustron në mënyrë të shkëlqyer shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të adhuruar Allahun:



Allahu i jep dy këshilla Musait عليه السلام:

1. Mos e lër pa shpresë këdo që shpreson tek ti!
2. Ruaje atë që kërkon mbrojtjen tënde!

Musai عليه السلام, gjatë një udhëtimi shikon një skifter, i cili ishte në ndjekje të një pëllumbi. Pëllumbi kur shikoi Musain, menjëherë fluturoi në krahun e tij për t'u mbrojtur, të njëjtën gjë bëri edhe skifteri duke qëndruar në krahun tjetër të Musait. Kur skifteri tentoi të sulmonte, pëllumbi iu drejtua Musait:

- Më mbro prej skifterit, o Musa!

Në krahun tjetër, skifteri iu drejtua Musait, duke i thënë:

- O Musa! Unë erdha tek ti për ndihmë. Mos ma humb shpresën që kisha tek ti, prandaj mos ndërhyj midis meje dhe rizikut tim!

Kurse pëllumbi:

- O Musa! Të lutem më ndihmo, më mbro prej skifterit!


Musai عليه السلام, i ndodhur përballë dilemës, për të mbrojtur pëllumbin apo për të plotësuar kërkesën e skifterit, duke u qëndruar besnik edhe këshillave të Allahut, mendoi të presë një copë mish nga këmba.

Kur pëllumbi dhe skifteri panë qëllimin sakrifikues të Musait عليه السلام, të dy njëzëri thirrën:




- O Musa! Mos nxito! Ne jemi engjëjt, të cilët kemi ardhur




për të vërtetuar besnikërinë tënde në fjalën e dhënë.


Në këtë tregim plot urtësi, Musait , së pari i tregohen kufijtë e ndalesave dhe urdhëresave, pastaj për të provuar besimin, bindjen dhe sinqeritetin e tij, testohet përmes një sakrifice shumë të vështirë. Sepse sinqeriteti në besim do të japë dobi në Ditën e Gjykimit, siç konfirmohet nga ajeti Kuranor.

“Kjo është dita (Dita e Gjykimit), në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre...” (Maide, 119)

Megjithë gjendjen jo të mirë ekonomike të Profetit , jeta e Tij është e mbushur plot me shembuj të bujarisë. Siç tregon edhe Xhabiri, shoku i Pejgamberit , nuk kishte ndodhur ndonjëherë që Pejgamberit , t'i kërkohej diçka dhe Ai të thoshte “Jo”.

Ja një shembull nga i Dërguari i Allahut:

Një djalë i vogël shkoi te i Dërguari i Allahut dhe ia paraqiti kërkesën e nënës për t'i dhënë një këmishë. Në atë çast Profeti s'kishte këmishë tjetër veç asaj që kishte në trup. Ai i tha djalit të vinte një herë tjetër. Djali shkoi, por u kthye menjëherë me kërkesën e nënës për t'ia dhënë këmishën që kishte në trup. Profeti , hyri në shtëpi, e nxori këmishën dhe ia dha djalit.

Në atë mes, Bilali , po këndonte ezanin. Por i Dërguari i Allahut nuk doli të flasë, sepse nuk kishte këmishë në trup. Një pjesë e shokëve u shqetësuan, hynë në shtëpi te Profeti dhe e gjetën pa këmishë. (Vahidi, fq. 194-295.)

Pra, besnikëria e pejgamberëve, të cilët janë dërguar si



model shembullor për njerëzimin, është testuar me provat më të rënda dhe të vështira. Dikush është sprovuar me refuzimin e besimit nga ana e familjes, dikush me shëndetin, dikush me smirën e vëllezërve, dikush me shpifje dhe trillime, dikush me humbjen e të dashurve dhe pasurisë, dikush me humbjen e shikimit..., por ata të gjithë i kaluan provat me besim dhe bindje të plotë tek Krijuesi i tyre.

Musai عليه السلام, në tregimin e lartpërmendur tregon një kujdes të madh edhe në respektimin e urdhëresave hyjnore, por edhe në përmbushjen e kërkesave të pëllumbit dhe skifterit, të cilat ishin të kundërta me njëra-tjetrën Musai عليه السلام, zgjodhi sakrificën e një pjese të tij për hir të respektimit të urdhëresave hyjnore.

Allahu e sprovoi Ibrahimin عليه السلام, me jetën, me fëmijën dhe pasurinë, sepse këto tri mirësi krijojnë mbretëri në zemrën e njeriut dhe Allahu kërkoi prej Ibrahimit ta shkatërronte këtë mbretëri. Së pari e sprovoi me pasuri dhe Ibrahim عليه السلام, e sakrifikoi gjithë pasurinë për hir të fitimit të dashurisë hyjnore. Pastaj e sprovoi me jetën, por hedhja në zjarr nuk e lëkundti besimin e tij tek Krijuesi. Të njëjtën bindje ndaj Allahut e tregoi edhe në gatishmërinë për të sakrifikuar birin e tij të dashur. Kur Allahu shikoi bindjen dhe besnikërinë e Ibrahimit, ia dhuroi të tria këto mirësi. Allahu e përgëzoi kështu Ibrahimin عليه السلام:

Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.”
Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një provë e qartë. Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh, dhe i lamë



**atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm.
“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”** (Saffat, 104-109)

Kurse Muhamedi ﷺ, është testuar me sprova nga më të vështirat. Siç e konfirmon edhe vetë kur thotë: “...Jam përballur në rrugën e Allahut me vështirësi që nuk i ka hasur asnjë tjetër.”

Dashuria dhe dhembshuria e Pejgamberit ﷺ, për ymetin e kalonte dashurinë e prindërve për fëmijën e tyre.

Muhamedi ﷺ, në Mekë u përgënjeshtroa, u ofendua, u bojkotua, u cenua fizikisht, kurse vështirësitë që hasi në Taif janë plot urtësi.

Aisheja , thotë:

E pyeta Pejgamberin ﷺ: “A ke pasur ndonjë ditë më të vështirë se ditën e luftës së Uhudit, o i Dërguar i Allahut?”

Dhe Ai m’u përgjigj kështu:

“Po, populli yt më ka përjetuar ditë shumë të vështira, kurse nga këto ditë më e vështirë dhe më e mundimshme ka qenë dita e Akabesë. Tjetër moment shumë i vështirë për mua ka qenë dita e Taifit, kur i kërkova Ibn Abdijalit mbrojtje nga kurejshët, por ai jo vetëm që refuzoi kërkesën time, por edhe nxiti njerëzit për të më qëlluar me gurë deri sa u mbulova me gjak. Në gjendje dëshpërimi të thellë mora rrugën e kthimit. Kur arrita në vendin e quajtur Karnu’tha-Thaealib, vura re që një re po më bënte hije. Kur pashë me vëmendje m’u shfaq Xhibrili dhe tha:

‘Allahu i dëgjoj fjalët dhe refuzimin e popullit për të mbrojtur Ty. Allahu ka dërguar engjëllin e maleve nën urdhrin për t’i dënuar.’



Pastaj engjëlli i maleve më bëri zë, dha selam dhe më tha:

‘O Muhamed! Zoti i dëgjoj fjalët e popullit tënd. Unë jam engjëlli i maleve. Allahu i lartë më dërgoi nën urdhrat e tua. Ç’ dëshiron të bëj? Nëse dëshiron, ua hedh këto dy male mbi kokë.’

Atëherë, unë iu përgjigja:

‘Jo, unë dua nga Allahu që nga fisi i tyre të sjellë breza që të adhurojnë vetëm Allahun pa i shoqëruar shok Atij...’

(Buhari, Bedu'l-Halk, 7; Muslim, Xhihad, 111)

Kjo sjellje e Muhamedit ﷺ, ndodhte sepse Ai dëshironte shpëtimin e gjithë njerëzimit, prandaj gjithmonë përhapte dashuri dhe dhembshuri.

Ai gjithmonë dobësinë e tij ia paraqiste Allahut, Krijuesit të gjithësisë, siç bëri pas pritjes armiqësore në Taif:

“O Allah, drejt Teje ankohe, shfaq pakënaqësi ndaj dobësisë time, paaftësisë time dhe përlësisë time. O më i Mëshirshmi i mëshiruesve, Ti je Zoti i të dobëtimit. Dhe Ti je Zoti im. Në duart e kujt do të më lësh mua? Në disa të huaj të cilët do të më keqtrajtojnë? Apo tek ndonjë armik i cili më dominon mua? Nëse nuk je zemëruar me mua, atëherë nuk shqetësohem, por ndihma Jote mbështetëse do të ishte më e lehtë për mua. Unë mbështetem në dritën e Miratimit Tënd, ku të gjitha errësirat ndriçohen dhe gjërat e kësaj bote dhe të tjetrës janë me drejtësi të përgatitura. Ty dhe vetëm Ty të takon e drejta e faljes dhe ndëshkimit derisa të arrihet Kënaqësia Jote. Nuk ka fuqi dhe as forcë përveçse përmes Teje.” (Ibn Hisham, Vol. 2, f. 29-30; Hejthemi, IV, 35)



Ja pra, pas durimit të treguar përballë gjithë atyre vështirësive dhe mundimeve, të cilat harxhojnë gjithë energjinë e njeriut, vjen ndihma dhe mbështetja. Allahu i përjetoj Muhamedit ﷺ, miraxhin, të cilin nuk e ka arritur asnjë genie njerëzore.

Vështirësitë më të mëdha i kanë përjetuar pejgamberët, njerëzit e dashur të Allahut dhe pastaj të gjithë besimtarët sipas gradave shpirtërore që kanë pasur. Nëse vëmë re gurët nëpër brigjet e lumenjve janë të lëmuar dhe të fortë, sepse janë përballur me dallgët për shekuj të tërë.

Njeriu që nuk heq vuajtje dhe mundime bëhet i harbuar dhe i shfrenuar. Shkon deri aty sa t'i mveshë vetes cilësi hyjnore. Faraoni dhe Nemrudi janë dy shembuj tipik të kësaj gjendjeje. Prandaj miqtë e Allahut vuajtjet, mundimet dhe vështirësitë i kanë konsideruar gjithmonë si mirësi që zbulon dobësinë e njeriut para Krijuesit. Shija e afrimitetit tek Krijuesi i bën të gjitha vuajtjet e kësaj bote të parëndësishme. Këtë gjendje mund ta përjetojnë ata që kanë arritur gradën “Radije” të gjendjes shpirtërore.

O Zot! Dobësinë tonë ta shprehim vetëm Ty. Na bëj prej tyre që janë të kënaqur me caktimin Tënd. O Zot, na bëj prej tyre që në këmbim të Xhenetit kanë dhuruar pasurinë dhe jetën.

Amin!..





Ekspozimi i një personaliteti islam



*Evlijatë, njerëzit e dashur të Allahut janë
njerëzit idealë për të shëruar zemrat e sëmu-
ra, për të qetësuar shpirtrat e trazuar dhe
për të orientuar mendjet kaotike.*



EKSPOZIMI I NJË PERSONALITETI ISLAM

Allahu e dërgoi Pejgamberin ﷺ, si mëshirë për njerëzimin. Ai është një model dhe shembull i përsosur për çdo nivel intelektual dhe pozite në çdo fushë të jetës së njeriut, deri në Ditën e Gjykimit. Çdo gjendje, sjellje dhe fjalë e tij përbën nivelin më të lartë të shkencave pedagogjike dhe psikologjike. Zemra e besimtarit që merr për shembull Pejgamberin ﷺ, shndërrohet në një parajsë lumturie. Eksperti i famshëm i së drejtës islame Karafi, thotë:

“Pejgamberi ﷺ, sikur të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, vetëm brezi që ka edukuar Ai, do të mjaftonte si mrekulli dhe si provë për të vërtetuar profetësinë”

Në të vërtetë, ajo shoqëri e cila para se të vinte Pejgamberi ishte e zhytur në errësirë totale duke bërë padrejtësi, duke varur foshnjat dhe duke shtypur të dobët, përmes Pejgamberit ﷺ, u shndërrua në shoqërinë e virtyteve.

Qëllimi kryesor i kësaj shoqërie ishte arritja në nivelin e njeriut ideal në të gjitha aspektet, në moral, në virtyt dhe në personalitet.

Ka shembuj të shumtë të përpjekjeve titanike të sahabëve për të arritur këtë ideal. Një nga këta shembuj plot mësimë është:



Xherir ibn Abdullah dëshironte të blinte një kalë. Një shitës kuajsh i ofroi kalin që pëlqeu për 500 dirhem. Abdullahu refuzoi ta merrte me këtë çmim, sepse mendonte se vlera e kalit mund të ishte 600 dirhem madje edhe 800 dirhem. Por shitësi nuk ishte shumë i aftë në vlerësimin e mallit që shiste.

Shitësi i drejtohet Abdullahut, duke i thënë:

- Përse e ngrite çmimin në 800 dirhem, kur kishe mundësi ta merrje për 500 dirhem?

Xheriri dha këtë përgjigje mbresëlënëse:

- Ne i kemi dhënë fjalën Pejgamberit ﷺ, për të mos bërë hile në tregti.

Sahabët bënë të gjitha përpjekjet për të përhapur në të gjitha anët e botës personalitetin dhe karakterin e gdhendur në zemrat e tyre përmes edukimit shembullor të Pejgamberit ﷺ.

Ata, me moralin e bukur dhe karakterin e përsosur, u bënë kopsht me lule për shumë njerëz, të cilët kishin qenë të privuar nga kopshti me trëndafila i Islamit.

Njerëzit mahniten mbas njerëzve me karakter dhe personalitet të përsosur. Sepse sjellja më e vogël e një personaliteti shembullor, në shumë raste ndikon më shumë se sa fjala. Shembull tipik i kësaj është kjo ndodhi historike:

Një tregtar trikotazhi, i cili e kishte mbajtur zemrën me bukuritë e Islamit, një ditë niset për tregti në Indonezi. Pasi vendoset në Indonezi, fillon të shesë mallin në Pazar.

Malli që kishte sjellë ishte shumë cilësor, por ngaqë nuk ishte lakmitar për të fituar shumë, mendoi se ishte më mirë



të fitonte pak, por në mënyrë hallall. Prandaj kërkesën e lartë për mallrat e tij nuk e kishte shfrytëzuar asnjëherë për të ngritur çmimin.

Një ditë, kur erdhi vonë në punë, vuri re se shërbëtori kishte fituar shumë para nga mallrat e shitur. Dhe midis tyre u zhvillua ky dialog:

- Prej cilit stof ke shitur?

- Nga ky këtu zotëri.

- Sa e shite?

- Dhjetë dinarë.

- Si e shite dhjetë dinarë një pëlhurë që kushton pesë dinarë? I kemi hyrë në hak njeriut të shkretë. Nëse e shikon, a e njeh?

- Po zotëri, e njoh!

- Atëherë, shko menjëherë, gjeje dhe sille këtu.

Shërbëtori iku menjëherë, e gjeti klientin dhe e solli tek tregtari.

Tregtari, sapo e pa klientin i kërkoi falje atij dhe iu lut që t'ia bënte hallall dhe tha: “Na falni, punëtori gabimisht stofin që kushtonte 5 dinarë e ka shitur 10 dinarë.” Dhe i zgjati klientit 5 dinarët e tepërt, duke i thënë se kjo ishte pjesa e tepërt që i përkiste atij.

Klienti u mahnit nga kjo sjellje sublime. Ishte hera e parë që përballej me një sjellje të tillë. Kurrë më parë nuk kishte dëgjuar për një rast si ky. Blerësi po mendonte mbi fjalët “ma bëj hallall”. Si ka mundësi një gjë e tillë? Copën e stofit



e kishte marrë me pëlqimin e vet. Megjithëatë, falënderoi tregtarin dhe doli nga dyqani.

Ngjarja filloi të përcillej gojë më gojë dhe brenda një kohe të shkurtër u dëgjua në të gjithë qytetin. Të gjithë i tregonin njëri-tjetrit për këtë ngjarje. Pa kaluar shumë, çështja i ra në vesh mbretit dhe vendosi ta thërriste shitësin e stofit në sarajet e tij. Ai dëshironte të mësonte si qëndronte puna. Në mbretërinë e tij, për herë të parë ndodhte një gjë e tillë. Brenda popullit të tij ishte e pamundur të ndodhte një gjë e tillë sepse gjithkush e shiste mallin e tij sipas dëshirës. Cili ishte shkaku që e shtynte tregtarin të bënte një veprim të tillë?

Mbreti e pyeti:

- Këtë veprim që ju keni bërë, ne as e kemi parë as e kemi dëgjuar më parë. Si është e vërteta e kësaj sjelljeje? Cili është shkaku që ju shtyn të bëni një veprim të tillë?

- Unë-, tha tregtari-, jam mysliman, jam besimtar. Feja islame kështu urdhëron. Atë stof e kisha blerë 4 dinarë dhe e shisja 5, por shërbëtori e kishte shitur 10 dinarë. Kështu që unë i kisha hyrë në hak klientit dhe për këtë shkak në mallin tim ishte përzier edhe fitimi haram. Unë vetëm rregullova një gabim të bërë.

Mbreti bëri disa pyetje të njëpasnjëshme:

Ç'është Islami? Ç'është morali islam? Tregtari iu përgjigj një e nga një pyetjeve të mbretit. Pa kaluar shumë kohë, mbreti pranoi Islamit dhe mbas tij i gjithë populli.

Ndoshta shkaku i pranimit të Islamit nga një vend me



popullsia 250 milion banorë është pikërisht ky moral i bukur islam, i shfaqur nga tregtari.

Duhet që vazhdimisht në çdo situatë dhe vend të ekspozojmë moralin e bukur të Islamit.



Në mënyrën e sjelljes së njeriut ndikojnë dy faktorë, të cilët janë:

1- Mënyra e fitimit të pasurisë:

Besimtari duhet të tregojë kujdes të veçantë në mënyrën e fitimit të pasurisë, që ajo të mos ndotet me fitim haram. Sepse pasuria që fitohet në mënyrë jo të ndershme ndikon shumë në gjendjen shpirtërore të njeriut.

2- Gjendja e njerëzve me të cilët ka marrëdhënie shoqërore

Njeriu ndikohet prej personit që shoqërohet, si në aspektin pozitiv, ashtu edhe atë negativ. Prandaj duhet të bëjmë kujdes për ushqimin që hamë dhe miqtë që zgjedhim.

Ndjeshmëria e tregtarit që përmendëm më sipër ndaj fitimit të pastër, jo vetëm që e mbrojt atë nga ndotja e zemrës me fitim haram, por u bë shkak për një lëmoshë rrjedhëse deri në Ditën e Gjykimit.

Fjalët që dalin prej një zemre të sigurtë dhe të devotshme lënë mbresa të jashtëzakonshme tek njerëzit, sidomos kur pasqyrohen në sjellje dhe moral.

Me moralin e bukur dhe mënyrën e duhur të komunikimi-



mit arriti Xhaferi ﷺ, të bëhet shkak që mbreti i Etiopisë të bëhej mysliman. Ushtritë myslimane, përpara se të çlironin një vend, dërgonin në ato vende njerëz të urtë dhe të ditur. Sepse gjendja ka një impakt të jashtëzakonshëm në jetën e njerëzve. Siç thotë Rumi:

“Ai që këshillon me gjendje është më i mirë se ai që këshillon me fjalë.”

Evlijatë, si ushtarë të zemrave, me gjendjen e tyre shpirtërore gdhendnin zemrën e popullit të sapoçliruar.

Popujt e sapoçliruar mahniteshin prej moralit të bukur, mëshirës dhe dhembshurisë së myslimanëve. Kjo e bënte shumë të lehtë pranimin e Islamit nga ana e tyre. Në të vërtetë, çliruesit realë janë çliruesit e zemrave. Shpata është një copë hekur, e cila merr vlerë kur përdoret për të zhdukur padrejtësitë, përkundrazi, ajo shndërrohet në një mjet tiranie.

Një nga mendimtarët e mëdhenj të botës islame të shekullit të kaluar, Muhamed Hamidullah thotë:

“Më habit fakti se shkak kryesor që i çon njerëzit sot në Evropë drejt Islamit, është misticizmi. Dritën e Islamit sot në botë nuk do të mund ta përçojë as shpata, as mendja, por vetëm zemra.”

Evlijatë, njerëzit e dashur të Allahut, janë njerëzit idealë për të shëruar zemrat e sëmura, për të qetësuar shpirtrat e trazuar dhe për të orientuar mendjet kaotike në këtë botë të trazuar.

Pejgamberi ﷺ, sahabët dhe të dashurit e Allahut, më



tepër sesa me fjalë, janë përpjekur për të paraqitur një personalitet islam si rrugën më të shkurtër për tek Allahu.

Çdo mysliman duhet të ndërtojë një personalitet islam, për ta përhapur më pas në mjedisin që e rrethon. Besimtari duhet të jetë një argument i gjallë i fesë islame, duke e përfaqësuar Islamin në mënyrën më të mirë. Allahu shprehet kështu në Kuran:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.” (Bekare, 143)

O Zot! Na bëj përfaqësues të denjë të Islamit me personalitetin, me moralin dhe me çdo sjellje tonën.

Amin...





U ngjalltë kushdo që vjen tek Ti



Nuk është dobësi dhe burracakëri të falësh, kur i ke të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë. Falja është një nga virtytet më të overa të njeriut. Njeriu, kur është i pafuqishëm, nuk mund të hakmerret, prandaj virtyti i vërtetë është të falësh, kur i ke të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë. Ajeti kuranor shprehet kështu:

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34)



U NGJALLTË KUSHDO QË VJEN TEK TI!

Ebu Hanife, një nga juristët më të mëdhenj të së drejtës islame dhe njëkohësisht themeluesi i shkollës hanefite, ishte një njeri i ditur dhe i virtytshëm. Në periudhën në të cilën jetoi kishte shumë simpatizantë, të cilët vlerësonin punën e tij, por kishte edhe njerëz të cilët e kishin zili. Një ditë, njëri nga ata që e kishin zili e goditi Ebu Hanifen pa asnjë shkak. Ebu Hanife, duke e parë në sy, reagoi në këtë mënyrë:

“Edhe unë mundem ta kthej me të njëjtën goditje, por nuk do ta bëj.

Unë mund të ankojem edhe tek gjykata për të të dhënë dënimin e merituar, por as këtë nuk do ta bëj.

Unë mund t'i ankojem edhe Allahut për këtë ofendim që më bëre, por as këtë nuk do ta bëj.

Unë mund t'i lutem Allahut që të marr hakun prej teje në Ditën e Gjykimit, por as në atë ditë të tmerrshme nuk mendoj të të lë në pozitë të vështirë.”

Përballë këtyre fjalëve gjithë mëshirë, burri mbeti i ngrirë. Këto fjalë gjithë dhembshuri të Ebu Hanifes janë si shembulli i fjalëve të prindërve për fëmijën e tyre.

Zemra e agresorit, përballë sjelljes gjithë hijeshi dhe



elegancë të Ebu Hanifes u trondit. Në pak momente urrejtja, mëria dhe armiqësia e tij ndaj Ebu Hanifes u zhduk krejtësisht, duke i lënë vendin simpatisë, respektit dhe dashurisë për Imamin.

Ebu Hanife me këtë sjellje, nga njëra anë shpëtoi veten nga zjarri i hakmarrjes, kurse nga ana tjetër fitoi zemrën e armikut.

Ky është morali që kërkon dhe nxit misticizmi. Në lidhje me këtë, Rislan Dimeshki thotë:

“Nëse ke mundësi dhe fuqi të mundësh armikun, atëherë si falënderim për fuqinë e dhuruar nga Allahu fale atë.”

Përballë butësisë dhe urtësisë së Ebu Hanifes, armiku u përkul duke i kërkuar ndjesë për veprimin e pahijshëm. Ebu Hanife u lut që Allahu t'i falte të dy për gabimet e mundshme.

Mësimi i parë që duhet të marrim nga ky tregim është modestia dhe falja si dy virtyte që nuk duhen braktisur asnjëherë.

Ebu Hanife, nëse do të ishte sjellë në mënyrë të vrazhdë, nuk kishte për të pasur asnjë ndikim mbi personin përballë, përveçse do t'i ndizte më keq zjarrin e mërisë dhe hakmarrjes.

Një mësim tjetër që nxjerrim nga tregimi është mos marrja hak për çështje personale, edhe nëse kemi mundësi ta bëjmë një gjë të tillë. Njeriu kur është i pafuqishëm, nuk mund të hakmerret, prandaj virtyti i vërtetë është të falësh,



kur i ke të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë.

Pejgamberi ﷺ, kishte mundësi që me një urdhër të vetëm të hakmerrej kundër të gjithë politeistëve që e kishin torturuar dhe persekutuar për vite të tëra, por Ai përmes shpalljes së një amnistie të përgjithshme fitoi zemrat e tyre. Sepse qëllimi i Pejgamberit nuk ishte dënimi, por udhëzimi, shpëtimi dhe pastrimi i zemrave me ujin e pastër dhe të kthjellët të Islamit.

Është virtyt i lartë që urrejtja ndaj veprimit të mos kalojë në urrejtje ndaj vepruesit. Ky është një virtyt që arrihet vetëm përmes rrugës së edukimit profetik.

Arma më e fortë e personit që i bëhet padrejtësi, është lutja. Në rastin e Ebu Hanifes, ai shumë mirë mund ta përdorte si mallkim për ofenduesin, por ai e përdori si bekim për të, duke i shkukur në këtë mënyrë urrejtjen dhe mërinë nga zemra. Me pjekurinë që tregoi Ebu Hanife, ndodhia u mbyll më përfitimin e të dy palëve.

Pejgamberi ﷺ, me sjelljen që shfaqti përballë arrogancës së popullit të Taifit, duke u lutur për udhëzimin e tyre në vend të mallkimit të tyre, tregoi që ai ishte dërguar si mëshirë për gjithë njerëzimin.

Si të gjithë njerëzit edhe besimtarët e devotshëm gjatë jetës, për shkaqe nga më të ndryshmet mund të bien pre e ofendimeve dhe sjelljeve armiqësore. Kjo sjellje mund të prekë vetë ata, familjen e tyre ose pasurinë e tyre, e rëndësishme është që përballë këtyre sjelljeve të ulëta besimtari të mos vrapojë menjëherë mbas hakmarrjes, por të përpiqet ta kthejë gjendjen në favorin e vet dhe të kundërshtarit si



në shembujt e mësipërm. Thënë ndryshe, ne duhet të përpiqemi që me pjekurinë tonë morale të ringjallim personin që vjen për të na vrarë.

Në lidhje me këtë, është shumë mësimdhënëse ndodhia që tregon pjekurinë morale të Aliut عليه السلام.

Gjatë një beteje, Aliu عليه السلام, kishte vënë poshtë një ushtar armik dhe po bëhej gati ta vriste, por ushtari bëri një gjest shumë të ulët duke pështyrë në fytyrë Aliun عليه السلام.

Për Aliun عليه السلام, që ishte një person trim, pjesëtar i Ehli Bejtit dhe “Luani i Allahut”, nuk ishte e vështirë që me një të rënë t’ia fluturonte kokën atij qafiri që e kishte vënë poshtë në sheshin e luftës, por duke u frikësuar nga devijimi i qëllimit për të cilin luftonte, ai hoqi dorë nga vendimi për ta vrarë, duke e lënë të lirë.

Ushtari, i cili kishte mbetur i shtrirë përtokë dhe po priste vdekjen në një gjendje të mjerueshme, u habit nga ky veprim, sepse mendoi se Aliu do t’ia fluturonte kokën menjëherë për shkak të veprimit që bëri duke e pështyrë në fytyrë. Por nuk ndodhi ashtu siç mendonte ai, përkundrazi, u ndodh përballë një realiteti, që as mund ta imagjinonte. Duke mos arritur ta perceptonte sjelljen e Aliut, e pyeti me habi:

“O Ali! Përse hoqe dorë nga vendimi për të më vrarë? Çfarë ndodhi që nga një zemërim i ashpër kalove në qetësi? Teksa po shpërtheje si një rrufe, papritmas u paqtove dhe re në qetësi...”

Aliu عليه السلام, i tha:

“Këtë shpatë që e kam dhuratë nga Pejgamberi صلى الله عليه وسلم, e



përdor vetëm për hir të Allahut. Edhe kokat e armiqve të Allahut i pres për hir të Tij. Nuk i përziej qëllimet vetjake me qëllimin hyjnor... Ti, duke më pështyrë, doje të më zemëroje dhe të më poshtëroje. Kjo do të thotë se, nëse do të të vrisja në gjendje zemërimi, do ta bëja për shkak të prekjes së dinjitetit tim personal, gjë që nuk i ka hije një besimtari. Por unë luftoj për hir të Allahut dhe jo për të kënaqur krenarinë time.”

Së fundi, zemra e armikut gjeti përsëri jetë përballë moralit të lartë të një njeriu që kishte ardhur për ta vvarë. Ai u nderua me besim, duke marrë pjesë nga besimi dhe sinqeriteti Aliut ﷺ.

Për këtë mënyrë sjelljeje, ajeti kuranor shprehet kështu:

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34)

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, i di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë.” (Nahl, 125)

Këto dy ajete kanë vendosur kriteret më të bukura që mund të ekzistojnë, në lidhje me komunikimin dhe marrëdhëniet njerëzore. Nëse respektohen këto kritere, personat që kanë gabuar, herët ose vonë do ta kuptojnë gabimin e tyre porsì vëllezërit e Jusufit ﷺ, të cilët e pranuan gabimin pas shumë vitesh.

Mirësjellja dhe bamirësia që tregoi Jusufi ﷺ, në për-



bushjen e të gjitha kërkesave të vëllezërve që vite më parë kishin dashur ta vrisnin, është një cilësi e lartë morale e vështirë për t’u arritur, sepse ai shumë lehtë me fuqinë dhe pushtetin që zotëronte mund të hakmerrej ndaj tyre, por Pejgamberi i Allahut zgjodhi t’ua kthejë të keqen me të mirë, t’ua mbulojë gabimet për hir të Allahut. Ky është shembulli i një virtyti të pashembullt. Allahu e shpreh kështu në Kuran mirësjelljen e Jusufit عليه السلام, ndaj vëllezërve: **Ai u tha: “Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!”** (Jusuf, 92)

Përballë kësaj sjelljeje shembullore dhe profetike, vëllezërit u penduan thellë për veprimin e shëmtuar që kishin bërë ndaj vëllait të tyre dhe në këtë mënyrë pranuan epërsinë e Jusufit عليه السلام, duke thënë: **“Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtet të gabuar.”** (Jusuf, 91)

O Zot! Na zbukuro me moralin e pejgamberëve dhe njerëzve Tuaj të dashur. Na bëj të denjë për të përfaqësuar fenë Tënde në tokë dhe na ringjall së bashku me njerëzit Tuaj të preferuar.

Amin!..



Mëshira fryti i parë i besimit



Një besimtar i përsosur është njeri i zemrës. Mëshira dhe vetëmohimi janë vetitë më të spikatura dhe natyra bazë e tij. Mëshira është si një zjarr që nuk shuhet kurrë në zemrën e tij. Rruga për t'u ngjitur në qiellin e pjekurisë, ku mund të arrijë shpirti njerëzor, kalon nëpër nivelet e mëshirës dhe shërbimit. Mëshira është një element hyjnor, që përbën dëshminë e besimit tonë në këtë botë dhe na afron me zemër te Zoti ynë.

MËSHIRA, FRYTI I PARË I BESIMIT

Një besimtar i përsosur është njeri i zemrës. Mëshira dhe vetëmohimi janë vetitë më të spikatura dhe natyra bazë e tij. Mëshira është një element hyjnor, që përbën dëshminë e besimit tonë në këtë botë dhe na afron me zemër te Zoti ynë. Rruga e vetme e shpirtit për të arritur pjekurinë dhe përsosjen është mëshira dhe zemërbutësia.

Mëshira e treguar ndaj çdo lloj krijese është një begati, e cila e përfshin njeriun në detin e mëshirës hyjnore. Pejgamberi ﷺ, e shpreh kështu mirësinë e mëshirës ndaj krijesave:

“Mëshironi ata që janë mbi tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë mbi qiell.” (Tirmidhi, Birr, 16)

Ata që kanë arritur këtë gjendje, vazhdimisht janë pranë nevojtarëve dhe të dobtëve duke kërkuar mëshirën hyjnore. Në të njëjtën kohë, ata janë edhe një strehim për gjithë krijesat.

Rasti i Hasanit, i cili ishte rritur nën edukimin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, është një shembull i përkryer i kësaj gjendjeje:

Një ditë, kur Hasani ﷺ, po shkante në vreshta takon



një skllav me ngjyrë. Skllavi, me bukën që kishte në dorë, një herë ushqente veten një herë qenin që kishte pranë.

Hasani u mahnit nga shfaqja e kësaj mëshire te ky skllav. Pasi e shikoi për një kohë, për të mësuar dhe matur thellësinë shpirtërore të tij, vendoi ta pyeste se përse e ndante bukën me qenin. Hasani ﷺ, e pyeti:

- Kush je ti?

Skllavi gjithë respekt i tha që ishte shërbëtori i Ebanit, djalit të Osmanit ﷺ.

Hasani ﷺ:

- E kujt është kjo vreshtë?

Skllavi:

- E djalit të Osmanit ﷺ.

Hasani ﷺ, me dëshirën e madhe për ta pasur pranë këtë njeri plot urtësi dhe pjekuri i tha:

- Mos u largo prej këtu, pas pak do të kthehem.

Hasani ﷺ, u largua prej aty dhe shkoi tek Ebabini për të blerë prej tij vreshtën dhe skllavin. Hasani ﷺ, kthehet dhe i thotë:

- Djalosh! Ty të bleva unë.

Skllavi ngrihet dhe i thotë:

- Bindja ime për Allahun, Pejgamberin ﷺ dhe ty.

Hasani ﷺ, përjetoi emocione të forta nga besnikëria dhe bindja e tij. Dhe përballë kësaj sjelljeje, Hasani ﷺ, i thotë:

- Ti je i lirë dhe kjo vreshtë është dhurata ime për ty.



Një tablo shumë e bukur e dashurisë dhe mëshirës për hir të Allahut!..

Dashuria dhe miqësia janë burim i qetësisë dhe gëzimit të jetës sonë në këtë botë të përkohshme. Aftësia për të dashuruar është një nga dhuratat më të mëdha që Allahu u ka dhënë krijesave të veta. Dashuria jonë duhet të orientohet drejt simbolit të mëshirës dhe dashurisë, Muhamedit ﷺ. Ndjenja e mëshirës dhe dashurisë në zemrën tonë rritet në përpjesëtim të drejtë me dashurinë që ndjejmë për Pejgamberin ﷺ.

Të gjithë miqtë e Allahut, duke qenë të mbrujtur me moralin e Pejgamberit ﷺ, kanë qenë gjithmonë qendër e dashurisë dhe mëshirës. Këshilla e Bahauddin Nakshibendiu e shpreh shumë bukur ndjeshmërinë e lartë ndaj mëshirës dhe dashurisë:

“Përpiqu të fitosh një zemër; shërbeju të pafuqishmëve! Mbroji të dobëtit dhe zemërthyerit! Ata jetojnë pa asnjë lloj të ardhure dhe krejtësisht të privuar nga të mirat e përkohshme të kësaj bote. Megjithatë, një pjesë e mirë e tyre jetojnë të qetë, të lumtur dhe të pasur nga ana shpirtërore. Kërkoji këta lloj njerëzish dhe shërbimin ndaj tyre konsideroje si mirësi.”

Nakshibendiu e shpreh kështu arritjen e gradës shpirtërore përmes mëshirës:

“Punova për një kohë të gjatë sipas porosive të mjeshtrit. Të gjitha shërbimet i kreja me përkushtim. Vetëdija m’u bë e tillë sa që, kur kaloja në rrugë, nëse më dilte para ndonjë krijesë çfarëdo e Allahut, ndaloja dhe prisja të kalon-



te. Kjo gjendje më vazhdoi shtatë vjet. Në shpërblim të këtij shërbimi, arrita të dëgjoj se si qeniet nxirrnin zëra ankues dhe përgjërues drejtuar Zotit.”

Mëshira është fryti i parë i besimit. Nga kjo pikëpamje, zemra e besimtarit që e përjeton besimin me entuziazëm, përfshin brenda mëshirës së saj gjithë krijesat e Allahut, sepse persona të tillë e kanë kuptuar mirë burimin e dashurisë, prandaj kanë krijuar miqësi me çdo krijesë. Kanë fituar aftësinë për ta parë krijesën me syrin e dashurisë dhe dhembshurisë.

Allahu na bëftë prej atyre që falin, duan dhe mëshirojnë për hir të Allahut. Allahu na mëshiroftë dhe na përfshiftë në grupin e fatmirëve.

Amin..!



Përgjegjësia e udhërrëfyesve



Drejtuesit e çdo niveli duhet të tregojnë kujdes në sjelljet dhe veprimet që kryejnë, sepse një gabim i tyre përfshin gjithë shoqërinë.

PËRGJEGJËSIA E UDHËRRËFYESVE

Begatia në të cilën jetojnë udhëheqësit shpirtërorë është e shoqëruar me përgjegjësi të madhe, sepse sjelljet dhe gjendjet e tyre kanë ndikim të madh në shoqëri.

Në një fabul të njohur gaforrrja nënë i thotë së bijës:

-Përse ecën shtrembër? Ec drejt bija ime!

Gaforrrja bijë i përgjigjet:

- Mirë nënë! Ec drejt ti që je para meje dhe të ndjek unë.

Kjo e vërtetë është e vlefshme në rrafshin, familjar, shoqëror dhe shtetëror. Historia është e mbushur me shembuj të pafund në lidhje me këtë të vërtetë.

Në kohën e dinastisë Umejade, drejtuesit ishin të dhënë pas jetës luksoze dhe ndërtesave madhështore. Edhe populli, duke ndjekur drejtuesit, filloi ndërtimin e godinave luksoze. Në të gjitha tubimet flitej vetëm për jetën mondane. Njerëzit filluan të garonin me njëri-tjetrin për shtëpinë më të madhe dhe të shtrenjtë.

Kurse kalifi Omer ibn Abdulaziz ishte një besimtar i devotshëm, i drejtë dhe modest. Në kohën e tij populli filloi të garonte kush adhuron më shumë dhe kush kontribuon



më shumë në rrugën e Allahut. Megjithëse drejtimi i Omer ibn Abdulazizit zgjati vetëm dy vjet e gjysmë, në kohën e tij për herë të parë në histori të pasurit nuk gjenin njerëz të varfër për të dhënë zekatin.

Prandaj drejtuesit e çdo niveli duhet të tregojnë kujdes në sjelljet dhe veprimet që kryejnë, sepse një gabim i tyre përfshin gjithë shoqërinë.

Një ditë, Ebu Hanife has një fëmijë që po ecte përmes baltës. Duke i buzëqeshur me mëshirë dhe dhembshuri, i tha:

- O bir, ki kujdes, të mos rrëzohesh!

Me sytë që i shndrisnin nga zgjuarsia, fëmija u kthye ndaj imami dhe i dha këtë përgjigje befusuese:

- O imam, rrëzimi im është i thjeshtë se, po të rrëzohem, dëmtohem vetëm unë! Në fakt, ju duhet të keni kujdes, sepse, po ju rrëshqiti këmba juve, ka për t'u rrëshqitur edhe atyre që vijnë pas jush dhe do të rrëzohen e pastaj për t'i ngritur në këmbë të gjithë ata, do të jetë shumë e vështirë!

Imami, që mbeti i mahnitur dhe admirues ndaj fjalëve të fëmijës, nisi të qante dhe u tha kështu nxënësve:

- Po qe se në një çështje ju arrini ndonjë provë apo argument më të fuqishëm, mos më ndiqni në atë çështje. Ky është në Islam treguesi i përkryerjes. Dashuria dhe besnikëria që keni ndaj meje vetëm në këtë mënyrë le të dalë në shesh!..

Drejtuesit janë pasqyrë e shoqërisë dhe shoqëria është pasqyrë e drejtuesve. Pejgamberi ﷺ, thotë:



“Si të jeni, ashtu do të drejtoheni.” (Sujuti, Xhamius Sagir, II, 82)

Prandaj Allahu kërkon prej nesh të ndërtojmë një shoqëri të bazuar mbi devotshmëri dhe të marrim si pikë orientimi njerëzit e devotshëm dhe të sinqertë. Allahu në lidhje me këtë, thotë: **“O Zoti ynë, na dhuro nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe na bëj shembull për të mirët!”** (Furkan,74)

Sepse një shoqëri e përbërë nga anëtarë të devotshëm nuk lejon devijimin nga e drejta të personave që udhëheqin. Ditën që Ebu Bekri u zgjodh kalif mbajti para popullit këtë fjalim:

“O njerëz u zgjodha i pari juaj duke mos qenë më i miri prej jush. Nëse e kryej mirë detyrën, më ndihmoni dhe nëse gaboj, më tregoni të drejtën...m’u bindni mua, përderisa unë i bindem Allahut, nëse unë nuk i bindem Allahut, as ju mos m’u bindni mua. Allahu ju mëshiroftë.”
(Ibn Sad, III, 182-183)

Nga ana tjetër, një shoqëri e zhytur në mëkate nuk dëshiron një drejtues të devotshëm. Sepse të gjithë duan të ngjashmin e vet. Ata ndjejnë kënaqësi nga degjenerimi ku ndodhen. Nuk marrin kënaqësi nga trëndafili dhe miski, përkundrazi, ata shqetësohen nga aroma e mirë e tyre. Populli i degjeneruar i Lutit عليه السلام, ndjente neveri prej njerëzve të moralshëm dhe të pastër. Dhe për shkak të moralit të tyre, i kërcënuan me dëbim nga vendi.

Jeta e njerëzve të mirë që prijnë shoqërinë dhe i ekspozojnë zemrat e tyre plot virtyte njerëzimit, vazhdon edhe pas kësaj jete të përkohshme. Shembuj të gjallë të kësaj janë



pejgamberët dhe ndjekësit e sinqertë të tyre. Sa më shumë që këshillat dhe porosinë e tyre të shkrihen dhe gdhenden në zemrat tona, aq më të mbrojtur jemi në ndaj dëmeve të shthurjes.

Në një kohë, në tokë shëtisnin njerëz plot vlera të cilët prinin njerëzimin, kurse sot, toka është mbushur me njerëz me xhybe, por pa zemër.

Në një botë gjithnjë e më globale bota shpirtërore po humbet dhe po shkrihet. Mozaiku i përgjithshëm i botës të kujton një karvan që ka humbur rrugën dhe të privuar nga udhërrëfyesi. Ringjallja e ymetit arrihet vetëm përmes ringjalljes shpirtërore dhe ringjallja shpirtërore arrihet duke ndjekur Pejgamberin ﷺ dhe njerëzit e dashur të Allahut. Mevlana e shpreh kështu këtë realitet:

“Nëse dëshiron të më kuptosh, të më dëgjosh, të thellosh dhe të lexosh të vërtetën duhet të bëhesh si unë...”

I lutemi Allahut të na mbajë në rrugën e njerëzve të Tij të dashur dhe të na ndihmojë për të qenë besimtarë të mirë dhe shembull për njerëzit!

Amin!..



Sekreti i rinisë



Rinia e çdo epoke jeton në një atmosferë të mbushur me entuziazëm. Kjo atmosferë shërben si barometër për të matur ecurinë e gjithë shoqërisë. Thënë ndryshe, çdo komb merr formë dhe karakter sipas botës shpirtërore dhe intelektuale të rinisë.

SEKRETI I RINISË

Nuk është mrekulli për të parashikuar të ardhmen e një populli. Sepse për të parashikuar të ardhmen e një vendi mjafton të shikosh rininë e atij vendi. Rinia e çdo epoke jeton në një atmosferë të mbushur me entuziazëm. Kjo atmosferë shërben si barometër për të matur ecurinë e gjithë shoqërisë. Thënë ndryshe, çdo komb merr formë dhe karakter sipas botës shpirtërore dhe intelektuale të rinisë. Nëse rinia e një kombi e harxhon energjinë për mirë, e ardhmja e atij kombi është e ndritur dhe e kundërta, nëse energjinë e harxhojnë në gjëra boshe, atëherë e ardhmja e atij kombi është e zymtë.

Një shembull historik i kësaj të vërtete është sulltan Fatihu, i cili me bindje dhe vendosmëri të fortë mori iniciativën për të çliruar Stambollin. Idealet e fëmijërisë dhe rinisë ishin shenjat e para që ai në të ardhmen do të bëhej një personalitet i madh. Shkaku që e shtyu sulltan Muratin të ulte në fron Fatihun, ishte zbulimi i virtyteve të larta tek personi i tij.

Një herë, kur po qëndronin në bahçe, u zhvillua ky dialog mbresëlënës midis Sulltan Muratit dhe djalit të tij, Fatihut.



“O baba! Ku qëndron sekreti që nuk shikoj tek ju shenjat e pleqërisë si tek moshatarët tuaj, megjithëse ju keni vuajtur dhe keni një barrë të rëndë mbi shpinë. Ju jeni plakur si të tjerët, por nuk jeni kërrusur dhe shtrembëruar si ata. Edhe pse keni vuajtur dhe jeni munduar shumë, e përdorni shumë mirë mendjen dhe vullnetin tuaj bashkë me energjinë, heroizmin dhe trimërinë e moshës së re. Shikoj se në fushat e luftës jeni një komandant që korr fitore, në kuvendet e dijes jeni një mjeshtër i thellë, jeni një dervish i sinqertë që i shërben popullit!.. Nuk keni as natë as ditë! Si ia dilni mbanë kundrejt këtyre, duke e mbajtur trupin drejt dhe pa e vjetëruar shpirtin tuaj delikat? Ç’është kjo punë baba?.. Në një kohë kur preokupimi i vazhdueshëm i mendjes e tret dhe mbaron njeriun, te ju s’ka arritur të shkaktojë ndonjë ndryshim dhe nuk ka mundur ta prishë gjendjen tuaj të qetë!.. Çfarë ilaçi pini për karakterin e veçantë që keni dhe çfarë lëngu përdorni për mendjen tuaj brilante? A mund të m’i mësoni edhe mua këto, që të eci edhe unë në rrugën tuaj...”

Përveçse u habit shumë nga këto pyetje që nuk i priste prej birit të tij, Sulltan Murat Hani II u gëzua shumë dhe i dha këtë këshillë historike:

“O biri im i dashur! Më gëzove. Zoti i lartë, të cilin e adhurojnë gjithësia dhe të gjitha krijesat, t’i shtoftë virtytet që t’i ka dhënë. Të bëftë që të interesohesh vazhdimisht për të studiuar dhe për të kërkuar rreth çështjeve të tilla të mëdha dhe të gjera.

O biri im! Le të thonë ç’të duan, por unë besoj se ata



që jetojnë në drejtësi, kur ndahen nga kjo botë do të fitojnë në Ahiret mirësi të pafundme që nuk mund të imagjinohen. Në këtë që besoj nuk kam as dyshimin më të vogël. Për këtë arsye, adhurimet që i bëj për Allahun e lartë, i bëj në mënyrën më të sigurtë dhe të përzemërt. Unë besoj shpërblimin e këtyre vuajtjeve që kam hequr dhe këtë botë brengash dhe mundimesh, do të ma japë Allahu në Ahiret dhe në çdo çështje i kërkoj mbrojtje Atij, veçanërisht, mendoj se caktimi i Tij, domethënë kaderi i Tij për mua është një nder i madh.

O biri im! Mos i beso dhe mos u mashtro ndaj çdo gjëje që thuhet, duhet ta mësosh dhe mendosh fytyrën e brendshme të çdo lloj situatë dhe t'i qasesh vetë së vërtetës!

Siç hahet mirë një frut vetëm atëherë kur piqet, ashtu edhe ata të cilët kanë dije dhe përvojë, janë përherë të përshtatshëm për t'i zgjedhur, përndryshe, të hash fruta akoma të papjekura, kur ka rrush të pjekur dhe të shijshëm, është dobësi e mendjes.

O biri im! Herë-herë kujtoj gjyshërit e mi të nderuar. Humbas në mendime për të ardhmen e brezave të mëvonshëm. Elhamdulillah, deri sot kemi ardhur me dashuri, respekt dhe besnikëri. Shpresoj se edhe pas të sotmes të vazhdojmë në të njëjtën mënyrë. Ashtu siç lindëm dhe erdhëm, përsëri ashtu dua të shkojmë...

Dije mirë se vazhdimi i çdo lloj gjëje nuk është i mundur me forcë, shpatë, heroizëm dhe me poshtërim. Mendja, marrja e masave, durimi, largpamësia, provimi dhe përvojat



lodhëse janë shumë të rëndësishme. Mënyra e parë, pra forca dhe shpata nuk është gjithmonë e suksesshme por edhe vetëm mënyra e dytë nuk mjafton. Për të pasur sukses duhet një harmonizim i mirë midis forcës dhe mendjes! Mos harro, në të vërtetë gjyshërit tanë të vyer i kanë korrur fitoret e mëdha me mendje, logjikë dhe me forcën e dashurisë, dhe jo nën hijen e shpatës siç duket në pamjen e jashtme.

O biri im! Kujdes, mos e lër drejtësinë qoftë edhe një çast, sepse Allahu i madhërishëm është i drejtë dhe e do të drejtin. Nga një aspekt, ti je halifja e Tij në këtë tokë. Ai të ka dhënë disa të mira dhe të ka bërë komandant në krye të robërve të Tij, këtë mos e harro!..

O biri im! Në këtë botë ka tre lloj njerëzish:

Grupi i parë, janë njerëzit që e kanë mendjen në vend, e shikojnë pak a shumë të ardhmen dhe janë besnikë.

Grupi i dytë, janë ata njerëz që nuk e dinë se cila rrugë është e vërtetë apo e gabuar, por nuk kanë rënë në këtë gjendje me dëshirën e tyre, por me ndikimin e njerëzve. Kur këshillohen, vijnë në rrugë të drejtë, e pranojnë të vërtetën dhe ta dëgjojnë fjalën. Krahas kësaj, shumicën e kohës e jetojnë duke iu përshtatur atyre që kanë dëgjuar.

Ndërsa grupi i tretë, janë njerëz që nuk dinë gjë dhe nuk dëgjojnë as qortim e as këshillë. Vetëm u përshtaten dëshirave të veta dhe pandehin se dinë çdo gjë. Këta janë ata më të rrezikshmit.

O biri im! Nëse Allahu të ka krijuar nga njerëzit që



numërova në grupin e parë, gëzohem dhe e falënderoj Allahun. Nëse je nga grupi i dytë, të këshilloj që t'ua vësh veshin këshillave dhe qortimeve. Bëj kujdes që të mos jesh nga grupi i tretë! Ata nuk janë në një gjendje të mirë as para Allahut, as para njerëzve.

O biri im! Padishahët u ngjajnë njerëzve që kanë peshore në dorë, por padishahu i vërtetë është ai që e mban drejt peshoren që ka në dorë! Kur të bëhesh padishah, të këshilloj ta mbash drejt peshoren. Atëherë edhe Allahu i lartë të jep mirësi dhe të bën prej të devotshmëve. Ai di gjithçka...”

Ky dialog plot urtësi, këshilla dhe intuitë midis babait dhe të birit tregon më së miri mbi çfarë themelesh ishte ndërtuar perandoria Osmane.

Në të vërtetë, njerëzit janë si shtetet dhe shtetet si njerëzit. Sepse ai që e ndërton, drejton dhe shkatërron shtetin është njeriu. Morali i njerëzve ose e lartëson shtetin, ose e rrënon atë. Kur njerëzit që përbëjnë bashkësinë janë të pajisur me moral dhe botë shpirtërore edhe shteti merr ngjyrën e bashkësisë. Dhe e kundërta, kur njerëzit që përbëjnë shtetin janë të pamoralshëm dhe me botë shpirtërore të varfër, shteti bëhet arenë e despotizmit dhe padrejtësive.

Është shumë e rëndësishme që bota e brendshme e njeriut të ushqehet vazhdimisht me virtyte, në mënyrë që të triumfojë mbi prirjet negative të egos. Ata që e arrijnë këtë, janë njerëzit më fatlumë, si në këtë botë dhe në botën tjetër.

Zoti ynë! Na mundëso edhe ne pjesë nga zjarri i



dashurisë së zemrave të miqve të së vërtetës! Dhe na mundëso të orientohemi me vërejtjet, paralajmërimet dhe këshillat e begata të miqve të Allahut. Na ruaj prej dobësive dhe kurtheve të kësaj bote..! Na bëj prej robërve Tuaj të dashur.

Amin..!





Si të jetosh do të vdesësh



Çdo ditë dhe çdo moment që kalon na afron më shumë me vdekjen. Jeta e njeriut është si një godinë që vjetërohet, por që nuk mund t'i bëhet konstruksion. Si çdo gjë në këtë botë edhe jeta është e përkohshme.

Kurse jeta e pafundme dhe e përjetshme është një e vërtetë shumë e madhe për t'u kufizuar midis lindjes dhe vdekjes. Jeta e kësaj bote përballë jetës së botës tjetër është si një pikë ujë në oqean.



SI TË JETOSH DO TË VDESËSH

Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. (Fussilet, 30)

Pejgamberi ﷺ, duke dashur të tregonte përkohshmërinë dhe karakterin provues të kësaj bote në luftën e Hendekut, ku myslimanëve po u humbiste durimi dhe gjakftohtësia, u predikonte për botën tjetër, duke u thënë se jeta e vërtetë është jeta në botën tjetër dhe çdo vuajtje dhe shqetësim në këtë botë është një kapital për botën tjetër.

Përsëri kur Pejgamberi ﷺ dhe myslimanët arritën fitoren historike dhe madhështore të çlirimit të Mekës, për të mos u bërë pre e krenarisë dhe mendjemadhësisë, vazhdimisht thoshte: “Jeta e vërtetë është jeta e botës tjetër.”

Ata që e pandehin mjerimin lumturi, kur pyeten se çfarë është jeta? Thonë: “Jeta është kjo që jetojmë këtu dhe që mbaron me vdekjen.” Sa e mjerueshme gjendja e atyre që mendojnë se jeta përfundon në varr.

A nuk mjaftojnë fatkeqësitë, sëmundjet, rreziqet dhe surprizat e ndryshme në jetë për të treguar vijën e hollë ndarëse midis vdekjes dhe njeriut?! Është fatkeqësi të jesh



kaq indiferent ndaj të vërtetës përballë kaq shumë shenjave orientuese.

Në të vërtetë, ne çdo ditë në mënyrë të pavetëdijshme i afrohemi më shumë vdekjes. Jeta e amëshuar është një e vërtetë, që në asnjë mënyrë nuk mund të kufizohet midis lindjes dhe vdekjes. Jeta e kësaj bote përballë jetës së botës tjetër është si një pikë ujë në oqean.

Prandaj jeta e vërtetë është jeta e jetuar sipas Kuranit dhe Pejgamberit ﷺ, për të fituar parajsën në botën tjetër. Rruga për në Xhenet kalon përmes kalimit me sukses të sprovave të kësaj bote.

Poeti e shpreh kështu jetën plot qetësi, të ndërtuar sipas qëllimit të krijimit.

*Ditën që linde qave
Kurse njerëzit pranë teje qeshnin
Bëj një jetë që kur të vdesësh të qeshësh
Dhe njerëzit të qajnë!..*

Njeriut, gjatë përjetimit të agonisë, i shfaqen të gjitha veprat e mira dhe të këqija përpara pors i një pasqyrë. Që të mos na shfaqet një panoramë e trishtueshme, duhet të bëjmë një jetë sipas Kuranit dhe Sunetit të Pejgamberit ﷺ, sepse Ai thotë: “Njeriu si të jetojë do të vdesë dhe si të vdesë do të ringjallet.”

Agonia është momenti i fundit i kësaj bote të përkohshme. Ky moment është shumë i rëndësishëm për të shikuar vendin në botën tjetër.



Nuk duhet të harrojmë që besimtarët e singertë e vazhdojnë jetën e qetë dhe të lumtur të kësaj bote edhe në botën tjetër. Sipas hadithit profetik, jeta e besimtarëve në varr do të jetë një bahçe prej bahçeve të Xhenetit.





Lëre barrën dhe kalo



Dhënia pas kësaj bote, duke harruar Ahiretin është pasojë e neglizhencës dhe indiferencës së njeriut ndaj jetës së amëshuar në botën tjetër. Jobsimtarët dhe të shthururit, në Ditën e Gjykimit, për të shpëtuar nga dënimi i ashpër, do të jenë të gatshëm të japin gjithë pasurinë që kanë në dynja. Por ata e kanë humbur mundësinë e tyre.



LËRE BARRËN DHE KALO

Një njeri i dashur i Allahut tregon një ngjarje të përjetuar dhe plot urtësi, që shpreh mjaft mirë ambicien e njeriut.

“Një ditë isha ulur për të pushuar nën hijen e një peme. Më tërhoqi vëmendjen një milingonë e cila kishte mbi kurriz një thërrmijë buke shumë herë më të madhe se trupi i saj. Nganjëherë përballej me pellgaçe, të cilave u vinte përqark për të kaluar në anën tjetër, nganjëherë pengohesh nga ndonjë fije bari. Por me gjithë këto vështirësi, as thërrmijën e bukës nuk e linte dhe as nuk e copëtonte për ta transportuar më lehtë. Më në fund, arriti së bashku me thërrmijën në kurriz tek foleja. Por korridori ishte i ngushtë për të kaluar thërrmijën. Me gjithë përpjekjet e mëdha, nuk arriti ta kalonte thërrmijën e bukës. Provoi të gjitha mënyrat për ta kaluar, por përsëri nuk ia arriti qëllimit.

Kjo panoramë më nxiti të mendoj për veten time. Më erdhi në mendje se me çfarë logjike përpiqemi të fusim në varr pasuritë e grumbulluara të kësaj bote, kur në botën tjetër na presin gjëra shumë më të bukura!..”

Dhënia pas pasurisë së kësaj bote dhe kënaqësive të përkohshme është një humbje për lumturinë dhe pasurinë



e përhershme në botën tjetër. Shitja e ahiretit për një çmim fare të vogël i ngjason shitjes së Jusufit عليه السلام, për dy-tre kacidhe.

Kur vëllezërit smirëzinj e hodhën Jusufin عليه السلام, në pus, Allahu e mbrojti atë. Kur një udhëtar hodhi kovën për të tërhequr ujë, gjeti Jusufin عليه السلام. Udhëtari mbeti i mahnitur nga bukuria e Jusufit عليه السلام, por udhëtari nuk arriti të mahnitej edhe nga bukuria shpirtërore e tij. Prandaj vendosi ta shesë për një çmim të vogël. Udhëtari duhej të vlerësonte bukuri-në shpirtërore të Jusufit عليه السلام, mirëpo duke qenë indiferent përballë anës shpirtërore, e shiti atë në këmbim të një vlere tepër të vogël materiale.

Mevlana e shpreh kështu rendjen pas bukurive të kësaj bote, duke harruar bukuritë e botës tjetër:

“Ata që e kanë të lidhur zemrën me pasuritë e kësaj bote, janë si gjuetari i hijeve. Si mund të gjuhet hija? Prandaj, një gjuetar idiot, duke e pandehur hijen e zogut vetë zogun deshi ta kapte. Përballë këtij veprimi edhe zogu që ishte mbi degën e pemës mbeti i shtangur.”

Është shumë mësimdhënëse ndodhia e Behlul Danës me Kalifin Harun Reshid.

Behlul Dana ishte një nga njerëzit më të urtë të kohës, i cili me urtësinë e tij këshillonte njerëzit. Herë pas here këshillonte edhe halifen. Por edhe Harun Rashidi e respektonte.

U bë një kohë mjaft e gjatë që Behlul Dana nuk kishte shkuar te Haruni Rashidi. Harun Rashidi kur e takoi, e pyeti:



- Behlul, ku ke qenë, u bën shumë kohë që nuk të shikoj?

- Vizitova Xhehenemin.

- Si hyre atje, a nuk te dogji zjarri?

Behlul Dana i dha këtë përgjigje mbresëlënëse:

- *Jo nuk më dogji, aty nuk pashë fare zjarr, sepse të gjithë e sillnin zjarrin e vet nga kjo botë!..*

Janë pikërisht dëshirat e njerëzve në këtë botë ato që shndërrohen në gaca zjarri në Ditën e Kiametit. Çdo gjë që dërgojmë në botën tjetër është e jona, kurse çdo gjë që lëmë këtu është e trashëgimtarëve.

Në një transmetim të Ebu Hurejres thuhet:

“Kur vdes njeriu, melekët thonë ‘çfarë sollti’? kurse njerëzit thonë ‘çfarë la?’” (Bejhaki, shuubul iman, VII, 10475)

Pejgamberi ﷺ, një ditë u tha sahabëve:

-*Cili prej jush e do pasurinë e trashëgimtarëve të vet më shumë se pasurinë e vet?*

Ata thanë:

-Për çdonjërin nga ne më e dashur është pasuria jonë sesa pasuria e trashëgimtarëve.

Atëherë, i Dërguari i Allahut tha:

“Vërtet, pasuria e tij është ajo që e ka shpenzuar, ndërsa pasuria e trashëgimtarëve të tij është ajo që e ka lënë pas.” (Buhari, Rikak, 12)

Këtë të vërtetë e ilustron shumë bukur shembulli i



Pejgamberit ﷺ, kur theri një dele dhe pasi e shpërndaui një pjesë të mirë, pyeti Aishen ؓ, se sa kishte mbetur. Aishja ؓ, i tha:

- Ne na ka mbetur vetëm një pjesë shumë e vogël.

Pejgamberi ﷺ, tha:

- Thuaj na ka mbetur e gjitha, përveç një pjese të vogël.

(Tirmidhi, Kijame, 33)

Prandaj besimtari nuk duhet të harrojë që pasuria është si një thikë me dy presa. Pasuria mund të përdoret për mirësi, por mund të përdoret edhe për keq. Njerëzit indiferentë ndaj botës tjetër e shpenzojnë pasurinë pa kriter vetëm për të plotësuar dëshirat e ulëta të kësaj bote. Pasuria nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, por duhet të shërbejë si mjet për të fituar botën tjetër. Sepse në Ditën e Gjykimit do të japim llogari për pasurinë e fituar. Siç e konfirmon ajeti kuranor: **“Atë ditë do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!** (Tekathur, 8)

Sa fatkeqësi e madhe për ata që mirësitë e Allahut i përdorin për të plotësuar dëshirat e kësaj bote dhe sa fatlumë ata që mirësitë e Allahut i përdorin si mjet për t'u afruar me Allahun.

Dhënia pas kësaj bote, duke harruar Ahiretin është pasojë e neglizhencës dhe indiferencës së njeriut ndaj jetës së amëshuar në botën tjetër. Jobesimtarët dhe të shtururit, në Ditën e Gjykimit, për të shpëtuar nga dënimi i ashpër, do të jenë të gatshëm të japin gjithë pasurinë që kanë në dynja. Por ata e kanë humbur mundësinë e tyre. Këtë gjendje, ajeti kuranor e përshkruan kështu:



“Atë Ditë qielli do të bëhet si llumi i vajit e malet do të bëhen si lesh i shprishur, shoku s’do të pyesë për shokun, edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllanë e vet, edhe farefisnin, që i gjendej pranë (në jetën e Tokës), si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte. Por jo, (fajtori do të hidhet në zjarr)! Ai është zjarr flakërues.”
(Mearixh, 8-15)

Kurse në një hadith, gjendja e jobesimtarëve përshkruhet kështu:

“Në Ditën e Gjykimit sillet një jobesimtar dhe i thuhet: ‘A je gati të japësh gjithë pasurinë si shpagim për të shpëtuar?’ Ai do të thotë ‘Po’, pastaj i thuhet: ‘Ty t’u kërkua diçka më e lehtë kur ishe në dynja, por iu shmange.’” (Buhari, Rikak, 49)

Kurse një njeri i urtë tregon:

“Pashë një ëndërr sikur isha mbi një urë që kalonte mbi Xhehenem. Gjithë frikë thashë me vete si do të kaloja? Kur një zë aty pranë më tha: “Lërë barrën dhe kalo!”

I thashë: “Çfarë barre?”

Tha:

“Dynjanë.” (Ruhul Bejan, II, 470)

Kuptimin e braktisjes së dynjasë Rumi e shpreh kështu:



“Dije mirë se dynjaja nuk është pasuri, para, mall, tregti dhe gra. Dynjaja është indiferenca ndaj Krijuesit”

Prandaj duhet që besimtari të pastrojë zemrën nga çdo gjë që sjell harresën e Allahut.

Allahu na bëftë prej atyre që mirësitë e kësaj bote i shfrytëzojnë si kapital për botën tjetër... i lutemi Zotit që Ditën e Gjykimit të na përfshijë në mëshirën e Tij.

Amin...



Gruaja e devotshme -1-



Lumturia e femrës është e mundur përmes jetës së saj prej zonje. Nëse gruaja del jashtë detyrës që i është ngarkuar, atëherë familja fillon të ftohet. Pjesëmarrja e gruas në aktivitete jashtë familjes është vetëm për raste të domosdoshme. Shkaqet që e detyrojnë gruan të dalë punë duhet të vlerësohen sa më objektivisht. Vetëm nëse shkaqet janë objektive dhe detyra i përshtatet natyrës së gruas, mundet të dalë në punë jashtë familjes. Edhe në këtë rast ajo duhet t'i shërbejë shoqërisë, por gjithmonë brenda kufijve legjitimë të përcaktuar nga feja.

GRUAJA E DEVOTSHME -1-

Vetmia dhe njësimi i përket vetëm Allahut. Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat çift. Tek njeriu dhe kafshët kemi çiftin mashkull-femër, kurse tek përbërjet kimike kemi çiftin pozitiv-negativ.

“Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!” (Dharijat, 49)

“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!” (Jasin, 36)

Për shkak të kësaj veçorie, të gjitha krijesat kanë nevojë për njëra-tjetrën, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të plotësohen. Duke plotësuar njëri-tjetrin ata përbëjnë një të tërë.

Nevoja e burrit dhe e gruas për njëri-tjetrin është për të siguruar vazhdimësinë e prejardhjes njerëzore. Por nuk është ky qëllimi i vetëm. Sepse krijimi i një familjeje të shëndoshë dhe të lumtur është po aq i rëndësishëm për shoqërinë njerëzore.

Në të gjitha krijesat ekziston ndjenja e dashurisë. Para se të krijohej gjithësia, Zoti ishte një thesar i fshehur. Ai me



dashurinë e Tij krijoi gjithësinë. Prandaj thelbi i çdo gjëje është dashuria.

Dashuria që u dhuroi Allahu të gjitha krijesave është një mjet për të arritur tek dashuria hyjnore. Dhe për të arritur dashurinë e Allahut, Ai i dhuroi njeriut dashurinë bashkëshortore si një hap i parë për të arritur dashurinë hyjnore.

Por, që dashuria midis burrit dhe gruas të shërbejë si mjet për të arritur dashurinë e Allahut, duhet të realizohet sipas urdhëresave hyjnore. Një martesë e bazuar thjesht në pasion nuk e arrin dot gradën e dashurisë në fjalë. Në një familje të tillë nuk mund të krijohen kushtet e përshtatshme për të arritur pjekurinë e duhur shpirtërore, sepse në martesë të tilla njerëzit bëhen skllëvër të epsheve. Një martesë e tillë, jo vetëm që nuk e ndihmon procesin e pjekurisë shpirtërore, por përkundrazi, e dëmton atë duke e çuar deri në shkatërrim.

Kurse martesat që ndihmojnë në pjekurinë shpirtërore dhe plotësojnë gjysmën e fesë janë martesat ideale, të cilat synohen të arrihen.

Në këtë kontekst, jeta familjare e peygamberëve është një shembull ideal për të gjithë njerëzit. Tradita e martesës ideale ka filluar me Ademin dhe Havanë në Xhenet, duke u trashëguar më vonë nga pasardhësit e tij. Kurse feja islame e përjetësoi martesën ideale. Allahu, i cili e krijoi jetën familjare midis Ademit dhe Havasë në Xhenet, u dhuroi jetës familjare të trashëgimtarëve të Ademit ﷺ, atmosferën e Xhenetit.

Prandaj martesë është traditë e peygamberëve, Sunet



i Muhamedit ﷺ, kështjellë e nderit dhe moralit dhe dallim i njeriut nga krijesat e tjera, sepse në krijesat e tjera nuk mund të bëhet fjalë për martesë.

Martesa është një ligj hyjnor, karakteristikë vetëm për njeriun. Prandaj martesa në Islam është një themel kryesor për të ruajtur prejardhjen, për të edukuar fëmijët dhe për të mbrojtur harmoninë e ndjeshmërinë njerëzore.

Familjet janë gurë themeli për shoqërinë. Historia ka treguar që familjet e shëndosha krijojnë shoqëri të shëndosha, kurse familjet e ndërtruara në baza jo të shëndosha sjellin degjenerimin dhe shkatërrimin e shoqërisë.

Mevlana në lidhje me çështjen në fjalë, thotë:

“Bashkëshortët duhet të ngjajnë me njëri-tjetrin. Shiko këpucët! Nëse njëra këpucë rri ngushtë në këmbë, atëherë as tjetra nuk mund të përdoret.”

Përsëri Mevlana i këshillon kështu të rinjtë, në mënyrë që të mos bien pre e epsheve gjatë martesës.

“Qëndro larg atyre që në pamje janë të bukura, kurse nga brenda janë të shëmtuara. Sepse Profeti ﷺ, thotë:

“Kujdes..! Kujdes..! Ruajuni nga lulja që ka çelur në mbeturina, në fis të keq dhe vese të këqija.”

Familjet që ndërtohen pa treguar këtë ndjeshmëri, në vend që të jenë burim qetësie dhe zhvillimi për shoqërinë, bëhen burim fatkeqësie.

Gruaja është si një abazhur diamanti, që ndriçon dhomën e qetësisë dhe lumturisë. Martesa ndriçon shoqërinë dhe



ruan nderin dhe dinjitetin e familjes. Familja është mburoja kryesore kundër erozionit shoqëror dhe moral. Përndryshe, brezat e rinj do të shndërroheshin në një gërmadhë. Prishja e brezit çon në dobësimin e marrëdhënieve fafesisnore. Në këtë gjendje, përhapet intriga dhe shthurja, poshtërsitë dhe shqetësimet pushtojnë shoqërinë, kurse ndjenjat e larta dhe sublime humbasin: këto janë simptomat e perëndimit të një shoqërie.

Përmes martesës së ligjshme, gruaja hyn në një botë krejt të re. Ndoshta mund t'i qëllojë të jetojë me një njeri krejt të panjohur deri atëherë. Por në saj të natyrës që i ka dhënë Allahu martesës, dy persona krejt të panjohur më parë, menjëherë bëhen miq të ngushtë me njëri-tjetrin. Familja e re e ndërtuar rishtas fillon të bëhet më e dashur dhe e ngrohtë se familja e babait. Në lidhje me këtë, Allahu në Kuran thotë:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”

(Rrum, 21)

Një familje e ndërtuar sipas Kuranit dhe Sunetit është themeli i një jete të lumtur dhe një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka dhuruar njeriut. Për vazhdimësinë e kësaj atmosfere është e domosdoshme sakrificat dhe përpjekja e të dy palëve.

Në periudhën moderne po propagandohet fort barazia gjinore. Kjo ka sjellë dëmtimin e natyrës së gruas, për të cilën



ajo është krijuar, humbjen e qetësisë familjare, dëmtim të personalitetit të individit dhe tronditje të jetës shoqërore.

Femra nuk mund të jetë e barabartë me mashkullin, sepse natyra fizike dhe shpirtërore e saj nuk janë të njëjta me të mashkullit. E rëndësishme nuk është barazia midis gjinive, por ekuilibri i të drejtave dhe detyrave midis tyre.

Allahu i ka krijuar burrin dhe gruan si plotësues të njëri-tjetrit dhe për këtë u ka ndarë detyra të veçanta dhe secilit i ka dhënë aftësi të veçanta për plotësimin e detyrës. Burri dhe gruaja e arrijnë qëllimin e krijimit vetëm kur bëhet bashkimi materialo-shpirtëror i tyre. Atëherë lind pjekuria dhe harmonia midis çiftit, kjo pastaj sjell qetësinë shoqërore.

Lumturia e femrës është e mundur përmes jetës së saj prej zonje. Nëse gruaja del jashtë detyrës që i është ngarkuar, atëherë familja fillon të ftohet. Pjesëmarrja e gruas në aktivitete jashtë familjes është vetëm për raste të domosdoshme. Shkaqet që e detyrojnë gruan të dalë në punë duhet të vlerësohen sa më objektivisht. Vetëm nëse shkaqet janë objektive dhe detyra i përshtatet natyrës së gruas, mundet të dalë në punë jashtë familjes. Edhe në këtë rast ajo duhet t'i shërbejë shoqërisë, por gjithmonë brenda kufijve legjitimë të përcaktuar nga feja. Kurse shkëlja e kufijve me pretekste boshe dhe të paarsyeshme, nuk është gjë tjetër veçse vetëmashtrim. Në të tilla raste, përfundimi ka qenë gjithmonë i keq. Sa e sa vajza janë mbytur në këtë batac në periudhën e fundit. Shumë vajza kanë qenë të verbëra përballë realitet hyjnor, duke humbur në këtë mënyrë lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër.



Është krejt e palogjikshme t'i largosh gratë nga detyra për të edukuar fëmijët, duke i drejtuar nëpër detyra që nuk janë në përputhje me natyrën e tyre. Sepse lumturia dhe qetësia në familje mund të arrihet vetëm përmes ndarjes së detyrave të bashkëshortëve sipas aftësive dhe qëllimit të krijimit të tyre.

Madhështia morale, shoqërore dhe kombëtare e gruas qëndron në jetën familjare.

Një nga shkaqet kryesore të erozionit të familjes dhe për pasojë atij shoqëror, është ndërrimi i roleve burrë-grua. Allahu nuk i ka dhënë aftësi të njëjta burrit dhe gruas. Kryerja e detyrave përkatëse nga burri dhe gruaja në të mirë të shoqërisë është përcaktuar nga feja. Përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar sipas krijimit, aftësive dhe veçorive fiziko-shpirtërore të tyre.

Allahu e ka krijuar gruan më të pasur me ndjenja sesa burri. Kjo pasuri ndjenjash është me qëllimin e kryerjes së detyrës për të cilën është krijuar. Dhe detyra e saj është ruajtja e prejardhjes njerëzore dhe edukimi i fëmijëve me dashurinë fetare, njerëzore dhe atdhetare. Nëse dilet jashtë këtij përcaktimi hyjnor, natyra e gruas është përdhosur.

Burrit, i cili është ngarkuar me detyrën e sigurimit të jetesës për familjen, i janë dhënë aftësi të veçanta për përbushjen e detyrës. Tek burri forca shpirtërore, fizike dhe psikologjike është më e zhvilluar në krahasim me gruan. Të gjitha këto veçori e bëjnë burrin përgjegjës për sigurimin e jetesës së familjes.

Për shkak të veçorive të veçanta të gruas, ajo nuk është



bërë përgjegjëse për sigurimin e jetesës së familjes. Nëse do të ndodhte kjo, do të ishte padrejtësi dhe shtypje për të. Sepse natyra fizike dhe shpirtërore nuk janë krijuar për të përballuar luftën e jetesës. Asaj i është ngarkuar një detyrë shumë e shenjtë, e cila është kujdesi për foshnjën e porsalinëdruar, që ka shumë nevojë për dhembshurinë dhe ndjeshmërinë e nënës për të pasur një rritje dhe zhvillim të shëndoshë. Por nëse kushtet dhe mundësitë janë të përshtatshme për punë, pa e cenuar natyrën e gruas, ajo mund të punojë dhe shërbejë në profesione të ndryshme në të mirë të shoqërisë, siç janë mësueset etj.

Veçoritë e ndryshme të mashkullit dhe femrës janë për të plotësuar njëri-tjetrin dhe jo për të sunduar mbi njëri-tjetrin. Autoriteti i burrit në familje nuk duhet kuptuar si sundim dhe forcë mbi gruan dhe as bindja e gruas nuk duhet kuptuar si skllavëri. Nëse rolet në një familje përcaktohen sipas rregullave islame, në atë familje nuk ka vend për shtypës dhe të shtypur, por gjithësecili është i pari në rolin e vet.

Dalja e gruas jashtë kufijve të bindjes dhe nderit është padrejtësi për burrat, kurse përdorimi i autoritetit nga ana e burrit për plotësimin e dëshirave të tij është padrejtësi që i bëhet gruas. Të dyja sjellin shkatërrimin e familjes. Burri, i cili lufton jashtë për të siguruar jetesën e familjes herë-herë mund të përjetojë gjendje nervozizmi. Në të tilla raste është shumë i rëndësishëm qëndrimi i qetë plot dashuri e gruas në përmirësimin e gjendjes së burrit. Në të njëjtën kohë, është e drejta e gruas që ndaj saj të tregohet interes dhe dashuri nga burri. Prandaj burri dhe gruaja duhet t'i dinë mirë detyrat dhe të drejtat që u ka ngarkuar Allahu. Në familje burri duhet



të tregojë mëshirë, kurse gruaja bindje dhe respekt.

Në shumë familje në themel të mungesës së lumturisë martesore qëndron mosrespektimi dhe mosvlerësimi për njëri-tjetrin. Mirëpo bashkëshortët mund ta shndërrojnë familjen në parajsë ose ferr. Nëse gruaja është e kujdesshme ndaj detyrimeve hyjnore dhe e bindur ndaj kërkesave legjitime të burrit, ajo grua është në rrugën për në Xhenet.

Ajo që e mban në këmbë një familje është dashuria dhe respekti i ndërsjelltë. Por nuk duhet të harrojmë siç kanë thënë të parët tanë që: *“Folenë e krijon zogu femër.”*, prandaj gruaja duhet të luajë një rol më të rëndësishëm në ruajtjen e familjes. Përpyekja dhe sakrifica e gruas nga ky këndvështrim është më i rëndësishëm se i burrit. Sepse nga ky këndvështrim, Allahu i ka dhënë gruas më përparësi se burrit. Normalisht që kjo është për ato gra që nuk i kanë humbur aftësitë natyrore për të cilat edhe janë krijuar. Sepse ka dhe nëna pa zemër dhe pa shpirt që i braktisin rrugëve fëmijët e tyre të pafajshëm. Mirëpo, këto janë shpirta që i kanë humbur aftësitë dhe vlerat natyrore.

Nënë bëhesh duke zotëruar jo vetëm disa veçori fizike, por duke zotëruar edhe veçori të larta shpirtërore. Nuk mund të bëhesh nënë vetëm duke lindur fëmijë, por janë një sërë detyrash të tjera të domosdoshme. Nëse një grua nuk i përmban këto veçori, ajo nuk mundet të bëhet monument dhembshurie dhe dashurie. Gratë duhet ta ruajnë me të gjitha forcat thesarin e mëmësisë. Sepse ato do të përballen me fëmijët e tyre në Ditën e Gjykimit dhe në rast se nuk ia kanë dhënë hakun, do të gjykohen. Pra, fëmijët do të dalin



përballë prindërve ose në favor ose kundër tyre në Ditën e Gjykimit. Prandaj nëna më e mirë është ajo që i mirëdukon dhe i përgatit fëmijët për botën tjetër, duke u bërë kështu shkak për fitimin e xhenetit. Nëna duhet t'i japë fëmijës edukatë fetare, moral të bukur dhe ndërgjegje kolektive.

Një fjalë e urtë thotë: “Nëna është shkollë.” Nëna është mësuesja e parë dhe më e rëndësishmja, e cila, duke u bërë shembull për fëmijët, lë gjurmë të qëndrueshme në moralin dhe karakterin e fëmijës.

Islami nuk e shikon nënën thjesht si një organizëm biologjik. Por ajo është shumë e rëndësishme edhe për sa i përket anës shpirtërore të edukimit të fëmijëve. Nëse nënvlerësohet edukimi i një brezi, përfundimi është shumë i dhembshëm për shoqërinë. Fëmija shpirtërisht bëhet i huaj për familjen, madje mund të humbë edhe lidhja biologjike midis fëmijës dhe familjes. Thirrja dhe lotët e nënës nuk kanë dobi për të rregulluar gjendjen. Prandaj, për të pasur një fëmijë të përsosur, duhet një nënë dhe baba i përsosur.

Çdo fjalë që del prej gojës së nënës është si një tullë që vendoset në mur për të ndërtuar një shtëpi. Zemra e nënës është si një shkollë ku mëson fëmija, burimi më i madh i mëshirës është nëna. Fëmijët që privohen nga edukimi i nënës, është shumë vështirë të edukohen në shkollë. Njerëzit me karakter dhe personalitet, në përgjithësi janë fëmijët që janë rritur nga nëna të devotshme.

Një nënë që menaxhon punët e shtëpisë, edukon fëmijët dhe kujdeset për bashkëshortin, meriton një falënderim dhe respekt të përjetshëm.




Kombet lartësohen përmes burrave të tyre, por duhet të dimë që janë gratë ato që e plotësojnë lartësimin. Përparimi është i mundur vetëm me kontributin e të dyve. Një burrë që është i shqetësuar në familje, nuk mund të pritet prej tij të ketë sukses në punë dhe profesion. Prandaj një vend zhvillohet dhe përparon në saje të pjekurisë dhe urtësisë së femrës. Dhe e kundërta e kësaj, nëse një grua poshtërohet, ai vend humb vlerat dhe është i destinuar të rrënohet. Historia është e mbushur plot me shembuj të tillë. Prandaj është i domosdoshëm ndërtimi i familjeve të shëndosha.





Gruaja e devotshme -2-



Asnjë grua nuk mund ta dojë bashkëshortin ashtu siç e kanë dashur bashkëshortet Pejgamberin ﷺ. Po ashtu, asnjë burrë nuk mund t'i dojë bashkëshortet ashtu siç i ka dashur Pejgamberi ﷺ. Asnjë fëmijë nuk mund ta dojë babain si Fatimja ؑ dhe asnjë baba nuk mund ta dojë fëmijën e tij siç i donte Pejgamberi ﷺ, sepse ai ﷺ, përmes shembullit ideal pati kultivuar në zemrat e tyre një dashuri dhe lidhje të veçantë. Në shtëpinë e tij për ditë të tëra nuk ndizej zjarr dhe nuk gjendej ushqim për të ngrënë, por aty përjetohej kënaqësia që të jep durimi dhe nënshtrimi total ndaj Allahut.



GRUAJA E DEVOTSHME -2-

Personi që kërkon qetësi dhe lumturi familjare duhet të përpiqet të përfitojë prej atmosferës shpirtërore të familjes shembullore të Pejgamberit ﷺ.

Ajo ishte një familje aq e lumtur dhe e qetë, saqë, megjithëse në shtëpinë e tyre për ditë të tëra nuk gatuhej ushqim për shkak të varfërisë, aty buronte vetëm gëzim, lumturi, qetësi dhe harmoni. Dhomat e bashkëshortëve ishin shumë modeste dhe të thjeshta. Megjithatë, ajo familje ishte shembull tipik i mirësisë, kënaqësisë, durimit dhe nënshtimit të plotë. Metoda edukative që përdori Pejgamberi ﷺ, në jetën familjare i mbushi zemrat e bashkëshorteve me plot respekt dhe dashuri për Të.

Pejgamberi ﷺ, ka qenë shumë i drejtë me bashkëshortet e Tij. Ai ka treguar kujdes të veçantë në respektimin e drejtësisë, por në të njëjtën kohë, ka pohuar edhe vështirësinë për të siguruar drejtësinë.

Në jetën familjare duhet të sundojë dashuria, respekti harmonia dhe sakrifica, të gjitha këto nën atmosferën shpirtërore.

Pejgamberi ﷺ, e përshkruan kështu atmosferën e dashurisë në një familje të tillë:



“Kush zgjon gruan në mesin e natës dhe të dy së bashku falin nga dy rekat namaz, Allahu i shkruan midis burrave dhe grave që përmendin shumë Allahun.” (Ebu Davud, Tatavvu 18, Vitir 13)

“Allahu e mëshiroftë një mashkull i cili ngrihet për të falur namaz nate, zgjon edhe gruan e tij dhe, nëse ajo nuk zgjohet, ia lag fytyrën me ujë. Gjithashtu, Allahu e mëshiroftë një grua e cila zgjohet për të falur namaz nate dhe e zgjon burrin e saj dhe, nëse ai nuk zgjohet, ia lag fytyrën e tij me ujë.”

Nga këto dy hadithe kuptojmë që lumturia familjare është e lidhur me plotësimin e dy kushteve.

1. Singëriteti midis bashkëshortëve.
2. Inkurajimi reciprok për devotshmëri.

Lumturia arrihet duke ruajtur vlerat bashkëshortore. Ditët e lumtura, të gëzuara, të qeta dhe të singërta të bashkëshortëve arrihen vetëm nën mburojën e martesës.

Por nuk duhet të harrojmë që bashkëshortët përveç gëzimit, lumturisë dhe kënaqësisë duhet të ndajnë midis tyre edhe shqetësimet, problemet dhe momentet e hidhura që u servir jeta. Bashkëshortët duhet t'i gjenden gjithmonë pranë njëri-tjetrit. Ata sidomos duhet ta inkurajojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin në çështjet shpirtërore. Ata duhet të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën duke u bërë kështu burim qetësie dhe lumturie.

Sepse jeta nuk është gjithmonë me ngjyra, ajo shpesh i servir njeriut momente të vështira. Asnjëherë nuk duhet



harruar që jeta është e mbushur plot me ulje-ngritje. E ardhmja e njeriut është e mbushur plot me surpriza dhe të panjohura.

Kaderi është i panjohur për ne. Prandaj burimi më i madh i forcës sonë duhet të jetë besimi dhe mbështetja tek Allahu. Kurse burimi i dytë i forcës janë bashkëshortët e bashkuar si një zemër e vetme.

Duhet bërë kujdes, sepse njerëzit e lodhur dhe të pashpresë, kur përballen me vështirësi, probleme dhe fatkeqësi, nëse nuk gjejnë mbështetje në familje, rrënohen plotësisht. Ose fillojnë të kërkojnë mbështetje jashtë familjes, që është hapi i parë drejt shkatërrimit të familjes.

Kurse familjet e shëndosha dhe të pjekura shpirtërisht i përballojnë shumë më lehtë problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen në jetë. Fuqia e familjes, paralel me pjekurinë shpirtërore është e lidhur ngushtë edhe me aftësinë e bashkëshortëve për të jetuar dhe kaluar jetën së bashku.


Sipas Islamit, institucioni i familjes është i një vlere të veçantë, sepse ai siguron vazhdimin e jetës, edukimin e brezave dhe ruajtjen e njerëzillëkut.

Islami e ka vlerësuar aq shumë familjen, saqë çdo element që mund ta cenojë atë e ka konsideruar mëkat të madh dhe në mënyrë kategorike e ka refuzuar. Prandaj Islami ka konsideruar imoralitetin si një nga mëkatet e mëdha, sepse imoraliteti është një lloj krimi që shkatërron bukurinë, freskinë dhe hijeshinë e martesës. Nuk mund të ketë më injorancë dhe idiotësi sesa të ndërrosh burimin e qetësisë dhe lumturisë me diçka të fëlliqur dhe të shpifur.



Gjëja më e shtrenjtë dhe e çmuar e një gruaje është nderi i saj. Gruaja mund ta ruajë prestigjin dhe dinjitetin e saj vetëm përmes nderit. Feja jonë i ka dhënë shumë rëndësi nderit. Merjemja është lëvduar në Kuran për shkak të pastërtisë dhe nderit të saj dhe për këtë është përmendur plot 34 herë. Asnjë grua nuk e ka pasur nderin të përmendet kaq shumë sa Merjemja në Kuran.

Kjo tregon se ajo që e bën gruan më të shtrenjtë është nderi. Nëse femra humbet nderin, atëherë ajo shndërrohet në lodër, argëtim dhe dëfrim për të tjerët.

Një cilësi e Fatimes , ka qenë “Betul”, që do të thotë femër gjithmonë e pastër dhe e dëlirë.

Prandaj Islami i ka dhënë shumë rëndësi mbulesës. Sepse mbulesa është një mburojë fizike dhe shpirtërore për gruan. Femra pa mbulesë humbet shumë vlera. Kurse mbulesa i siguron nder, autoritet dhe e shndërron atë në monument të nderit dhe dëlirësisë.

Urdhri për t’u mbuluar është shfaqje e pozitës dhe vlerës së lartë që Islami i ka dhënë gruas. Thesaret me vlerë dhe të çmuara mbrohen në mënyrën më të mirë. Prandaj është kërkuar mbulesa e gruas, në mënyrë që ajo të jetë e mbrojtur dhe e ruajtur nga çdo gjë që ndot dëlirësinë e saj. Kjo është edhe urtësia më e madhe e mbulesës së gruas.

Fatkeqësisht, sot shoqëria jonë është shndërruar në një vatër zjarri. Dhe ato që do ta shpëtojnë shoqërinë janë vajzat tona të ndërgjegjshme, të arsimuara dhe të mirëedukuara.

Për të parashikuar të ardhmen e një kombi nuk duhet



të jesh profet. Për të parashikuar të ardhmen mjafton të shikosh rininë dhe prirjet e tyre. Prandaj është bërë e domosdoshme shpëtimi i fëmijëve tanë nga disa institucione që janë shndërruar në një luginë ujqërish. Institucioni që udhëheq në këtë luginë, padyshim që është media.

Fëmijët duhet të jenë një lëmoshë e vazhdueshme për ne. Por, nëse ne tregojmë mospërfillje dhe jo kujdes për ta, atëherë ata në Ditën e Gjykimit do të jenë argument kundër nesh.

Aftësia dhe arti i nënës duket në edukimin e fëmijës. Ashtu si aftësia e një mekaniku shfaqet në rregullimin e makinës edhe aftësia e nënës shfaqet në edukimin e fëmijëve të saj. Që nënat ta kryejnë siç duhet rolin e tyre të edukimit të fëmijëve dhe të sigurojnë mbrojtjen e tyre nga kurthet e jetës, duhet që ato vetë të marrin një edukim të mjaftueshëm.

Sot fatkeqësisht disa nëna pa asnjë shkak legjitim, në mënyrë krejt kriminale dhe çnjerëzore abortojnë fëmijët e tyre. Nëse në periudhën paraislamike i varrosnin për së gjalli vajzat, sot po i vrasin fëmijët që në bark, duke u bërë kurban i një krimi modern. Kjo së pari është një mosmirënjohje ndaj mirësive të shumta të Allahut. Përveç kësaj, këta nuk e dinë se me çfarë surprizash do të përballen në jetë. Ata që bëjnë këtë krim duhet të mendohen mirë, sepse ndoshta në të ardhmen do të mbeten krejt të vetmuar dhe ai fëmijë do të jetë një burim ngushëllimi dhe gëzimi për ta. Ata duhet të mendohen mirë, sepse edhe jeta e tyre kaq e shtrenjtë për ta mund të kishte përfunduar në mënyrë të tillë.



Historia është dëshmitare e një numri të pafund ngjarjesh të hidhura që mund të vijnë kur njerëzit jetojnë larg besimit dhe jepen pas egos dhe kënaqësive të kësaj bote. Gjendja e shoqërisë e zhytur në imoralitet, korrupsion, drogë dhe vese të këqija është shumë më e keqe se gjendja e një shoqërie të goditur nga një tërmet i fuqishëm dhe shkatërrues.

Allahu na bëftë të mundur të rrisim dhe edukojmë breza me moral të mirë dhe të dobishëm për shoqërinë dhe Allahu na ruajtë prej vorbullës së kënaqësive të kësaj bote. Lusim Allahun që t'i bëjë familjet tona burim të qetësisë dhe lumturisë. Allahu na i bëftë familjet portë të Xhenetit!

Amin...!



Modeli i gruas së devotshme në epokën e lumturisë



Nëna e devotshme është një burim mëshire, që Allahu i ka dhuruar njerëzimit. Zemra e nënës është mulliri ku bluhën dhe shkrihen tekat e fëmijëve. Një nënë e devotshme meriton falënderime, mirënjohje dhe respekt të përjetshëm.

MODELI I GRUAS SË DEVOTSHME NË EPOKËN E LUMTURISË

Esmaja, halla e sahabiut të famshëm Muadh ibn Xhebelit ishte një nga gratë sahabe të zgjedhura. Duke qenë një grua inteligjente, mendjemprehtë dhe oratore, i ishte dhënë titulli “zëdhënësja e grave”. Prej saj janë transmetuar 81 hadithe.

Gratë e Medinës e dërgonin si përfaqësuese të tyre tek Pejgamberi, për të marrë përgjigje për pyetjet, problemet dhe shqetësimet e tyre rreth fesë. Kur Pejgamberi ﷺ, shikonte Esmanë, thoshte:

- Esmaja bën pyetje që nuk i vijnë ndërmend asnjërit.

Njëherë Esmaja vjen tek Pejgamberi ﷺ, gjithë edukatë:

- O i Dërguari i Allahut! Cili është faji i grave? Dhe më tej vazhdon:

- O i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im të qofshin falë, unë erdha tek Ti si përfaqësuese e grave. Por të gjitha gratë kudo që janë, në lindje dhe perëndim, janë të një mendimi se Ti je i dërguari i Allahut për burrat dhe gratë. Ne të kemi besuar ty dhe Zotit tënd. Ngaqë jemi gra, jetoj-



më brenda mureve të shtëpisë. Ne edukojmë fëmijët dhe jemi burim qetësie dhe lumturie për burrat tanë. Por ne në ndryshim nga burrat kemi disa privime, për sa i përket mundësisë për t'u afruar me Allahun. Burrat falin namazin e xhumasë, pesë vaktet i falin me xhemat, vizitojnë të sëmurët më shumë se ne, marrin pjesë në shoqërimin e xhenazes, shkojnë në Haxh më tepër se ne. Dhe më e rëndësishme se këto, burrat dalin në luftë për hir të Allahut, kurse ne mbrojmë pasurinë e shtëpisë, përgatisim rroba për ta dhe ushqejmë fëmijët. Sipas kësaj, a jemi ne ortakë me ta në ndarjen e shpërblimeve dhe sevapeve?

Pejgamberit ﷺ, i pëlqyen shumë këto fjalë largpamëse dhe të urta të Esmasë. Dhe duke u kthyer nga sahabët, tha:

- A keni dëgjuar nga gra të tjera fjalë më të bukura në lidhje me çështjet e fesë se sa këto?

Thanë:

- O i Dërguari i Allahut! Nuk e kishim mendur se një grua mund të flasë kaq bukur!

Pejgamberi ﷺ, duke u kthyer nga Esmaja tha:

- Esmaja! Dëgjo me vëmendje dhe informoju gratë e tjera se, nëse një grua kalon mirë me bashkëshortin dhe fiton kënaqësinë e burrit, ajo është e njëjtë me burrin për sa i përket fitimit të shpërblimit.”

Esmaja mbeti shumë e kënaqur nga kjo përgjigje dhe kënaqësinë e shprehte duke madhëruar dhe falënderuar Allahun.



E ngjashme me këtë ndodhi është edhe:

Ummu Ri'le, një nga gratë sahabe, vjen te Pejgamberi ﷺ dhe pasi shpreh shqetësimin që janë të zënë me punët e shtëpisë, me shërbimin ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve tha:

- O i Dërguari i Allahut! Ne nuk kemi mundësi të marrim pjesë në luftë për të fituar shpërblime të mëdha. Na mëso diçka që t'i afrohem Allahut.

Pejgamberi ﷺ, tha:

“- Përmendeni Allahun ditë e natë. Ruani sytë dhe veshët tuaj nga të huajt...” (Ibn Haxher, el-Isabe, VIII, 204)

Siç kuptohet nga këto dy transmetime, shqetësimi i grave ishte pamundësia për t'i shërbyer fesë dhe në këtë mënyrë, privimi nga fitimi i sevapeve për shkak të preokupimit me punët e shtëpisë. Ato mendonin se duke qëndruar në shtëpi nuk po fitonin sevape si burrat e tyre, të cilët shkonin në xhihad, jepnin lëmoshë dhe bënin më shumë ibadet. Ishte ky entuziazëm dhe dëshirë për të bërë vepra të mira, që i kishte detyruar të dërgonin disa herë rresht përfaqësues te Pejgamberi ﷺ.

Nëse reflektojmë sado pak mbi këto dy ngjarje, do të vërejmë se ato përmbajnë shumë urtësi dhe mësim.

Allahu i ka krijuar njerëzit nevojtarë për njëri-tjetrin dhe të gjithëve u ka dhuruar aftësi dhe talente të ndryshme. Një i varfër për këtë botë ka nevojë për një të pasur, kurse një i pasur për të fituar Ahiretin ka nevojë për një të varfër. Një i sëmurë ka nevojë për një të shëndetshëm, që të kuj-



deset për të, kurse një i shëndoshë ka nevojë për lutjen e të sëmurit. Fëmijët kanë nevojë për edukimin e prindërve, kurse prindërit kanë nevojë për lëmoshën e vazhdueshme të fëmijëve të mbarë në Ditën e Gjykimit.

Si çdo gjë tjetër edhe burri me gruan kanë nevojë për njëri-tjetrin në jetën e kësaj bote. Aftësitë dhe natyrat e tyre janë të ndryshme, por ato janë elementë që plotësojnë njëri-tjetrin. Të dy palët duhet të inkurajojnë njëri-tjetrin për mirësi dhe detyrat duhet t'i kryejnë për hir të Allahut.

Nëse gruaja jeton në harmoni dhe sipas natyrës së saj të krijimit, shoqëria bëhet parajsë. Nga historia mësojmë se shoqëritë janë lartësuar me edukimin e gruas dhe kanë rënë me prishjen e saj. Sepse gruaja ka një rol të jashtëzakonshëm në familje, e cila formon bërthamën e shoqërisë.

Prandaj vajzat tona duhet të jenë burim i moralit, karakterit dhe personalitetit islam. Nuk duhet të harrojmë që të gjithë dijetarët e famshëm mësimet e para i kanë marrë prej nënave të tyre.

Në familje burri duhet të jetë i mëshirshëm dhe xhentil, kurse gruaja duhet të jetë e bindur dhe respektuese. Femra duhet të inkurajojë burrin, fëmijët madje edhe fqinjët për punë dhe vepra të mira. Gruaja e devotshme është si një lule xheneti që përhap erë të mirë përreth.

Nëna e devotshme është një burim mëshire që Allahu i ka dhuruar njerëzimit. Zemra e nënës është mulliri ku bluhet dhe shkrihen tekat e fëmijëve. Farat e lules së lumturisë janë lënë në zemrën e nënës. Prandaj Pejgamberi ﷺ, ka thënë:



“Xheneti është nën këmbët e nënës.” Përsëri kur u pyet se cili person duhet të duhet më shumë, përsëriti tri herë rresht nënën, herën e katërt babain.

Një transmetim i Abdullah ibn Mesudit e shpreh shumë bukur modelin e gruas së edukuar nën atmosferën e Kuranit dhe Sunetit.

Kur një sahab hynte në shtëpi, gjëja e parë që bënte bashkëshortja ishin dy pyetje:

1- Sa ajete u shpallën sot nga Kurani?

2- Sa hadithe mësove nga Pejgamberi ﷺ? Dhe hadithet që ke mësuar kërkoj të m'i më mësosh edhe mua.

Kur bashkëshorti dilte nga shtëpia, porosia që i jepte bashkëshortja ishte:

“Frikësoju Allahut, mos fito pasuri haram, sepse ne në këtë botë e durojmë urinë, por nuk mund të durojmë zjarrin në Xhehenem.” (Abdulhamid Kishk, Fi Rihabi ‘t Tefsir, I, 26)


Një grua të zbukuruar me këto cilësi, Pejgamberi ﷺ, e ka përshkruar kështu:


“Gruaja e devotshme, kur e shikon bashkëshorti, e mbush atë me gëzim, i bindet atij dhe në mungesë të burrit ruan nderin dhe pasurinë e tij.” (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857)

Përcaktimi hyjnor për njeriun në këtë botë është i ndryshëm për njerëz të ndryshëm. Prandaj, një sërë familjesh janë të lumtura dhe të qeta. Këto familje janë sprovuar me sprovën e falënderimit.



Kurse në një sërë familjesh të tjera zotëron pakënaqësi, problemet dhe shqetësimet. Këto duhet të mbështeten tek Allahu dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë martesën pa menduar për divorc, sepse ky grup është sprovuar me durim. Në kohën tonë fenomeni i divorcit është përhapur shumë, duke u bërë shkak për shkatërrimin e shumë familjeve. Divorcet lënë pasoja shumë negative prapa.

Disa familje nuk mundën të kenë fëmijë. Ata duhet të marrin shembull nënën tonë Aishen . Ajo mori në kujdestari fëmijët jetimë të motrës, duke u dhënë një edukatë shembullore. (Muvatta, Zekat, 10)

Për njerëzit që kujdesen për jetimët, Pejgamberi , ka thënë: “Me ata do të jem kështu (dhe ngriti ngjitur gishtin tregues dhe të mesit) në Xhenet.”

Disa vajza dhe djem nuk mund të martohen, sepse nuk u ka dalë një rast i përshtatshëm. Edhe ata duhet ta përballojnë me durim këtë gjendje. Ajeti kuranor urdhëron: **“Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le të përmbajnë veten, derisa Allahu t’i begatojë me dhuntinë e Tij.”** (Nur, 33)

Kurse në një ajet tjetër: **“...Ju mund të urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** (Bekare, 216)

Për disa të tjerë mund të ekzistojnë disa pengesa dhe vështirësi për martesë.

Për ta përmbledhur, një besimtar në çfarëdo kushtesh



dhe situatash qoftë, duhet të jetë gjithmonë i kënaqur me Allahun dhe të përpiqet të lartësojë vlerat islame, në çdo vështirësi që has duhet të mbështetet tek Allahu. Allahu në Kuran thotë:

“...Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai...”

(Talak, 3)

O Zot! Na zbukuro dhe ndriço zemrat me dritën që u ndriçuan zemrat e sahabëve dhe na e bëj të mundur të takohemi me Ty të zbukuruar me atë dritë që ndriçoi zemrat e tyre.

Amin!..



Kësbillat e një nëne për vajzën



Islami nuk e konsideron nënën thjesht si një organizëm biologjik. Sipas Islamit nëna është një shkollë më vete, sepse, nëse prindërit neglizhojnë edukimin e fëmijëve, pasojat janë të frikshme. Fëmijët bëhen të huaj për familjen.

Nëse prindërit nuk i orientojnë fëmijët drejt edukimit shpirtëror, por ia lënë edukimin e tyre rastit dhe rrugës, ata kanë shkatërruar ahiretin e vet dhe të fëmijëve.

KËSHILLAT E NJË NËNE PËR VAJZËN

Fëmijët janë pjesë e qenies së prindërve. Prandaj prindërit dëshirojnë lumturinë dhe suksesin e fëmijëve të tyre dhe për lumturinë dhe mirëqenien e tyre kapërcejnë të gjitha vështirësitë, qëndrojnë pa gjumë, pa veshur dhe pa ngrënë. Kur sëmuren fëmijët, kujdesen gjithë përkushtim dhe mëshirë për ta.

Kur ata rriten dhe bëhen për t'u martuar, prindërit me shpresën për t'u siguruar një jetë të lumtur, të nisur edhe nga përvoja që kanë fituar gjatë jetës së tyre, përpiqen t'u japin fëmijëve të tyre disa këshilla. Përpiqen sipas nivelit arsimor, kulturor dhe edukativ t'i udhëzojnë fëmijët në rrugën më të mirë dhe të drejtë.

Por fatkeqësisht sot, për shkak të dobësisht të karakteristikave shpirtërore, një sërë prindërisht, në vend që t'i këshillojnë për dashuri, respekt, durim dhe sakrificë, i nxisin për hakmarrje, kryeneçësi dhe mosbindje. Në këtë mënyrë, ata shkatërrojnë me duart e tyre jetën dhe lumturinë e fëmijëve të tyre.

Këto sugjestionime, të cilat e kushtëzojnë negativisht zemrën që në fillim të rrugës, nuk mund t'i japin jetë familjes. Ato bëhen shkak për shkatërrimin e shpejtë të saj. Nën



shtimin e numrit të divorceve, të problemeve familjare, të krizave shpirtërore dhe psikologjike qëndrojnë pikërisht sugjestionime të tilla, të cilat kanë lënë gjurmë në subkoshencën e tyre.

Kurse në traditën islame qëllimi i këshillave është shndërrimi i jetës në kopsht xheneti. Islami nxit për altruizëm dhe jo egoizëm dhe në këtë mënyrë, i mbush zemrat me dashuri reciproke. Në traditën tonë prindërit i këshillojnë kështu vajzat që janë për t'u martuar:

-Bijë! Siç dole nga shtëpia jonë me vello, të dalësh nga shtëpia e burrit me qefin..

Në këtë mënyrë e inkurajonin për besnikëri dhe sakrificë në familjen e re ku do të shkonte për të kaluar jetën. Dhe për të qëndruar fort përballë vështirësive dhe surprizave që të ofron jeta, i këshillonin:

- Edhe nëse të jepet gjak për të pirë, thuaj piva shurup thane...

Një çift bashkëshortësh që rrjedh nga familje të mira dhe të moralshme, arrin të krijojë të njëjtën atmosferë të bukur edhe në familjen e re, të sapokrijuar.

Këshillat për të rinjtë që do të martohen do të jenë gurë themeli për lumturinë e tyre. Ne, këto këshilla të cilat kanë kaluar nëpër sitën e kohës, duhet t'u transmetojmë brezave pas nesh.

Tani të shohim një shembull madhështor të një nëne, e cila këshillon vajzën e saj që është gati për të shkuar tek familja e burrit.



Këshillat e Umame binti Harisit për vajzën që po bëhej gati për martesë, ishin:

“Bija ime! Nëse këshilla do të ishte vetëm për edukatë dhe për të përmirësuar sjelljet, nuk do të ishte e nevojshme të këshilloja ty. Por këshilla është kujtesë për të diturin dhe mësim për të paditurin, prandaj është e dobishme për të gjithë.

Bijë! Nëse një vajzë nuk do të kishte nevojë për bashkëshortin për shkak të pasurisë, atëherë ti do të ishe e para që nuk ke nevojë. Por çështja nuk është kështu, burrat dhe gratë janë krijuar për njëri-tjetrin.

Bijë! Ti tani po shkon në një shtëpi të panjohur, ndryshe nga shtëpia ku ke lindur dhe je rritur.

Prandaj bindu, shërbe dhe bëhu burim lumturie për të, në mënyrë që edhe ai të bëhet robi i yt, të të dojë dhe të përpiqet me gjithë shpirt të të bëjë të lumtur.

Tani do të tregoj dhjetë këshilla. Këto këshilla mësoji dhe nguliti mirë në mendje, në mënyrë që të bësh një jetë bashkëshortore të lumtur.

- 1. Prano me kënaqësi çdo gjë që të sjell burri.*
- 2. Qëndro larg gjërave që të ka ndalur dhe zbato të gjitha urdhrat e tij, dëgjoje dhe bindu.*
- 3. Trego kujdes në pastërtinë e shtëpisë dhe higjienës vetjake.*
- 4. Qëndro larg çdo gjëje që nuk i pëlqen bashkëshortit.*



5. *Ndiqi me përpikëri kohët kur ha dhe kur fle bashkëshorti, në mënyrë që ai ta gjejë tryezën e bukës dhe dhomën e gjumit gati. Sepse uria e zemëron njeriun, kurse pagjumësia e nervozon.*
6. *Ruaj dhe mos e harxho pa kriter pasurinën e bashkëshortit.*
7. *Ruaj prestigjin e burrit dhe respekto të afërmit e tij.*
8. *Mos e kundërshto në asnjë çështje.*
9. *Ruaj sekretet e familjes. Nëse nuk i bindesh, fiton urrejtjen e tij dhe nëse i zbulon sekretin, fiton mllefën e tij.*
10. *Bijë! Kujdes mos shfaq shenja gëzimi dhe lumturie kur bashkëshorti është i mërzitur dhe mos shfaq shenja mërzie kur ai është i gëzuar dhe i lumtur.*

Nëse do t'i analizonim këto këshilla mund themi:

Për shkak të ekuilibrit që Allahu ka vendosur në univers, bashkëshortët janë dy pjesë të domosdoshme për njëri-tjetrin. Ato janë dy përmasa që plotësojnë njëra-tjetrën. Bashkimi i tyre është i domosdoshëm për vazhdimin e jetës në tokë. Çdo çift bashkëshortor ndjen nevojë për shijimin e lumturisë familjare. Allahu e ka bërë familjen burim lumturie dhe gëzimi dhe vazhdimësinë dhe lumturinë e shoqërisë e ka kushtëzuar me familjen.

Prandaj çifti që dëshiron të krijojë familje duhet të tre-



gojë kujdes se mbi çfarë parimesh do ta ndërtojë familjen, në mënyrë që të arrijë qetësinë dhe lumturinë e dëshiruar.

Në këtë kontekst, parimi që duhet respektuar më shumë janë ndalesat dhe urdhëresat hyjnore, sepse lumturia është dhuratë e Allahut. Familja është e lumtur në raport të drejtë me respektimin e urdhëresave hyjnore. Prandaj çifti nuk duhet t'i harrojë në asnjë mënyrë detyrat që ka përpara Allahut. Madje edhe martesë duhet konsideruar si ibadet ndaj Allahut.

Një tjetër parim që duhet respektuar në familje, është vetëdija për përgjegjësitë që i takojnë çdo njërit prej bashkëshortëve. Harmonia në familje është e varur drejtpërdrejt me vetëdijen e detyrimeve dhe përgjegjësiive respektive. Nëse njëra palë nuk i kryen detyrat e veta ose i kalon kufijtë duke i bërë padrejtësi palës tjetër, atëherë në atë familje fillojnë të ngrenë krye problemet, pakënaqësitë dhe mëritë. Armiku më i madh i familjes është të presësh sakrificën gjithmonë prej palës tjetër. Mirëpo, nëse çdo njëri prej çiftit do të tregonte sakrificë sipas mundësisë dhe fuqisë që ka, jo vetëm familja, por gjithë shoqëria do të shndërrohej në një burim lumturie dhe kënaqësie.

Një nga qëllimet madhore të familjes është rritja dhe edukimi i fëmijës sipas normave dhe edukatës islame. Prindërit duhet të mendojnë seriozisht për të ardhmen shpirtërore të fëmijëve. Fëmijët kanë shumë nevojë për edukimin e prindërve, sidomos në periudhën e hershme dhe adoleshencës. Prindërve që u japin një edukatë dhe moral të mirë fëmijëve, Pejgamberi ﷺ, u ka dhënë një sihariq të madh:



“Allahu i lartëson gradën besimtarit në Xhenet, personi i habitur nga ky vlerësim pyet:

- O Zot, për çfarë ishte ky vlerësim dhe lartësim?

Allahu Teala i përgjigjet:

“Të lartësova për shkak të istigfarëve dhe lutjeve që kanë bërë fëmijët tuaj për ty...” (Ibn Maxhe, Edeb, 1)

Nëse ndodh e kundërta, pra neglizhohet edukimi shpirtëror dhe molepsen pas veseve të këqija, në Ditën e Gjykimit ata fëmijë do të jenë palë akuzuese për prindërit e tyre.

Allahu në Kuran urdhëron:

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”

(Tahrim, 6)

Pejgamberi ﷺ, me qëllimin e komentimit të ajetit tha:

“Nëse i largoni fëmijët nga ndalesat dhe i inkurajoni për të kryer urdhëresat, atëherë i keni shpëtuar dhe mbrojtur nga Xhehenemi.” (Alusi, XXVIII, 156)

Nën ndikimin e programeve mediatike dhe internetit, rinia po zhytet gjithnjë e më shumë në vorbullën e telasheve, erozioni moral i shkaktuar të jep përshtypjen e një lugine ujqerish. Kjo gjendje kërkon një kujdes të veçantë kryesisht për vajzat, të cilat do të marrin përsipër edukimin e brezave të ardhshëm. Sepse mangësitë morale të prindërve ndikojnë direkt në formimin e gjithanshëm të fëmijëve. Përgatitja e fëmijëve vetëm nga ana materiale nuk u siguron atyre lumturinë, as në këtë botë dhe as në botën tjetër. Përkundrazi, i fut në rrugë pa krye.



Libri më i rëndësishëm i edukimit të besimtarit është Kurani. Është kusht mbujtja e karakterit të besimtarit me Kuranin dhe Sunetin e Pejgamerit ﷺ.

Pejgamberin ﷺ, të cilin e ka dërguar mëshirë për gjithë njerëzimin, Allahu e ka bërë shembullin më të përkryer për besimtarët. Prandaj shembulli model që duhet t'u japim fëmijëve është Pejgamberi ynë i dashur.

Në këtë kontekst, duhet të kuptojmë shumë mirë mënyrën si e edukoi Pejgamberi ﷺ, vajzën e tij, Fatimen ﷺ. Orientimi i saj drejt jetës shpirtërore, thjeshtësisë, devotshmërisë dhe asketizmit, duke u larguar pothuajse plotësisht nga kënaqësitë e kësaj bote, megjithëse Fatimja ﷺ, kishte një vend të veçantë në zemrën e Pejgamberit ﷺ, të gjitha këto janë kritere të rëndësishme mbi të cilat duhet të mendojë mirë çdo mysliman.

Pejgamberi ﷺ, në lidhje me arsimin dhe edukimin e vajzave thotë:

“Kushdo që ka tri vajza ose tri motra dhe kujdeset, i rrit dhe i edukon, i marton dhe sillet mirë me to, ka fituar Xhenetin.” (Ebu Davud, Edeb, 120-121/5147)

“Kushdo që ka dy vajza, për të cilat kujdeset dhe i edukon, në Ditën e Gjykimit do të jetë pranë meje.” (Muslim, Birr, 149)

“Kushdo që përballet me vështirësi për shkak të edukimit të vajzave, ato vajza do të jenë mburojë nga zjarri i Xhehenemit.” (Buhari, Zekat, 10)

Përmendja e vajzave në këto hadithe është edhe për



të çrrënjosur traditën injorante ndaj vajzave në periudhën paraislamike, por edhe për të theksuar rëndësinë e edukimit të vajzave në përsosjen e shoqërisë.

Sepse vajza nuk është thjesht vetëm një individ, ajo është foleja, mësuesja dhe shkolla e brezit të ri. Brezat e rinj mugullojnë në zemrat plot dashuri, mëshirë dhe dhembshuri të vajzave. Nëse prindërit nuk u japin edukatën dhe moralin e duhur, por ia lënë edukimin rastit dhe rrugës, atëherë ata kanë shkatërruar veten dhe fëmijët e tyre.

O Zot! Na bëj të mundur një jetë nën atmosferën shpirtërore të Kuranit dhe Sunetit! Zbukuroji brezat e ardhshëm me bukuritë e Islamit! Bëji ata burim gëzimi, drite dhe kënaqësie për prindërit e tyre!

Amin..!





Prika



Fatkeqësisht në ditët tona, ndër karakteristikat që kërkohen më shumë tek vajza dhe djali që dëshiron të marrohet është interesi material. Mirëpo Pejgamberi ﷺ, e ka këshilluar umetin e vet t'i japë përparësi fesë dhe moralit të bukur.

“Kur të vijë tek ju dikush me moralin dhe besimin e të cilit jeni të kënaqur, jepjani vajzën tuaj. Nëse nuk vepron kështu, do të shfaqen trazira dhe shturje.”



PRIKA

Duke u nisur nga urtësia e qëllimit të krijimit, femra është pajisur me një intensitet shumë të madh ndjenjash. Prandaj femra është krijesë shumë e brishtë. Edhe fiziku i tyre në krahasim me atë mashkullit është më i dobët. Ato nuk janë rezistente dhe të fuqishme sa burri. Në përgjithësi, sigurimi i fitimit të jetesës është në duart e burrave.

Prika është një e drejtë e ligjshme, që i është njohur gruas në Islam, pikërisht për të kompensuar këto dobësi të gruas.

Siç është e njohur, prika në një kuptim është një garanci monetare që burri i jep gruas kur martohet. Vlera përcaktohet nga kërkesa e gruas dhe mundësitë e burrit për ta paguar. Me këtë shumë parash gruaja mund të sigurojë jetesën, qoftë edhe për një kohë të shkurtër në rast divorci apo vdekje të bashkëshortit.

Prika nuk është një shumë parash që i jepet familjes së vajzës, por i jepet vetë vajzës. Dhënia e një shume parash familjes së vajzës është një traditë pa baza në Islam.

Prika është një garanci materiale. Por garancia më e madhe për të cilën njeriu ka nevojë është garancia shpirt-



ërore, e cila e ndihmon dhe i gjendet pranë njeriut në Ditën e Gjykimit. Në një këndvështrim, qëllimi parësor i prikës është ruajta dhe sigurimi i anës shpirtërore të gruas. I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka këshilluar burrat t'u japin grave të drejtat materiale dhe shpirtërore, t'i pajisin ato me siguri materiale dhe shpirtërore. Por në rast të pamundësisë për të paguar prikë, vajzave u sugjerohet të kënaqen me diçka simbolike dhe të preferojnë devotshmërinë dhe moralin e bukur përballë pasurisë materiale.

Një ngjarje e ndodhur në kohën e Pejgamberit ﷺ, e shpjegon shumë bukur këtë:

Një grua i ofroi Pejgamberit ﷺ, propozim për martesë. Pejgamberi ﷺ, heshti. Përballë heshtjes së tij, dikush nga të pranishmit tha: “O i Dërguari i Allahut! Martoje me mua.”

Pejgamberi ﷺ, e pyeti:

“Ç'ke ndonjë gjë për t'i dhënë?”

Ai i tha:

“Nuk kam asgjë.”

Pejgamberi ﷺ, i tha:

“Shko e kërko ndonjë gjë, edhe sikur të jetë një unazë hekuri.”

Burri shkoi, pastaj u kthye dhe tha:

“Jo, për Allah, nuk kam gjetur asgjë, as edhe një unazë hekuri. Por kjo është rroba ime dhe gjysmën ia jap asaj.”

Por ai nuk kishte rrobë nga mesi e lart. Profeti ﷺ, i tha:

“Ç'të bëjë ajo me gjysmën e rrobës tënde? Në qoftë se



e vesh ti atë, ajo s' do të ketë gjë; në qoftë se e vesh ajo, t'i s' do të kesh asgjë.”

Kështu ai u ul dhe, pasi ndenji një kohë të gjatë, u ngrit për të ikur. Kur Pejgamberi ﷺ, e pa të largohej, e thirri atë dhe i tha:

“Sa di përmendsh nga Kurani?”

Ai iu përgjigj:

“Di këtë sure e atë sure”, - tha, duke përmendur emrat e disa sureve.

Kështu Pejgamberi ﷺ, i tha:

“Të martojmë ty me të për atë që di nga Kurani.”

(Buhari. Nikah, 49)

Nga ky hadith mund të nxjerrim dy mësimë shumë të rëndësishme:

Dashuria, lidhja dhe nënshtrimi i plotë i një gruaje saha-be ndaj të Dërguarit të Allahut. Ishte kjo dashuri që e kishte shtyrë atë të ofronte veten si dhuratë për Pejgamberin ﷺ.

Siç dihet, Pejgamberit ﷺ, i është lejuar të martohet me gratë që i dhurohen. Në lidhje me këtë çështje, Kurani shprehet:

“O Profet! Ne t'i kemi lejuar ty (për martesë), gratë që u ke dhënë dhuratat e martesës, skillavet, që t'i ka dhënë ty Allahu (si pre të luftës), vajzat e shaxhallarëve, hallave, dajave dhe tezeve të cilat mërguan bashkë me ty, si edhe gruan besimtare, që u vetëdha për Ty, nëse Ti dëshiron të martohesh me atë. Kjo të është lejuar



vetëm ty e jo besimtarëve të tjerë. Ne e dimë çfarë u kemi caktuar atyre për gratë e tyre dhe për ato që gjenden nën pushtetin e tyre, që për ty të mos ketë fajësim. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” (Ahzab, 50)

Propozimi i gruas u prit me heshtje nga Profeti ﷺ dhe kjo për të mos plagosur zemrën e saj. Një sahab, duke parë heshtjen e Pejgamberit ﷺ dhe duke kërkuar leje prej Tij, kërkoi dorën e gruas në fjalë për martesë. Përsëri këtu na del në pah dashuria dhe nënshtrimi i kësaj gruaje të devotshme ndaj Pejgamberit ﷺ. Ajo pranoi të martohej me sahabin pa asnjë mëdyshje dhe hezitim.

Pika tjetër që ia vlen të preket në këtë ngjarje, është varfëria ekstreme e sahabiut, i cili nuk kishte asnjë unazë të thjeshtë.

Pranimi për t’u martuar me një burrë të tillë, që nuk zotëron asgjë materiale në kushtet e sotme mund të duket e pakonceptueshme, sepse sot të gjithë kërkojnë të sigurojnë anën materiale. Nëse një burrë nuk ka shtëpi, makinë, punë, pagë të mirë, sado besimtar dhe i devotshëm të jetë, është i destinuar t’i refuzohen shumë propozime për martesë. Mirëpo Pejgamberi ﷺ, ka thënë: *“Kur të vijë tek ju dikush me moralin dhe besimin e së cilit jeni të kënaqur, jepja- ni vajzën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, do të shfaqen trazira dhe shthurje.”*

Mbi këtë, një sahab u shpreh:

-O i Dërguari i Allahut! Po nëse ajo është e varfër dhe nga familje jo e fisme?



I Dërguari i Allahut, duke e përsëritur tri herë, tha: “Kur të vijë një njeri me fenë dhe moralin e të cilit jeni të kënaqur, martojeni”.

Pra, kushti i parë për martesë është besimi. I Dërguari i Allahut ﷺ, duke e martuar vajzën e tij të dashur, Fatimen ﷺ, me Aliun ﷺ, ka dhënë shembullin e vet për të treguar epërsinë e besimit dhe moralit ndaj interesave dhe të mirave materiale.

Edhe në ngjarjen e mësipërme, gruaja e nderuar sahabe pranoi me kënaqësi të martohej me një burrë në skamje të plotë, sepse burri dinte Kuran dhe pranoi t’ia mësojë edhe asaj. Ajo grua ishte në merak për të garantuar botën e përtejme, jo këtë botë. Sepse ajo ishte e vetëdijshme për përkohshmërinë e rehatisë dhe mirëqenies së kësaj bote dhe në fund do ta priste vdekja dhe Ahireti. E vetmja monedhë e vlefshme në Ahiret është besimi dhe vepra e mirë. Kjo grua së pari dëshiroi të ishte gruaja e Pejgamberit ﷺ, pa asnjë përfitim, pastaj me ndërhyrjen e tij pranoi pa asnjë hezitim të martohej pa kërkuar asnjë të mirë materiale prej burrit.

Personave që janë të dhënë pas të mirave të kësaj bote mund t’u duket e habitshme dhe absurde kjo lloj martese. Sepse sot në shoqërinë tonë vlerat shpirtërore kanë pësuar tronditje, duke e bazuar çdo gjë në interesa materiale. Prandaj sakrificat është harruar, madje në disa raste po konsiderohet si egoizëm. Është shumë e vështirë të japë gjykime të sakta një mendje materialiste krejtësisht larg atmosferës shpirtërore.

Por njëkohësisht, është e padrejtë t’u kërkosh grave



të heqin dorë nga kjo e drejtë e tyre, duke u nisur nga ky shembull i lartë që tregoi kjo grua. Një ngjarje e ndodhur në kohën e Omerit رضي الله عنه, na ndihmon të shikojmë situatën në një prizëm tjetër.

Në periudhën e Omerit رضي الله عنه, për shkak të prikës së lartë që kërkonin gratë, shumë veta nuk kishin mundësi të martoheshin. Kur u shtuan shqetësimet në lidhje me këtë, Omeri رضي الله عنه, ndjeu nevojën të ndërhynte për një rregullim ligjor. Kur u ngjit në minber, iu drejtua njerëzve:

- Kam vënë re që gratë kërkojnë prikë shumë të lartë, gjë e cila vështirëson shumë martesën. Unë nuk e shikoj të përshtatshme që prika të jetë mbi 400 dirhem...

Pa mbaruar fjalën, Omeri رضي الله عنه, u përball me kundërshtimin e një gruaje kurejshite.

- Halife! Ti nuk ke të drejtë për këtë! Allahu në Kuran nuk ka vendosur asnjë kufi tavan. Atëherë, ku bazohesh që e kufizon prikën me 400 dirhem dhe lexoi ajetin:

“Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë një tjetër, asaj që i keni dhënë pasuri, mos merrni nga ajo (pasuri) asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?!”

(Nisa, 20)

Argumenti kuranor dhe protesta legjitime e gruas mjaftoi për ta bindur Omerin رضي الله عنه, për të hequr dorë nga vendimi dhe për të pranuar gabimin. Pas kësaj, Omeri mbajti fjalën historike:

“O Zot, më fal! Të gjithë njerëzit janë më të ditur se



Omeri!.. O njerëz! Unë jua ndalova prikën mbi 400 dirhem. Por të gjithë janë të lirë të kërkojnë prikë sa të duan.” (Ibn Haxher, Metalib, II, 4,5)

Është për t’u admiruar ndjeshmëria që tregoi Omeri ﷺ, përballë kufijve hyjnorë. Ai pranoi gjithë modesti, përpara gjithë xhematit, gabimin e bërë duke iu nënshtruar plotësisht gjykimit hyjnor.

Për ta përmbledhur, prika nuk ka as kufi tavan, as dyshe-me. Çdo grua mund të kërkojë prikë sipas dëshirës që ka. Nëse dëshiron, mund të kërkojë si prikë vetëm diçka shpirtërore, si në rastin e gruas që përmendëm në fillim.

Janë për t’u përgëzuar shumë vajza, të cilat duke mos i dhënë rëndësi vlerës materiale, kërkojnë për prikë një shumë monetare që përballon umren ose haxhin. Me këtë tregojnë intuitën dhe zgjuarsinë e tyre për ta shndërruar të drejtën e tyre materiale në një përfitim shpirtëror.

I lutemi Allahut të na ruajë zemrat nga çdo lloj vesi të egos dhe nxitje të shejtanit. Allahu na bëftë prej atyre që i binden pa vështirësi çdo gjykimi hyjnor! O Zot, na bëj të mundur të mbërrijmë tek Ti me një zemër të pastër dhe të dëlirë!

Amin..!



PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Një këshillë, një mijë mësimë.....	17
Besimi kërkon dëshmi.....	31
Begatia e devocionit dhe e sinqeritetit.....	41
Elementet e çelësit të Tevhidit.....	53
Realiteti njihet përmes të kundërtave.....	63
Kurani, libri i gjithësisë.....	75
Mistika, arti i të qenit i kënaqur me caktimin hyjnor.....	85
Urtësia e vuajtjeve.....	95
Ekspozimi i një personaliteti islam.....	105
U ngjalltë kushdo që vjen tek Ti.....	115
Mëshira, fryti i parë i besimit.....	123
Përgjegjësia e udhërrëfyesve.....	129
Sekreti i rinisë.....	135
Si të jetosh do të vdesësh.....	143
Lëre barrën dhe kalo.....	149
Gruaja e devotshme -1-.....	157
Gruaja e devotshme -2-.....	169
Modeli i gruas së devotshme në epokën e lumturisë.....	177
Këshillat e një nëne për vajzën.....	187
Prika.....	197

